



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORT I VLERËSIMIT TË JASHTËM

**Programi i Studimit të Ciklit të Dytë Master i Shkencave në:
“Ekonomiks”
Universiteti i Tiranës**

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:


Prof. Besnik KRASNIQI

Prof. As. Eglantina HYSA

Prill / 2023

TABELA PËRMBLEDHËSE E TË DHËNAVE TË PROGRAMIT TË STUDIMIT**Master i Shkencave në: “Ekonomiks”**

	IAL aplikues:	Universiteti i Tiranës
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Ekonomiksit
3	Emërtimi i programit të studimit:	Master i Shkencave në “Ekonomiks”
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	UMASh Nr. 510, datë 08.11.2010
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	-
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	Urdhër Nr. 297, datë 20.07.2012
7	Urdhëri/VBA i akreditimit periodik:	-
8	Cikli i studimit:	Cikli i dytë
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	2 vite akademike
10	Kreditet në total (ECTS):	120 ECTS
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Shqip
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Niveli 7
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	14 PAE / 1 PAK Ngarkesa mësimore: 85 % PAE / 15 % PAK
18	Numri i studentëve:	2020-2021 50 studentë; 2021-2022 17 studentë;
19	Komente / të tjera:	-



TË DHËNA TË PËRGJITHSHME PËR PROGRAMIN E STUDIMIT NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM



Universiteti i Tiranës është institucion publik i arsimit të lartë, i themeluar me Vendim të Këshillit të Ministrave, Nr. 207, datë 30.05.1957. Universiteti i Tiranës zhvillon veprimtari në fushën e arsimit dhe shkencës në Republikën e Shqipërisë, në zbatim të Ligjit Nr. 80/ 2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”. Universiteti i Tiranës ka kaluar procesin e vlerësimit institucional në kuadër të akreditimit, proces i zhvilluar nga ASCAL në bashkëpunim me Agjencinë Britanike të Sigurimit të Cilësisë QAA. Ky vlerësim u finalizua me Vendim të Bordit të Akreditimit nr.84, datë 27.10.2018, me kohëzgjatje 4 vite akademike, me afat vlefshmërie deri në 26.10.2022. Universiteti i Tiranës është i organizuar në 8 Njësi Kryesore, konkretisht:

1. Fakulteti i Drejtësisë;
2. **Fakulteti i Ekonomisë;**
3. Fakulteti i Gjuhëve të Huaja;
4. Fakulteti i Historisë dhe Filologjisë;
5. Fakulteti i Shkencave Sociale;
6. Fakulteti i Shkencave Natyrore;
7. Instituti i Fizikës Bërthamore të Zbatuar;
8. Instituti i Studimeve Europiane;

Ky raport i vlerësimit të jashtëm analizon programin e studimit Master i Shkencave në “Ekonomiks”, licensuar sipas Urdhërit Nr. 510, datë 08.11.2010, që realizohet me 120 kredite në gjuhën shqipe, me formë studimi me kohë të plotë dhe me kohëzgjatje normale 2 (dy), vite akademike, 4 semestra. Programi i studimit Master i Shkencave në “Ekonomiks”, ofrohet nga **Departamenti i Ekonomiksit, Fakulteti Ekonomik (FE).**

Fakulteti i Ekonomisë është i organizuar në gjashtë departamente:

1. Departamenti i Ekonomiksit;
2. Departamenti i Financës;
3. Departamenti i Kontabilitetit;
4. Departamenti i Marketing Turizmit;
5. Departamenti i Menaxhimit;
6. Departamenti i Statistikë Informatikë e Zbatuar;





PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Procesi i vlerësimit të jashtëm për akreditimin e programit të studimit të Ciklit të Dytë Master i Shkencave në “Ekonomiks” ofruar nga Departamenti i Ekonomiksit, pjesë e Fakultetit të Ekonomisë, filloi me prezantimin si dhe ndarjen e punës ndërmjet ekspertëve të grupit të vlerësimit të jashtëm. Më pas ky grup, bazuar në dokumentacionin e vendosur në dispozicion nga ASCAL, filloi shqyrtimin e Raportit të vlerësimit të brendshëm si dhe dokumentet përkatëse në mbështetje të tij. Gjatë kësaj faze u identifikuan dhe u listuan një sërë pyetjesh, që kishin lidhje me standardet dhe kriteret përkatëse, të cilat do të merrnin përgjigje gjatë takimeve që do të realizoheshin në IAL.

ASCAL bazuar në “Manualin për Procedurat dhe Afatet për Vlerësimin e Cilësisë në kuadër të Akreditimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe programeve të studimit 2017”, përzgjodhi dy vlerësues të jashtëm për të shqyrtuar dokumentacionin e përcjellë nga Institucioni i Arsimit të Lartë “Universiteti i Tiranës”, për të kryer vizitën në institucion dhe për të përpiluar raportin e vlerësimit të jashtëm. Grupi i vlerësimit të jashtëm ka në përbërje Prof. Dr. Besnik Krasniqi dhe Prof. As. Eglantina Hysa. Gjatë të gjithë fazës së vlerësimit të jashtëm ky grup pune u asistua nga Kordinatori Teknik i ASCAL, Zj. Majlinda Demireli. Në bashkëpunim me kordinatorin teknik të ASCAL u caktuan datat e vizitës në institucion dhe u përgatit axhenda e takimeve që do të realizoheshin. Axhenda iu dërgua paraprakisht edhe institucionit. Përpara vizitës në institucion grupi i vlerësimit të jashtëm realizoi një takim me kordinatorin e ASCAL, ku u diskutuan elementë të vlerësimit të programit. Vizita dy ditore në institucion u zhvillua në datat 26 dhe 27 Shtator 2022. Gjatë kësaj vizite, GVJ u takua me: Drejtues të Institucionit të Arsimit të Lartë “Universiteti i Tiranës”, Dekanin e Fakultetit dhe Përgjegjësin e Departamentit që mbulon programin e studimit; grupin e vlerësimit të brendshëm; pedagogët e aktivizuar në këtë program studimi; studentë të këtij programi studimi, përfaqësues të Komisionit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, përfaqësues të zyrës së Kurrikulës, përfaqësues të zyrës së Projekteve, përfaqësues të zyrës së Burimeve Njerëzore, përfaqësues të zyrës së Shërbimit të Studentëve dhe Këshillimit të Karrierës dhe Alumni, si dhe përfaqësues të sekretarisë mësimore. Gjithashtu u vizituan ambjentet e institucionit ku zhvillohet mësimi për këtë program studimi, si edhe ambjentet e bibliotekës. Pas vizitës në Institucion, grupi i vlerësimit të jashtëm diskutoi për çështje dhe problematika që dolën gjatë shqyrtimit dhe analizës të materialeve të paraqitura nga institucioni, diskutimeve gjatë ditëve të takimit, si dhe shqyrtimit dhe analizës së materialeve shtesë që iu kërkuan institucionit në ditën e dytë të vizitës. Më tej ky grup filloi punën për hartimin e raportit të vlerësimit të jashtëm. Në përfundim të këtij procesi, grupi përgatiti dhe dorëzoi draft raportin tek kordinatori teknik i ASCAL.


Universiteti i Tiranës është njohur me Draft-Raportin e Vlerësimit të Jashtëm më datë 29.03.2023, përmes sistemit AMS, si dhe në formë zyrtare me anë të shkresës me Nr. 1/61 Prot, datë 03.04.2023. Më datë 20.04.2023 Universiteti i Tiranës njofton nëpërmjet shkresës Nr. 869/8 Prot, datë 19.04.2023 “ Mbi Draft Raportin e Vlerësimit të Jashtëm për programin e studimit Master i Shkencave në Ekonomiks”, ku shpreh dakortësinë me vlerësimin e jashtëm të programit të studimit. Në këtë mënyrë Draft Raporti merr formën e tij përfundimtare si Raport i Vlerësimit të Jashtëm.





Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Dytë Master i Shkencave në “Ekonomiks”

I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT MASTER I SHKENCAVE NE EKONOMIKS

Standardi I.1	
Institucioni i arsimit të lartë ofron program studimi “Master i shkencave”/“Master i arteve”, në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synojnë ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ofron program studimi “Master i shkencave”/“Master i arteve” që nuk bien ndesh me interesat kombëtare.	Programi i studimit të ciklit të II-të Master i Shkencave në “Ekonomiks”, ofruar nga UT/ Fakulteti i Ekonomisë, në të gjithë komponentët e tij nuk bie ndesh me interesat kombëtare por i shërben këtyre të fundit. Si një program relativisht specifik dhe bashkëkohor ai i shërben përgatitjes dhe kualifikimit të studenteve në shërbim të interesave kombëtare në përgjithësi dhe zhvillimit ekonomik të vendit në veçanti. <i>Ev.1.1 Statuti i UT</i>
Kriteri 2. Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” synon ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	Programi i studimit MSH në “Ekonomiks” është hartuar në zbatim të Ligjit në fuqi për Arsimin e Lartë, akteve nënligjore dhe kuadrin rregullues të tij si dhe në Strategjinë e UT-së. Ky program reflekton vlerat akademike e kulturore standarde të arsimit të lartë në Shqipëri. Ky vlerësim bazohet në plotësimin e kriterëve thelbësorë të këtij programi në aspektin akademik dhe atë kulturor bazuar në Statutin e UT. Parë në tërësi, programi synon përcjelljen tek studentët si të vlerave akademike, ashtu dhe të atyre kulturore në shërbim të sektorit ekonomik të vendit. <i>Ev.1.1 Statuti i UT</i> <i>Ev.1.2 Strategjia e zhvillimit të UT-së</i>
Kriteri 3. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	Programi i studimit MSH në “Ekonomiks” është hartuar në mbështetje të qëllimit dhe misionit të UT-së dhe Fakultetit të Ekonomisë si njësi kryesore e tij, të shprehura në strategjinë e zhvillimit të institucionit me fokus përgatitjen e studentëve me njohuritë bashkëkohore teorike praktike në fushën e aplikimit të ekonomisë. Në zbatim të kësaj strategjie është edhe operimi i njësisë bazë të këtij programi, Departamentit i Ekonomisë, si pjesë e Fakultetit të Ekonomisë të UT-së. GVJ, gjatë vizitës në institucion, konsultoi dokumentacionin e vënë në dispozicion, verifikoi referencat ligjore, bisedoi me personelin akademik dhe



	<p>studentët, u informua për punëzënjen e të diplomuarve dhe, mbi këtë bazë, konkludon plotësimin e këtij kriteri.</p> <p><i>Ev.1.1 Statuti i UT</i></p> <p><i>Ev. 1.4 Rregullore e programit të studimit, neni 4, fq.3</i></p> <p><i>Ev.1.2 Strategjia e zhvillimit të UT-së</i></p> <p><i>Ref. Shënime nga vizita në institucion</i></p>			
<p>Kriteri 4. Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” hartohet dhe ofrohet në përputhje dhe për të nxitur zhvillimin ekonomik lokal dhe/ose kombëtar.</p>	<p>Ky program studimi ofron mundësi për të plotësuar tregun e punës specialistë të cilët mund të kontribuojnë në sektorë të rëndësishëm të ekonomisë, veçanërisht në nivel lokal. Vetë niveli i lartë i trajtimeve teoriko shkencore të ekonomisë bën të mundur koordinimin e nivelit shkencor me atë aplikativ në shërbim të sektorit të ekonomisë. PS është hartuar gjithashtu për të formuar specialist që mund të punësohen në sipërmarrje të ndryshme apo të vetëpunësohen, duke kontribuar në këtë mënyrë në përgatitjen e kapitalit human që kërkohet për zhvillimin e ekonomisë lokale dhe kombëtare.</p> <p><i>Ev. 1.3 Propozim për hapjen dhe organizimin e programeve të studimit të ciklit të dytë</i></p> <p><i>Ref. Shënime nga vizita në institucion</i></p>			
<p>Kriteri 5. Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” krijon baza të qëndrueshme njohurish për studime të thelluara të ciklit të tretë, duke përfshirë aftësimin e thelluar profesional e shkencor</p>	<p>Bazuar në përmbajtjen e programit, syllabuset dhe strukturën e tij evidentojmë para së gjithash përmbushjen e standardit shkencor për një program të nivelit të dytë. Niveli dhe struktura e tij është e përshtatshme dhe përlligj plotësisht përmbajtjen shkencore të programit ku dominojnë transmetimi i njohurive shkencore në fushën e ekonometrisë, mikroekonomi, makroekonomi, dhe elementë të optimizimit, të gërshetuar me ato aplikative dhe profesionale. Mbi këtë bazë programi përmbush kriteret për të mundësuar vazhdimin e programit të ciklit të tretë të studimit Doktoraturë në fushat që përfshin ky program.</p> <p><i>Ev. 1.3 Propozim për hapjen dhe organizimin e programeve të studimit të ciklit të dytë</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

Standardi I.2

Programi i studimit MSH/MA është në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të institucionit të arsimit të lartë dhe fushat akademike të tij.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni përcakton qartë se programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim të vetë institucionit.	Programi i studimit MSH në “ Ekonomiks” është hartuar në përputhje me Statutin e UT, Strategjinë e Zhvillimit të UT, dhe konstatoi që PS “Master i Shkencave në Ekonomiks” është konceptuar në harmoni me vizionin dhe misionin e UT-së. Qëllimi dhe objektivat e PS janë në përputhje me qëllimet dhe objektivat strategjike të zhvillimit të institucionit. <i>Ev. 1.1 Statuti, neni 92</i> <i>Ev.1.2 Strategjia e zhvillimit të UT-së</i> <i>Ev. 1.3 Propozim për hapjen dhe organizimin e programeve të studimit të ciklit të dytë</i>
Kriteri 2. Statuti dhe rregullorja e institucionit përcaktojnë qartë drejtimit prioritar akademike të tij dhe demonstrojnë se programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje dhe në zbatim të këtyre të fundit.	Statuti dhe rregullorja e UT-së përcaktojnë shtyllat kryesore ku mbështetet gjithë veprimtaria akademike dhe shkencore e institucionit. Kjo rregullore është miratuar në 12.4.2010 dhe në vijimesi me vendim Senati janë miratuar amendamente të ndryshme deri në vitin 2015, duke reflektuar edhe ndryshimet ligjore dhe aktet nënligjore në fuqi. Krahas kësaj baze rregullative, edhe vetë njësia bazë, Departamenti i Ekonomiksit që mbulon këtë program, ka hartuar rregulloren e programit “Master i Shkencave në Ekonomiks” ku janë të përcaktuara edhe drejtimit kryesore të këtij programi. <i>Ev. 1.1 Statuti i UT</i> <i>Ev.1.2 Strategjia e zhvillimit të UT-së</i>
Kriteri 3. Emërtimi, organizimi, struktura dhe përmbajtja e programit të studimit ofrohen në përputhje me fushat e drejtimit akademike të institucionit.	Ky program është në unison me fokusin dhe drejtimit kryesore akademike, shkencore dhe profesionale të Fakultetit të Ekonomisë dhe njësisë bazë të tij Departamentit të Ekonomiksit. Nga shqyrtimi i dokumentave përkatës, GVJ konstatoi se PS është organizuar në përputhje me fushat dhe drejtimit akademike të institucionit. Ky program studimi është organizuar dhe stukturuar duke u bazuar në dispozitat e Ligjit nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë". <i>Ev. 1.1 Statuti i UT</i> <i>Ev. 1.3 Propozim për hapjen dhe organizimin e programeve të studimit të ciklit të dytë</i>


Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al




7





	<i>Ref. Shënime nga vizita në institucion</i>			
Kriteri 4. Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” hartohet e zhvillohet në përputhje me strategjitë kombëtare të zhvillimit, interesit kombëtar dhe trendet globale të zhvillimit	<p>Ky program studimi i shërben zhvillimit kombëtar dhe lokal të ekonomisë. Në këtë këndvështrim, ky program studimi, nëpërmjet përgatitjes së studentëve me njohuritë teorike shkencore por edhe aplikative në fushën e ekonomisë i shërben këtij zhvillimi. Gjatë takimeve me drejtuesit e fakultetit dhe të departamentit përkatës, u theksua fakti se programi i studimit “Msc në Ekonomiks” është organizuar dhe hartuar sipas shembujve Europianë, dhe vecanërisht i mbështetur në ekperiencën e Universitetit të Bambergut, duke qenë se ky departament ka pasur program të përbashkët me po këtë universitet. Ndërthurja e lëndëve mbështesin zhvillimin e kërkimit shkencor si dhe bazohen në Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2015-2020. GVJ konkludoi që hartimi i PS përputhet me objektivat strategjike kombëtar të zhvillimit, mban në konsideratë interesin kombëtar dhe mbështetet në nevojat e tregut të punës.</p> <p><i>Ref. Shënime nga vizita në institucion;</i></p> <p><i>Ev. 1.2 Strategjia e zhvillimit të UT-së</i></p> <p><i>Ref. http://www.ips.gov.al/wp-content/uploads/2019/11/NSDI-shqip.pdf</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X


Standardi I.3	
Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” synon të plotësojë nevojat e tregut të punës dhe ofrohet në përputhje me kërkesat e tij.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” ka objektiva të përcaktuar qartë për formimin e studentëve në atë program, të cilët përfshijnë njohuritë e thelluara shkencore, aftësitë dhe kompetencat profesionale, që	Programi i studimit MSH në “Ekonomiksit”, ka të përcaktuara qartë objektivat e tij që përfshijnë nivelin e duhur shkencor dhe aspektin aplikativ e profesional që synon tu japë studentëve. Ata pajisen kryesisht me njohuri teorike bazë dhe aftësim praktik për zbatimin e këtyre njohurive. Dijet dhe aftësitë që fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit paraqiten në mënyrë të detajuar në dokumentacionin e PS



<p>duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit dhe që karakterizojnë profilin e programit në përputhje me nivelin e studimeve në të cilin ofrohen ato dhe me kërkesat e tregut të punës.</p>	<p>(syllabuset). Rezultatet e të nxënit janë specifikuar gjithashtu për secilin nga profilet e programit të studimit në suplementin e diplomës. GVJ mbështetur në DVV dhe takimet me stafin gjatë vizitës konstatoi që PS ka objektiva të qarta për formimin e studentëve.</p> <p><i>Ev. 1.3 Propozim për hapjen dhe organizimin e programeve të studimit të ciklit të dytë</i></p> <p><i>Ev. 1.4 Rregullore e programit të studimit MSH në Ekonomiks</i></p> <p><i>Ref. Shënime nga vizita në institucion</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni kryen studime mbi tregun lokal e ndërkombëtar të punës për programin e studimit që ofron përpara hapjes së tij, pas daljes së studentëve dhe në mënyrë periodike. Këto studime duhet të përfshijnë: të dhëna nga komunikimi zyrtar me punëdhënësit e fushës, kërkesat dhe nevojat e tyre, mundësitë e punësimit të studentëve, të dhëna mbi punësimin real të studentëve të diplomuar dhe zhvillimet e pritshme në sektorin përkatës.</p>	<p>GVJ evidentoi dy studime tregu, një të realizuar në nivel institucioni, dhe një të përgatitur nga vetë departamenti i Ekonomiksit. Të dy këto studime kishin synim analizimin e trendit të prurjeve për program studimi. Sipas gjetjeve, numri i aplikantëve për programin "MSC në Ekonomiks" është i qëndrueshëm dhe Departamenti i Ekonomiksit planifikon rreth 30-40 kuota për çdo vit akademik. Analiza e raporteve të prezantuara mbështetin nevojën e një programi studimi në fushën e ekonomiksit që do tu mundësojë studenteve punësime në këtë drejtim. Studimi ka informacion të bollshëm dhe analiza të detajuara. Si përfundim, GVJ konstatoi se programi merr në konsideratë studimet të ndyshme të tregut të punës duke mundësuar krahasimin e të dhënave me studimin e mëparshëm dhe bërjen e parashikime për të ardhmen.</p> <p><i>Ref. Shënime nga vizita në institucion;</i></p> <p><i>Ev 1.8 Studimi mbi tregun e punës UT 2018</i></p> <p><i>Ev. 1.9 Studim i tregut të punës për studentët e diplomuar në të gjitha ciklet e studimit të degës Ekonomiks, Dhjetor 2021</i></p>
<p>Kriteri 3. Objektivat formues, struktura dhe përmbajtja e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit garantojnë përfitimin e dijeve, aftësive, shkathtësive e kompetencave që i përgjigjen nevojave të tregut dhe lehtësojnë punësimin e studentëve.</p>	<p>Nga shqyrtimi i programit të studimit, konstatohet që në tërësinë e vet ky program bazohet në objektiva formuese të qarta dhe strukturë të përshtatshme që janë në funksion të dijeve dhe aftësive të studentëve në tregun e punës. Ky program tashmë i përgatitur në kuadër të kërkesave ligjore dhe rregullative me kohëzgjatje 2 vite akademike, arrin ti përgjigjet nevojave të tregut të punës sidomos në sektorin e ekonomisë privat dhe publik me specialistë që kanë njohuri të avancuara teoriko shkencore, duke përbërë një premisë për të pasur kërkesa të shumta nga ky treg. Disa nga lëndët e programit janë vazhdim i njohurive të mëparshme, ndërsa disa lëndë të tjera janë disi më të profilizuara, të cilat shërbejnë për zhvillimin e</p>



	<p>aftësive të studentëve për të punuar në sektorë të ndryshëm të ekonomisë.</p> <p><i>Ev. 1.3 Propozim për hapjen dhe organizimin e programeve të studimit të ciklit të dytë</i></p> <p><i>Ref. Shënime nga vizita në institucion</i></p>
<p>Kriteri 4. Programi i studimit përafrohet me programe studimi të ngjashme të ofruara nga institucione ndërkombëtare me qëllim lehtësimin e transferimit të studimeve apo punësimin e studentëve në të ardhmen në tregun ndërkombëtar.</p>	<p>Nga shqyrtimi i këtij programi studimi mendohet se ai përafrohet plotësisht me programe të ngjashme studimi në Universitete homologe të vendeve të tjera që fokusohen në fushën e ekonomisë. Nga vizita në institucion, morëm informacion për referencën e përgatitjes së këtij programi me universitete të huaja që ofronin programe në këtë fushë dhe që UT ka marrëveshje, si dhe të faktit të ngritjes së këtij programi si output i një bashkëpunimi jaft të frytshëm me Universitetin e Bambergut në Gjermani.</p> <p><i>Ev. 2.1 Plani mësimor i programit të studimit</i></p> <p><i>Ev. 2.14 Lista e studentëve që kanë bërë mobilitete</i></p> <p><i>Ref. Shënime nga vizita në institucion</i></p>
<p>Kriteri 5. Programi i studimit hartohet në përputhje me objektivat e përcaktuar në legjislacionin dhe direktivat e BE-së për arsimin e lartë dhe profesionet e rregulluara, mbështetet në përvojën disavjeçare të institucionit dhe praktikrat e mira të vendeve evropiane.</p>	<p>Ky program studimi është hartuar bazuar në kuadrin ligjor dhe rregullativ në fuqi. Hartimi është fokusuar në cilësinë e mësimdhënies, në zhvillimin e tij kryesisht me staf efektiv dhe vazhdimësinë e programit me të gjitha ndryshimet në të. Programi bazohet tashmë në Kartën e Bolonjës që përcakton ndarjen e grupimit të lëndëve në kurrikulën e programit MSH në "Ekonomiks" në variantet me 120 ECTS, në përputhje me standardet dhe praktikrat më të mira bashkëkohore.</p> <p><i>Ev. 1.3 Propozim për hapjen dhe organizimin e programeve të studimit të ciklit të dytë</i></p> <p><i>Ev. 2.6 Programet e lëndëve (syllabuset)</i></p> <p><i>Ev. 1.5 Plani i Kërkimit Shkencor të UT (2018-2022)</i></p>
<p>Kriteri 6. Programi i studimit "Master i shkencave"/"Master i arteve" përfshin aftësimin profesional në praktika profesionale të përputhura me qëllimin dhe objektivat e programit, si dhe në direktiva ndërkombëtare për profesionet e rregulluara.</p>	<p>GVJ konstatoi që konceptimi dhe mënyra e organizimit të praktikës profesionale është në përputhje me objektivin e programit të studimit për aftësimin praktik të studentëve. Konkretisht, bazuar dhe në VKM 41, datë 24.01.2018 "Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë", praktika profesionale ka në total 12 kredite. Nga vizita në institucion dhe takimi me stafin që mbulon këtë program, u theksua rëndësia që i jepet gjatë zhvillimit të shumicës së lëndëve karakteri aplikativ nëpërmjet programeve</p>



	<p>bashkëkohore dhe që janë tashmë prezentë në shumicën me profil ekonomik. Nga verifikimi ynë, stafi akademik bashkë me studentet e programit sqaruan me detaje kryerjen e praktikës profesionale dhe listuan disa nga insitucionet që ky program ka bashkëpunim në kuadër të praktikës profesionale dhe më gjerë. Bazuar në emërtimin e programit, ky program është në përputhje me orientimet e Kornizës Shqiptare të Kualifikimit. Emërtimi i programit është në përputhje me drejtimin e tij në ekonomi dhe me gjerë.</p> <p><i>Ref. Shënime nga vizita në institucion</i></p> <p><i>Ev. 1.3 Propozim për hapjen dhe organizimin e programeve të studimit të ciklit të dytë</i></p> <p><i>Ev. Aneks Tabelat përmbledhëse _RVB, tabela 5, tabela 9</i></p>
<p>Kriteri 7. Në programin e studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve”, duhet të përfshihen elemente të mësimdhënies, module, lëndë ose i gjithë programi në gjuhë të huaj me qëllim thithjen e studentëve të huaj, rritjen e mobilitetit në kuadër të kërkimit shkencor dhe ndërkombëtarizimin e institucionit.</p>	<p>Megjithë që programi ofrohet në gjuhën shqipe, stafi akademik i angazhuar në këtë program zotëron gjuhë të huaja të vendeve të BE dhe mund të zhvillojë leksione në këto gjuhë. Nga vizita pranë institucionit, takimin me stafin që mbulon programin si dhe shqyrtimi i CV të stafit, evidentuam këtë fakt, aq më teper që pedagogje që zhvillojnë lëndë të caktuara kanë mbaruar studime jashte vendit apo kanë dhenë leksione në to në kuader të staff mobility të projekteve ERASMUS +. Nisur nga fakti që kemi të bëjmë me një program MSH që është i detyrueshëm zotërimi i gjuhës së huaj për studentët, kjo nuk përben pengesë por përparësi pasi keta të fundit e kanë të çertifikuar zotërimin e gjuhës se huaj sipas kerkesave ligjore. Në kuader të angazhimit të zhvillimit të leksioneve të hapura , janë zhvilluar të tilla në gjuhën angleze. Gjithashtu, në këto lëndë, por jo vetëm, si literaturë rekomanduese jepet në anglisht. Dhënia e lëndëve të veçanta në gjuhë të huaj, jep mundësinë në të ardhmen e realizimit të mobiliteteve nga studentë të universiteteve të huaja pranë institucionit në kuadër të programeve të ndryshme ERASMUS, etj.</p> <p><i>Ev. 2.6 Programet e lëndëve (syllabuset)</i></p> <p><i>Ref. Shënime nga vizita në institucion</i></p>
<p>Kriteri 8. Për programin studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve”, institucioni përgatit, ruan dhe arkivon të gjithë</p>	<p>Pranë institucionit ruhen dhe arkivohen në gjuhën angleze një pjesë e dokumentacionit të lidhur me programin si: programi i studimit, syllabuset, CV e personelit, marrëveshjet e bashkëpunimit, rregullore të brendshme, etj. Ky informacion ruhet në formë elektronike dhe hardcopy. Ruajtja e</p>



dokumentacionin dhe aktivitetin e zhvilluar edhe në gjuhën angleze	dokumentacionit respekton dhe konfidencialitetin e tyre, që është sanksionuar në rregulloret e institucionit. <i>Ev. 2.1.1 Plani mësimor i programit të studimit (anglisht)</i> <i>Ev. 2.6.1 Programet e lëndëve (syllabuset anglisht)</i> <i>Ev. 2.8 Suplementi i diplomës; Ref. Shënime nga vizita në institucion</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.4	
Programi i studimit është në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.	Organizimi i UT, struktura e tij hierarkike është e ndërtuar në mënyrë të tillë që të përmbushë misionin dhe objektivat e përcaktuara prej tij por edhe të programit MSH në “Ekonomiks”, duke pasur edhe përvojën, kapacitetet dhe burimet njerëzore të përshtatshme për një mision të tillë. Fakulteti i Ekonomisë dhe Departamenti i Ekonomiksit që mbulon këtë program studimi, arrijnë që nëpërmjet kualifikimit të nevojshëm dhe kapaciteteve akademike që ato kanë, të realizojnë me sukses zhvillimin e programit. Kështu, bazuar në organigramën e Fakultetit të Ekonomisë si njësi kryesore e programit, ai përfshin gjashtë Departamente me një personel akademik efektiv ((PAE) prej 175 punonjësish dhe që perfaqeson Fakultetin Ekonomik me të hershëm dhe më të madh në vend. <i>Ref. Shënime nga vizita në institucion</i> <i>Ev. Aneks Tabelat përmbledhëse _RVB, tabela 1, tabela 6.1</i>
Kriteri 2. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas	Programi MSH në: Ekonomiks funksionon në përputhje të plotë me Statutin dhe Rregulloren e UT, si dhe Rregulloren e Programit të Studimit. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit është relativisht në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore përgjegjëse për këtë






klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.	program studimi që është Fakulteti i Ekonomisë si një ndër Fakultetet e UT. <i>Ligji Nr. 80/2015</i> <i>Ev. 1.1 Statuti i UT</i> <i>Ev. Aneks Tabelat përmbledhëse _RVB</i>			
Kriteri 3. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje	Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit është plotësisht në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë përgjegjëse për këtë program studimi që është Departamenti i Ekonomiksit mbulon këtë program, i cili që në emërtim është i njëjtë me objektivin e këtij programi dhe që gjithashtu ka pjesën me të madhe të stafit të programit nga fusha e ekonomisë. <i>Ev. Aneks Tabelat përmbledhëse _RVB</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.5	
Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësisë profesionale, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësisë e personelit, marrjes së përgjegjësisë respektive dhe	Njësia bazë mësimore shkencore e realizimit të këtij programi është Departamenti i Ekonomiksit. Departamenti operon në dinamikën e tij duke zhvilluar takime dhe diskutime periodike për problematikën e mësimdhënies, kërkimit shkencor, etj. Ndër funksionet kryesore të Departamentit përmendim: shqyrtimin dhe miratimin e planeve mësimore, programeve të lëndëve (syllabuseve) si edhe propozimin e ndryshimeve që gjykohen të nevojshme; shqyrtimin dhe miratimin e propozimeve të

<p>analizës së vazhdueshme të punës së tyre.</p>	<p>përgjegjësve të grup-lëndëve për tekstet mësimore që do të përdoren në lëndët e programit të studimit; ndjekjen e realizimit të programit të studimit sipas planit të miratuar dhe mbikëqyrjen e cilësisë së mësimdhënies. Përgjegjësitë e kësaj njësie bazë si dhe të hallkave të tjera të Fakultetit janë të mirë përcaktuara në rregulloret përkatëse të institucionit dhe në rregulloren e Fakultetit. Përgjegjësi i departamentit përgjigjet për vlerësimin e performancës së personelit akademik të Departamentit gjatë vitit akademik. Kjo përfshin kryesisht korrektesën e tij në respektimin e orarit të punës, zhvillimin e mësimit dhe përmbushjen e detyrimeve të tjera akademike si edhe cilësinë e mësimdhënies në auditor dhe veprimtarinë e tij shkencore. Vlerësimet e mësipërme u evidentuan edhe gjatë vizitës në institucion.</p> <p><i>Ev. 1.1 Statuti i UT, neni 14, pika 5.a; neni 31, pika f</i></p> <p><i>Ref. Shënime nga vizita në institucion</i></p>
<p>Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit rezultojnë se UT ka nënshkruar një numër të konsiderueshëm marrëveshjesh me institucione të arsimit të lartë jashtë vendit dhe brenda vendit, si dhe me një numër institucionesh dhe subjektsh ekonomike shtetërore dhe private. Keto marrëveshje bashkëpunimi janë realizuar kryesisht nepermjet projekteve të perbashketa si Tempus, ERASMUS + ; IPA etj. Këto marrëveshje përfshijnë shkëmbime reciproke të vizitave akademike shkencore si dhe marrëdhënie të tjera reciproke në fushën e kualifikimit, shkëmbimit të eksperiencave, realizimit të praktikave mësimore etj. Gjatë vizitës në institucion u evidentua edhe përfshirja e lektorëve të huaj për të dhënë leksione për tema të veçanta, ku një temë specifike është trajtuar me studentët e këtij programi dhe të programeve të tjera në fushën e ekonomisë</p> <p><i>Ev. Aneks Tabelat përmbledhëse _RVB, tabela 5</i></p> <p><i>Ev. 1.13 Lista e pedagogeve të huaj në Dep Ekonomiksit</i></p> <p><i>Ev. 2.14 Lista e studentëve që kanë bërë mobilitete</i></p> <p><i>Ref. Shënime nga vizita në institucion</i></p>
<p>Kriteri 3. Për realizimin e programit të studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve”, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me</p>	<p>Nga shqyrtimi i dosjes së përcjellë dhe evidentimit gjatë vizitës në institucion, konstatohet se UT ka një sërë marrëveshjesh me institucione dhe sipërmarrje në funksion të realizimit të praktikës profesionale. Gjatë takimeve në FEUT, pedagogët u shprehën,</p>



<p>institucione, institute kërkimore, kompani, të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj.</p>	<p>por dhe studentët konfirmuan që pedagogët kontribuojnë në punësimin apo intershipet e tyre, përmes ndarjes së informacionit në auditor dhe mbështetjes në karrieren të tyre.</p> <p><i>Ev. 2.18 Lista e marrëveshjeve për realizimin e Praktikave Profesionale</i></p> <p><i>Ref. Shënime nga vizita në institucion</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni vendos marrëdhënie zyrtare e bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të natyrës specifike të programit të studimit që ofron.</p>	<p>Në realizimin e praktikës profesionale hartohet kontratë e përbashkët mes FE të UT dhe entit përkatës në funksion, kjo edhe të natyrës së programit studimor. U verifikua që institucioni ka të miratuar nga Dekani paketën e plotë të praktikës me të cilën paisen studentët e këtij programi. Kjo u konfirmua dhe nga takimi me studentët. Paketa përfshin procedurën e këtij procesi, programin e praktikës, vlerësimin e monitoruesit të saj, hartimin e një raporti nga studenti për praktiken e realizuar etj, në funksion edhe të realizimit të praktikës profesionale institucioni UT apo FE i UT ka 46 marrëveshje bashkëpunimi me institucione apo ente të ndryshme në vend me afate të caktuara apo edhe të pacaktuara mes paleve .</p> <p><i>Ev. Aneks Tabelat përmbledhëse _RVB, tabela 5</i></p> <p><i>Ev. 2.18 Lista e marrëveshjeve për realizimin e Praktikave Profesionale</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni garanton bashkëpunim me institucione homologe apo institute kërkimore shkencore me qëllim realizimin e kërkimeve shkencore dhe mobilitetit të personelit dhe studentëve.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e aplikimit pranë ASCAL-it institucioni ka një numer marrëveshje bashkëpunimi me institucione homologe të huaja të realizuara apo edhe në proces. Në kuader të projekteve ERASMUS + janë nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me universitete partnere, gjë që ka mundur të sigurojë mobilitete për stafin dhe studentet e këtij programi. Nga takimi me studentët u evidentua angazhimi i tyre në kërkim shkencor lidhur me përgatitjen e punimit të mikrotezës bazuar edhe në leksionet e hapura të organizuar nga lektorë të huaj në kuadër të këtyre projekteve.</p> <p><i>Ev. 1.14 Stafi i Dep Ekonomikist në projekte</i></p> <p><i>Ev. 2.14 Lista e studentëve që kanë bërë mobilitete</i></p>
<p>Kriteri 6. Në mënyrë periodike njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të</p>	<p>GVJ konstatoi se në analizën vjetore të departamentit diskutohet dhe mbi ecurinë e këtyre bashkëpunimeve, ecurinë e praktikave mësimore pranë këtyre institucioneve dhe përmirësimet që duhet të ketë bashkëpunimi në të ardhmen. Gjithashtu, në nivel Njësie kryesore përfitimet nga bashkëpunimi përfshihen në raportin</p>

realizimit të programit të studimit	<p>vjetor të FEUT-së. Kjo u konfirmua dhe nga bashkëbisedimet me stafin akademik dhe studentët e këtij PS.</p> <p><i>Ev. Aneks Tabelat përmbledhëse _RVB, tabela 5</i></p> <p><i>Ev. 6.11.1 Raporti FEUT 2020-2021, fq.6-9</i></p> <p><i>Ref. Shënime nga vizita në institucion</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X



Standardi I.6

Institucioni mbështet arritjet në studimet e thelluara dhe të kërkimit shkencor, të cilat promovohen dhe bëhen publike.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni ndjek një politikë mbështetëse për publikimet e rezultateve në fushën e kërkimit shkencor, veprimtarive kërkimore shkencore të personelit akademik dhe studentëve.</p>	<p>Konstatohet se UT synon të jetë aktiv në fushën e kërkimit shkencor të personelit akademik nepermjet nxitjes dhe mbështetjes se këtij procesi e theksuar kjo edhe në strategjinë e zhvillimit të institucionit 2018-2023. Në webin e institucionit u evidentuan si thirrjet e hapura për projekte ashtu edhe projektet kombetare fituese të kërkimit dhe zhvillimit “Horizon” apo ERASMUS+. Vete institucioni në kuader të programit “UT - kerkim ekselence, inovacion” ka mbështetur financiarisht nisma të stafit për publikimet e bëra nga personeli akademik si dhe veprimtari të tjera lidhur me kërkimet shkencore.</p> <p><i>Ev. 1.5 Plani i Kërkimit Shkencor të Universitetit të Tiranës (2018-2022)</i></p> <p><i>Ev. 1.11 Programi i grantit per prezantimin e punimeve në konferenca</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni ngre një njësi që vlerëson ecurinë e rezultateve në fushën e kërkimit shkencor.</p>	<p>Institucioni nuk ka njësi të veçantë për kërkimin shkencor por ky proces është pjese e Komisionit të Perhershëm të Sigurimit të Standardit të cilësisë i percaktuar në Statut si dhe të NJSBC të ngritura në nivel institucional dhe njësisë kryesore se fundmi. Në nivel të njësisë kryesore (FE i UT) kerkimi shkencor ndiqet nga një nga Zv.Dekanet si dhe NJSBC të FE si pjese e funksioneve që kjo njesi ka. Departamenti i Ekonomiksit si njësia bazë qe mbulon këtë program ndjek dhe analizon periodikisht (në analizat vjetore) punën kërkimore shkencore të stafit të saj. Gjithashtu, ndjekja e procesit kërkimor shkencor bëhet nga</p>



	<p>Zv.Dekani për kërkimin shkencor. Evidentimi i punës kërkimore shkencore të stafit akademik realizohet nëpërmjet raportimit të tyre vjetor, gjë që dokumentohet si pjesë e dosjeve individuale të tyre.</p> <p><i>Ref. Shënime nga vizita në institucion</i></p> <p><i>Ev. 1.6 Rregullore e Administratës së Rektoratit</i></p> <p><i>Ref. https://feut.edu.al/lajmerime/1600-fakulteti-i-ekonomise-ut-organizoi-konferencen-nderkombetare-me-teme-rebound-rebuild-and-reinvent-for-a-sustainable-and-equitable-development]</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni ndjek një politikë për promovimin e rezultateve në fushën e kërkimit shkencor.</p>	<p>Personeli akademik, krahas punës së pavarur kërkimore shkencore, promovohet nëpërmjet përfshirjes në projektet kërkimore të fituara nga institucioni, duke bërë të mundur publikimin e tyre dhe në disa raste mbështetjen financiare. Punime shkencore të personelit akademik janë botuar në revistat shkencore të Fakulteteve të UT. Njesia kryesore që mbulon kete program FE i UT boton revistën e tij “Ekonomia dhe Biznesi” me Bord Shkencor si dhe janë promovuar botime në revista të huaja me faktor impakti.</p> <p><i>Ev.1.1. Statuti i UT</i></p> <p><i>Ev. 1.5 Plani i Kërkimit Shkencor të Universitetit të Tiranës (2018-2022)</i></p> <p><i>Ev. 2.25 Workshopte e projekteve kërkimore</i></p> <p><i>Ref. Shënime nga vizita në institucion</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni ndjek një politikë për mbrojtjen e pronësisë intelektuale, si dhe praktikën e mirë në veprimtarinë kërkimore-botuese.</p>	<p>Kopje të punimeve shkencore janë të arkivuara në bibliotekën e UT dhe në dosjet përkatëse të personelit, të cilat u panë në mënyrë të rastësishme edhe gjatë vizitës në institucion. Në botimet e publikuara në revistat e njesive kryesore të UT theksohet pronësia intelektuale e tyre me qellim minimizimin e plagjiaturave.</p> <p><i>Ev. 1.5 Plani i Kërkimit Shkencor të Universitetit të Tiranës (2018-2022)</i></p> <p><i>Ref. Shënime nga vizita në institucion</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni inkurajon studentët dhe kërkuesit e rinj për ndërmarrjen e iniciativave</p>	<p>Institucioni ka angazhuar studentë në projektet ku është partnere si dhe në ndihmë të kërkimeve shkencore që realizon personeli akademik sidomos në anketime dhe përpunim të dhënash. Shpesh kjo punë e tyre materializohet në punimin e mikrotezes. Bashkëpunimi në punë shkencore të studeteve ka bere që të</p>

vetjake në fushën e kërkimit shkencor	<p>botohen në revisten e FE të UT artikuj të perbashkët pedagog student. Po ashtu në konferenca kombetare dhe nderkombetare të organizuara nga FE i UT apo vete Departamenti i Ekonomiksit ka pjesëmarrje të studenteve të programeve mesimore të ciklit të dytë dhe të tretë.</p> <p><i>Ev. 1.5 Plani i Kërkimit Shkencor të Universitetit të Tiranës (2018-2022)</i></p> <p><i>Ev. 2.22 Puna shkencore 2018-2022</i></p> <p><i>Ref. Shënime nga vizita në institucion</i></p>
---------------------------------------	---

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X


II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË CIKLIT TË DYTË MASTER I SHKENCAVE/ARTEVE

Standardi II.1


Programet e studimit organizohen në përputhje me parashikimet ligjore e përcaktimet nënligjore kombëtare në fuqi për këto programe studimi.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Programi i studimit është i organizuar në lëndë e module, të vlerësuara në kredite, në përputhje me legjislacionin vendës në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).</p>	<p>Gjatë shqyrtimit të kurrikulës dhe programit të studimit “MSH në Ekonomiks”, GVJ konstatoi përputhshmërinë e këtij PS me legjislacionin në fuqi si dhe me Sistemit Evropian të Transferimit të Krediteve (ECTS). Njëkohësisht, referuar dokumentacionit të dorëzuar dhe vizitës në institucion, GVJ konstatoi se PS është program i ciklit të dytë, i organizuar në 4 semestra me një kohëzgjatje prej 2 vitesh akademike (60 ECTS /në vit, në total 120 ECTS). Plani mësimor është i organizuar në lëndë, ku çdo lëndë vlerësohet me kredite (ECTS). Në total ky PS ka 14 lëndë, nga të cilat 12 janë të detyrueshme dhe 2 me zgjedhje.</p> <p><i>GVJ sugjeron, duke u bazuar në metodologjinë e përcaktimit të krediteve për lëndët e veçanta si dhe në mjaft eksperiencë të programeve në universitete të tjera, numri i krediteve të përcaktuara, duhet të luhatet në funksion të ngarkesës (angazhimit) në auditor dhe jashtë tij të studentit që mund të ndryshojnë për lende të veçanta.</i></p> <p><i>Ev. 1.1 Statuti, neni 92</i></p> <p><i>Ev. 1.4 Rregullore e programit të studimit MSH në Ekonomiks</i></p> <p><i>Ev. 2.1 Plani mësimor i programit</i></p> <p><i>Ev. Aneks Tabelat përmbledhëse _RVB, tabela nr.10</i></p> <p><i>Ref. Shënime nga vizita në institucion</i></p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” synon formimin e shprehive të veçanta në një llojshmëri të gjerë profesionale e specialitetesh.</p>	<p>Duke u bazuar në DVV dhe specifikisht në planin mësimor të këtij Ps, GVJ vlerëson me nota pozitive kontekstin e lëndëve të ofruara për këtë PS, i cili mundëson formim teorik të thelluar në fushën e Ekonomiksit. Njëkohësisht, kurrikula i jep mundësi studentit që të marrë një formim specifik në fushën e statistikës, financës dhe menaxhimit në vartësi të dëshirave dhe rrethanave që i paraqiten nëpërmjet lëndëve me zgjedhje. Gjithashtu, lëndët e zhvilluara gjatë programit kombinojnë studimin rigoroz analitik me studimin e detajuar të problemeve dhe situatave aktuale ekonomike. GVJ është e mendimit se PS i shërben formimit të shprehive të veçanta</p>

	<p>në një nga profilet, dhe krijon mundësi më të mëdha punësimi në institucione qëndrore dhe vendore, apo në sipërmarrje private, etj.</p> <p><i>Ev. 2.2 Propozim për hapjen dhe organizimin e programeve të studimit të ciklit të dytë, fq. 1-2</i></p> <p><i>Ev. 2.1 Plani mësimor i programit të studimit</i></p>
<p>Kriteri 3. Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” jep njohuri të përparuara në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës.</p>	<p>Programi bazohet mbi njohuritë e marra në ciklin e parë të studimit. Nga shqyrtimi i syllabuseve vihet re që ka tema të cilat japin një trajtim të shpejtë të koncepteve të marra në programin Bachelor sipas fushës që mbulon lënda përkatëse. Ky trajtim është i domosdoshëm në kushtet kur këtë program kanë mundësinë që ta ndjekin edhe studentë që nuk kanë mbaruar studimet e ciklit të parë në fushën e ekonomisë. Ashtu sic parashikohet dhe në legjislacionin në fuqi, lëndët bazë dhe lëndët karakterizuese (Veprimtaria A+B) të programit “MSH në Ekonomiks” kanë peshën kryesore të krediteve dhe orëve mësimore, prej rreth 60% të ECTS, si psh. Mikroekonometri 3, Makroekonometri 3, Ekonometri, Elementë të Optimizimit, Ekonomiks Zhvillimi, Ekonomiks i Sektorit Publik, Ekonomiks Financiar, Makroekonomi e hapur-Financa Ndërkombëtare, Tregti Ndërkombëtare-Teori dhe politika, etj. GVJ është e mendimit se PS i shërben formimit të shprehive të veçanta në një nga profilet, dhe krijon mundësi më të mëdha punësimi në institucione qëndrore dhe vendore, apo në sipërmarrje private, etj.</p> <p><i>Ev. 2.1 Plani mësimor i programit të studimit</i></p> <p><i>Ev 2.7 CV-të e personelit akademik efektiv</i></p>
<p>Kriteri 4. Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të avancuara në një fushë akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.</p>	<p>GVJ mbasi shqyrtoi të gjithë dokumentacionin që ndodhej në DVV si plani strategjik për zhvillimin e programit të studimit, kurrikula e programit të studimit, plani mësimor, syllabuset e lëndëve, si dhe nga informacioni i siguruar nga takimet me drejtues të njësisë kryesore dhe asaj bazë, personelin akademik dhe studentët e programit të studimit, është i mendimit se ky program studimi iu ofron studentëve njohuri të thelluara në fushën e ekonomisë dhe i aftëson studentët për punë të pavarur në sektorë të ndryshëm të ekonomisë.</p> <p><i>Ev. 2.2 Propozim për hapjen dhe organizimin e programeve të studimit të ciklit të dytë</i></p> <p><i>Ev. 2.6 Programet e lëndëve (syllabuset)</i></p>



<p>Kriteri 5. Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” përmban të gjitha elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit të përcaktuara në akte ligjore e nënligjore.</p>	<p>Nga shqyrtimi i këtij programi studimi rezulton se ai përfshin të gjithë elementët strukturor të përcaktuara në aktet ligjore dhe rregullative që kanë objekt arsimin e lartë në Shqipëri, të tilla si numri i krediteve, kohëzgjatja e tij, sistemi i vlerësimit me kredite, kategorizimi i lëndëve, praktika profesionale, finalizimi i perfundimit të programit nepermjet mbrojtjes me një punim mikroteze etj.</p> <p><i>Ev. 1.4 Rregullore e programit të studimit MSH në Ekonomiks</i> <i>Ev. 2.1 Plani mësimor i programit të studimit</i> <i>Ev. 2.6 Programet e lëndëve (syllabuset)</i></p>
<p>Kriteri 6. Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” ka të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese, duke grupuar lëndët / modulet sipas kategorive të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite.</p>	<p>Programi i studimit ofrohet me 120 ETCS (ku përfshihen 15 lëndë, praktika dhe detyrimet përmblyëse me mbrojtjen e punimit të mikrotezes) dhe me kohëzgjatje 2 vite akademike. Bazuar në VKM Nr.41, datë 24.01.2018, i ndryshuar, sipas kategorizimit të lëndëve të paraqitura në programin e studimit rezulton se:</p> <ul style="list-style-type: none"> - lëndët bazë (kategoria A) kanë 7.5 ECTS ose 6.25% të krediteve, - lëndët karakterizuese (kategoria B) kanë 64.5 ECTS, ose 53.75 % të krediteve, - lëndët integruese (kategoria C) kanë 18 ECTS që zënë 15% të krediteve, - lëndët plotësuese (kategoria D) kanë 12 ECTS ose 10% të krediteve, - kategoria E e detyrimeve përmblyëse përmban 18 ECTS ose 15% të krediteve të PS. <p>Bazuar në kriteret e miratuara për një program MSH shohim se struktura e programit përmbush kriteret e vendosura.</p> <p><i>Ev. 2.1 Plani mësimor i programit të studimit</i> <i>Ev. Aneks Tabelat përmbledhëse _RVB, tabela 9</i></p>
<p>Kriteri 7. Programi i studimit ka të përcaktuar kreditet për realizimin e diplomës dhe aktivitetet kërkimore në kuadër të zhvillimit të saj</p>	<p>Programi i studimit përmban punimin e diplomës, ose e përcaktuar ndyshe si mikroeteza, e cila parashikon në total 18 kredite. Studenti ka në dispozicion orë në auditor, që konsiderohen të rëndësishme nën drejtimin e një pedagogun, i cili asiston në përzgjedhjen e literaturës, përdorimin e programeve kompjuterike për ndërtimin e modeleve ekonometrike, etj. Njëkohësisht, studenti ka kohë të dedikuar për kërkimin individual, i cili monitorohet nga udhëheqësi</p>




	<p>i specializuar në fushën përkatëse të temës të studentit. GVJ konstatoi që mënyra e zhvillimit, mbikëqyrja dhe vlerësimi praktikës janë të parashikuara në rregulloren e IAL-së dhe rregulloren e programit të studimit.</p> <p><i>Ev. Aneks Tabelat përmbledhëse _RVB, tabela 10</i></p> <p><i>Ev. 2.3 Format vlerësimi _mikroteze _master _shkencor</i></p> <p><i>Ev. 2.4 Lista e drejtuesve të mikrotezave/praktikave</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.2

Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore për vlerësimin dhe akreditimin.</p>	<p>UT, në funksion të përmbushjes së misionit dhe objektivave si Institucion i Arsimit të Lartë Publik, është i organizuar dhe i përbërë me një strukturë hierarkike të tillë që të përmbushë dhe objektivat e programit MSH në “Ekonomiks”. Fakulteti i Ekonomisë, (si një nga 7 fakultetet e UT) si njësi kryesore e këtij programi me një historik tashme prej rreth 65 vitesh përfshin 6 njësi bazë ku Departamenti i Ekonomiksit si një prej tyre është përgjegjës i zhvillimit të këtij programi duke përmbushur plotësisht kriteret ligjore dhe aktet nënligjore në fuqi. UT i është akorduar akreditimi institucional me Vendim BA Nr. 84, datë 27.10.2018, me kohëzgjatje 4 vite akademike, afati vlefshmërisë deri më 26.10.2022.</p> <p><i>Ev. 1.1 Statuti i UT-së, nenet-12 13;</i></p> <p><i>Ev. 1.8 Rregullore e UT-së e përditësuar, kreu II</i></p>
<p>Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.</p>	<p>Njësia kryesore përgjegjëse për programin e studimit është Fakulteti i Ekonomisë, i cili përbëhet nga 6 njësi bazë të cilat përmbushin kriteret ligjore për njësitë bazë. Këto njësi janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Departamenti i Ekonomiksit; • Departamenti i Financës; • Departamenti i Kontabilitetit;



<p>Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore për numrin dhe nivelin e kualifikimit të personelit akademik, raportet midis personelit me kohë të plotë, të pjesshme dhe të ftuar.</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Departamenti i Marketing Turizmit; • Departamenti i Menaxhimit; • Departamenti i Statistikë Informatikë e Zbatuar; <p>Të gjitha Njësitet bazë ofrojnë programe studimi në të tre ciklet e studimit. Departamenti i Ekonomiksit ka aktive 3 programe studimi, që i përkasin tre niveleve të studimit, dhe një nga të cilët është "MSH në Ekonomiks". Struktura, detyrat dhe përgjegjësitë e Njësisë kryesore dhe asaj bazë që është përgjegjëse për PS "MSH në Ekonomiks" janë të përcaktuara në statutin e institucionit dhe janë në përputhje me Ligjin 80/2015 të Arsimit të Lartë. Dekani i Fakultetit dhe Përgjegjësi i Departamentit të Ekonomiksit mbajnë titullin akademik "Profesor". GVJ konstatoi që organizimi dhe struktura akademike përmbushin detyrimet ligjore në fuqi.</p> <p><i>Ev. Aneks Tabelat përmbledhëse _RVB, tabela nr.1, tabela nr. 3</i></p> <p><i>Ev. Statuti i UT-së, neni 12</i></p> <p><i>Ev. 1.1 Statuti i UT-së, nenet-12 dhe 14</i></p>																				
<p>Kriteri 4. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.</p>	<p>FEUT në vitin akademik 2021-2022, është i përberë nga 464 Personel Akademik gjithsej, nga ku 175 Personel Akademik Efektiv (PAE), dhe 289 Personel Akademik me Kontratë (PAK), të cilët kanë kualifikimin si më poshtë Përsa i përket njësisë bazë, personeli akademik për vitin akademik 2021-2022 është si më poshtë:</p> <p>Departamenti i Ekopnomiksit si njësia bazë përgjegjëse për programin e studimit në vitin akademik 2021-2022 ka këtë paraqitje:</p> <table border="1" data-bbox="576 1294 1385 1525"> <thead> <tr> <th rowspan="2">Kualifikimi i stafit</th> <th colspan="2">Departamenti i Ekonomiksit</th> </tr> <tr> <th>PAE</th> <th>PAK</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>Prof.Dr</td> <td>5</td> <td>5</td> </tr> <tr> <td>Prof.Asoc</td> <td>11</td> <td>-</td> </tr> <tr> <td>Dr/PhD</td> <td>13</td> <td>6</td> </tr> <tr> <td>Msc</td> <td>7</td> <td>11</td> </tr> <tr> <td>Gjithsej</td> <td>36</td> <td>22</td> </tr> </tbody> </table> <p>Në vitin akademik 2021-2022 Departamenti përbëhej nga 36 anëtarë personel akademik me kohë të plotë, nga të cilët 29 anëtarë të personelit akademik të brendshëm kanë grada dhe tituj shkencor, duke plotësuar në mënyrë optimale kriteret ligjore dhe standardet për të ofruar programin e studimit. Përsa më sipër GVJ konstatoi se</p>	Kualifikimi i stafit	Departamenti i Ekonomiksit		PAE	PAK	Prof.Dr	5	5	Prof.Asoc	11	-	Dr/PhD	13	6	Msc	7	11	Gjithsej	36	22
Kualifikimi i stafit	Departamenti i Ekonomiksit																				
	PAE	PAK																			
Prof.Dr	5	5																			
Prof.Asoc	11	-																			
Dr/PhD	13	6																			
Msc	7	11																			
Gjithsej	36	22																			





	<p>njësia bazë i plotëson më së miri detyrimet ligjore për numrin dhe nivelin e kualifikimit të personelit akademik.</p> <p>Përsa i përket tre viteve të fundit, Departamenti i Ekonomiksit ka patur raportet PAE/PAK si më poshtë:</p> <p>Për vitin akademik 2019-2020, (30 PAE / 26 PAK), nga këta me grada/tituj shkencore 25/12;</p> <p>Për vitin akademik 2020-2021, (35 PAE / 20 PAK) nga këta me grada/tituj shkencore 27/7.</p> <p>Për vitin akademik 2021-2022, (36 PAE / 22 PAK) nga këta me grada/tituj shkencore 29/11.</p> <p>GVJ konkludon që Njësia kryesore dhe Njësia bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbushin detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.</p> <p><i>Ev. 1.1 Statuti, neni 12, neni 19</i></p> <p><i>Ev. Aneks Tabelat përmbledhëse _RVB, tabelat nr. 1 dhe 2</i></p> <p><i>Ev. 2.7 CV-të e personelit akademik efektiv</i></p> <p><i>Ev. Aneks Tabelat përmbledhëse _RVB, tabelat nr. 6.1, 6.2 dhe 6.3</i></p>
<p>Kriteri 5. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit angazhon personel akademik ndihmës për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, projekteve studimore e kërkimore etj.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit të aplikimit nga institucioni si dhe nga takimet e realizuara gjatë vizites në institucion Departamenti angazhon personel akademik për të ndjekur ecurinë e zhvillimit të praktikave të studenteve në semestrin e katër të programit. Gjithashtu personeli ndihmës që është në strukturën e Departamentit angazhohet në zhvillimin korrekt të mesimeve laboratorike dhe dorezimin e projekteve nga studentet e programit.</p> <p><i>Ev. 2.4 Lista e drejtuesve të mikrotezave/praktikave</i></p> <p><i>Ev. 2.11 Paketa e dokumentave të praktikës mësimore</i></p> <p><i>Ref. Shënime nga vizita në institucion</i></p>
<p>Kriteri 6. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale</p>	<p>GVJ konstatoi nga DVV dhe vizita në institucion që përgjegjësi i Departamentit është edhe Koordinator i Programit të Studimit. Koordinator i programit, përcjell shqetësimet e studentëve në lidhje me realizimin e programit mësimor në përputhje me planin e miratuar, respektimin e orarit të mësimdhënies nga personeli akademik, cilësinë e sallave të leksioneve dhe seminareve, materialet didaktike etj. Gjithashtu ai është përgjegjës për realizimin e praktikave dhe të përmbushjes së të gjitha elementeve të procesit mësimor. Përgjegjësi i Departamentit mbikqyr</p>

në përputhje me objektivat e tij.	veprimtaritë mësimore dhe kërkimore/shkencore në departament, në përputhje me planifikimin vjetor, mban dokumentacionin e aktivitetit shkencor e akademik të personelit akademik, pas raportimeve në analizën vjetore të tij. <i>[Ev. 1.1 Statuti, neni 51, fq.33; Ev. 1.8 Rregullore e Univesitetit të Tiranës, neni 24, fq.16; Ref. Shënime nga vizita në institucion]</i>			
Kriteri 7. Koordinator i programit raporton në mënyrë periodike te drejtuesi i njësisë përgjegjëse dhe dokumenton çdo informacion që lidhet me programin e studimit	GVJ konstatoi nga DVV që një nga detyrat e koordinatorit është hartimi i raportit periodik vjetor mbi arritjen e objektivave formuese të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe aftësimit profesional, i cili duhet të analizohet në mbledhjen e departamentit përkatës. Pjesë e detyrave të tij është dhe dokumenimi dhe ruajtja e informacionit që ka të bëjë me realizimin e programit të studimit. <i>Ev. 6.5.1 Raporti vjetor i Departamentit viti akademik 2020-2021</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.3	
Programi i studimit MSH/MA është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të dytë.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programin e studimit të ciklit të dytë, disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit.	Referuar DVV dhe vizitës në institucion, GVJ konstatoi se FEUT dhe Departamenti i Ekonomiksit disponojnë informacion të plotë lidhur me PS "Master Shkencor në Ekonomiks", siç janë rregullore e programit të studimit, kuotat e pranimit, plani mësimor, informacion mbi strukturën akademike, syllabuset e lëndëve, personelin akademik të programit të studimit dhe CV e tyre, cilësinë në hyrje dhe në dalje të studentëve, etj. GVJ konstatoi se organizimi dhe struktura e këtij programi janë publikuar në website-n e FEUT-së. <i>Ev. 1.4 Rregullore e programit të studimit MSH në Ekonomiks</i> <i>Ev. 2.1 Plani mësimor i programit të studimit</i> <i>Ev. 2.2 Propozim për hapjen dhe organizimin e programeve të studimit të ciklit të dytë</i> <i>Ev. 2.6 Programet e lëndëve (syllabuset)</i>

<p>Kriteri 2. Programi i studimit organizohet në lëndë, module, praktikë e aktivitete formuese, në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi.</p>	<p><i>Ev. Aneks Tabelat përmbledhëse _RVB, tabela 21</i></p> <p>Programi i studimit është organizuar në 14 lëndë, nga të cilat 12 lëndë të detyrueshme dhe 2 lëndë me zgjedhje. Pjesë e programit të studimit janë dhe praktika mësimore dhe mikroteza. Në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi programi studimit përmban:</p> <ul style="list-style-type: none"> - A. Lëndë bazë: përgatitje metodologjike dhe kulturë e përgjithshme: 1 lëndë. - B. Lëndë të formimit karakterizues, përgatitje për disiplinën shkencore: 10 lëndë. - C. Lëndë Ndërdisciplinore/Integruese: Lëndë të formimit të ngjashëm ose/dhe integruese me lëndët karakterizuese si dhe lëndë formuese të zgjedhura nga studentët: 3 lëndë. - D. Lëndë Plotësuese: Lëndë formuese dhe aktivitete që lidhen me përfitim të aftësive për të lehtësuar hyrjen në tregun e punës si: për njohje të gjuhës së huaj, informatikës, praktikë: Praktika. - E. Detyrime Përmblylëse: Teza e diplomës: <p>GVJ konstatoi që organizimi i programit të studimit në lëndë dhe aktivitete formuese është në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi si Ligji 80/2015 dhe VKM Nr. 41. Gjithashtu, shpërndarja e lëndëve sipas kategorive A, B, C, D dhe E janë në përputhje me kërkesat ligjore. <i>Ev. Aneks Tabelat përmbledhëse _RVB, tabela 9-10</i></p>
<p>Kriteri 3. Programi i studimit organizohet në lëndë e module, të vlerësuara me kredite sipas sistemit vendës e evropian, të ndara në vite e semestra.</p>	<p>GVJ konstatoi që ndarja e lëndëve në semestra dhe vite akademike është në përputhje me aktet ligjore në fuqi. Lëndët e programit të studimit janë të vlerësuara në kredite dhe për secilën prej tyre jepet ngarkesa në orë në auditor/jashtë auditorit të shpërndara sipas formave të mësimdhënies siç parashikohet në Ligjin Nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në IAL" dhe VKM Nr. 41 datë 24/01/2018 "Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e Arsimin të Lartë", të ndryshuar. Shpërndarja e krediteve sipas veprimtarive është:</p> <ul style="list-style-type: none"> - A. Lëndë bazë: 7.5 kredite. - B. Lëndë të formimit karakterizues, përgatitje për disiplinën shkencore: 64.5 kredite.

	<p>- C. Lëndë Ndërdisciplinore/Integruese: 18 kredite.</p> <p>- D. Lëndë Plotësuese: 12 kredite.</p> <p>- E. Detyrime Përmbyllëse: 18 kredite.</p> <p>Gjithashtu, plani mësimor i programit është hartuar duke mbajtur në konsideratë sistemin e krediteve europiane ku cdo kredit është 25 orë mësimore. GVJ vlerësoi pozitivisht këtë kriter.</p> <p><i>Ev. Aneks Tabelat përmbledhëse _RVB, tabela 9-10</i></p> <p><i>Ev. 2.1 Plani mësimor i programit të studimit</i></p>
<p>Kriteri 4. Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacion i nevojshëm për ngarkesën mësimore, orët në auditor/jashtë auditorit, frekuentimin/ndjekjen e programit dhe mënyrën e vlerësimit të dijeve etj.</p>	<p>Nga shqyrtimi i DVV dhe vizita në institucion, GVJ konstatoi se në planin mësimor të programit janë të pasqyruara informacionet lidhur me ngarkesën mësimore, orët në auditor/jashtë auditorit, numrin e provimeve. Specifikisht, ngarkesa mësimore totale në auditor është 1230 orë, kurse jashtë auditorit 1770 orë. GVJ konstatoi që plani mësimor është hartuar në përputhje me përcaktimet ligjore.</p> <p><i>Ref. Shënime nga vizita në institucion</i></p> <p><i>Ev. 2.1 Plani mësimor i programit të studimit</i></p> <p><i>Ev. 1.4 Rregullore e programit të studimit MSH në Ekonomiks, fq. 8</i></p> <p><i>Ev. 2.6 Programet e lëndëve (syllabuset)</i></p>
<p>Kriteri 5. Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.</p>	<p>GVJ konstatoi se kriteret e përgjithshme që aplikohen për pranimin në ciklin e dytë të studimeve janë përcaktuar në Statutin e UT-së. Gjithashtu në statut janë përcaktuar procedurat që duhet të ndiqen nga Njësitë kryesore për njohjen, ekuivalentimin dhe transferimin e studimeve të ciklit të dytë. Si porcedure vjetore, Senati akademik i UT –së, miraton kriteret specifike të pranimit në programin e studimit për vitin pasardhës dhe kuotat e pranimit duke u bazuar tek propozimet që vijnë nga departamentet përkatëse. Procesi i pranimit dhe regjistrimit administrohet nga sekretaria mësimore, nga komisionet <i>ad hoc</i> të ngritura në nivelin e Njësisë bazë nga Dekani i FEUT për përzgjedhjen e kandidatëve në përputhje me kuotat dhe kriteret e miratuara. Kriteret e pranimit bëhen publike të cilat vijnë në ndihmë të të interesuarve.</p> <p><i>Ev. 1.1 Statuti, neni 94, fq.58-59, neni 112, fq. 65</i></p> <p><i>Ev. 2.13 Kriteret e pranimit për vitin akademik 2020-2021 Cikli I II-të</i></p>

<p>Kriteri 6. Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset e detajuara) për secilën lëndë, për praktikat, seminarët apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.</p>	<p><i>Ev. 2.14 Kuotat Master i shkencave 2021 2022</i></p> <p>Nga shqyrtimi i programit të studimit rezulton se ai përfshin gjithë elementët përbërës formues teorik praktik për një program të nivelit MSH. Nga shqyrtimi i syllabuseve vërejmë se ato përmbajnë të gjithë elementët e përcaktuara në Vendimin e KM Nr.41, datë 24.01.2018, i ndryshuar, si :</p> <ul style="list-style-type: none"> • Emërtimi i lëndës/modulit • Viti/semestri kur zhvillohet lënda • Emri i pedagogut që do të zhvillojë lëndën • Vendi që zë lënda në formimin tërësor të studentit • Njohuritë paraprake që duhet të ketë studenti për përvetimin e lëndës • Çfarë njohurish dhe aftësish i jep studentit kjo lëndë • Temat që do të trajtojë lënda në formimin teorik dhe praktik • Ngarkesa në orë në auditor dhe jashtë auditorit si dhe në ECTS • Format dhe metodat e mësimdhënies të lëndës dhe raportet midis tyre • Format e vlerësimit të studentëve • Detyrimet e studentit për lëndën • Literatura e detyruar dhe ajo ndihmëse <p>Nga verifikimi i dokumentacionit dhe vizita në institucion rezulton kontroll periodik i njohurive të marra me anë të testeve apo provimit përfundimtar. Format e vlerësimit të mësimdhënies janë nëpërmjet vlerësimit periodik në seminare (për pjesëmarrje aktive), detyra kursi, provime të ndërmjetme dhe provim final.</p> <p><i>Ev. 1.1 Statuti neni 104, fq. 163</i></p> <p><i>Ev. 2.6 Programet e lëndëve (syllabuset)</i></p>
<p>Kriteri 7. Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen</p>	<p>Programi i studimit është hapur në vitin akademik 2011-2012 dhe është riorganizuar në vitin akademik 2019-2020 pas hyrjes në fuqi të VKM 41, 24.1.2018, për t'u përshtatur me kërkesat e vendimit. GVJ konstatoi se ndryshimet për shkak të ndryshimit të kuadrit ligjor janë: ndryshime në shpërndarjen e krediteve për</p>



ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë në shqip dhe anglisht	çdo lëndë, praktikën dhe mikrotezën, grupimin e lëndëve sipas tipit të veprimtarive, ndryshimet në formatin e syllabuseve (në tema të veçanta të tyre), ndryshimet në literaturë, etj. GVJ konstatoi konsolidimin e PS përsa i përket përmajtjes së tij dhe strukturës së përgjithshme. <i>Ev. 2.1 Plani mësimor i programit të studimit</i> <i>Ev. Aneks Tabelat përmbledhëse _RVB, tabela 10-11</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.4


Struktura dhe organizimi i programit të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Ngarkesa e programit të studimit “Master i Shkencave”/“Master i Arteve” është strukturuar në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi.	Ky program studimi plotëson kërkesat ligjore (neni 75, pika 6 e Ligjit të Arsimit të Lartë dhe kerkimit shkencor në RSH, nr.80/2015) dhe nënligjore në fuqi. Ai realizohet me një ngarkesë mësimore, shkencore dhe praktike me 120 ECTS dhe me afat kohor dy vite akademike. Në program perfshihen një ngarkese prej 1230 ore mesimore në auditor dhe kurse jashtë auditorit 1770 orë. Shpërndarja e kësaj ngarkese është uniforme në të katër semestrat përkatës. <i>Ev. 2.1 Plani mësimor i programit të studimit</i> <i>Ev. 2.8.1 Formatit i diplomës</i>
Kriteri 2. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve.	Nga shqyrtimi i programit shohim që në përmbajtjen e tij ai ofron tiparet e një programi të nivelit të dytë në fushën e Ekonomiksit. Programi ndërtohet mbi njohuritë e fituara në ciklin e parë të studimit dhe thellon njohuritë dhe aftësitë e studentëve në përputhje me kriteret e vendosura. Vendosja e lëndëve në planin mësimor është bërë duke marr në konsideratë thellimin e njohurive ekzistuesve, marrjen e njohurive të reja dhe aplikimin e tyre në projekte apo detyra, si dhe në punimin e diplomës. GVJ duke iu refruar përmbajtjes së planit mësimor, emërtesës së lëndëve dhe syllabuseve të lëndëve konkludon që program

	<p>studimit mundëson marrjen e njohurive të reja, i pajisë dhe aftëson studentët me njohuri për tëu futur në tregun e punës.</p> <p><i>Ev. 2.1 Plani mësimor i programit të studimit</i></p> <p><i>Ev. 2.6 Programet e lëndëve (syllabuset)</i></p>
<p>Kriteri 3. Lëndët/ modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe kërkimit shkencor.</p>	<p>Ngarkesa e programit të studimit është shpërndarë në mënyrë të barabartë në të dy semestrat. GVJ është i mendimit se shpërndarja e lëndëve dhe krediteve për çdo lëndë mundëson arritjen e objektivave formuese të programit të studimit dhe arritjen rezultateve të pritshme të të nxënit. Shpërndarja e ngarkesës është e njëjtë mes semestrave duke i dhënë një ngarkesë të njëjtë studentëve. Shpërndarja e lëndëve, është e tillë që në semestrin e parë mundëson marrjen e njohurive bazë dhe formuse të avancuara në Mikroekonomimi, Makroekonomi, Elementë të Optimizimit dhe Ekonometri, Këto lëndë zhvillohen me 5 orë në javë dhe kanë 7.5 kredite. Marrja e këtyre njohurive mundëson arritjen e objektivave formues të programit dhe i aftëson studentët në aplikimin e tyre në disiplina të veçanta të Ekonomiksit. Lëndët e tjera zhvillohen 4 orë në javë dhe kanë 6 kredite.</p> <p><i>Ev. 2.1 Plani mësimor i programit të studimit</i></p> <p><i>Ev. 2.6 Programet e lëndëve (syllabuset)</i></p>
<p>Kriteri 4. Struktura e programit të studimit, lëndët dhe emërtimi i tyre, ngarkesa në kredite, raporti teori-praktikë është në përputhje me profilin e programit master dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare.</p>	<p>Programit i studimit “MSH në Ekonomiks” është hartuar, organizuar dhe rishikuar bazuar në programe të ngjashme ndërkombëtare dhe në sistemin European të Transferimit dhe Mbledhjes së Krediteve (ECTS). Specifikisht, raporti leksione/seminare/ushtrime në lëndët e semestrit të parë është 3/0.5/1.5, ndërsa në lëndët e tjera është 2/1/1. Gjithashtu, shpërndarja e orëve sipas veprimtarive formuese leksione/seminare/ushtrime është në përputhje me profilin e programit. Duke iu referuar DVV dhe takimeve në institucion me drejtuesit e njësisë bazë dhe kryesore, rezultoi që shpërndarja lëndore, numri i lëndëve, kreditet e çdo lënde, janë të ngjashme me programe të përafërta të universiteteve evropiane. Kjo lehtëson dhe lëvizjet e studentëve nga një univeristet në tjetrin.</p> <p><i>Ev. Aneks Tabelat përmbledhëse _RVB, tabela 9, 10 dhe 13</i></p> <p><i>Ev. 2.14 Lista e studentëve që kanë bërë mobilitetë</i></p> <p><i>Ev. 2.15 Njohja e lëndëve nga programet e mobilitetit</i></p>

<p>Kriteri 5. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.</p>	<p>Përqindja e lëndëve sipas veprimtarive formuese është sipas përqindjeve të parashikura në VKM 41, datë 24.01.2018. Format e zhvillimit të procesit mësimor janë të larmishme (leksione, seminare, detyra praktike, detyra kursi, provime të ndërmjetëme, provime përfundimtare) dhe krijojnë një balance midis formimit teorik dhe atij praktik. GVJ mbështetur në DVV, takimet me personelin akademik dhe studentët konstatoi që lëndët e përfshira në planin mësimor dhe format e zhvillimit të procesit mësimor mundësojnë arritjen e objektivave formuese. Ndarja sipas veprimtarive formuese mundëson gjithashtu transferimin e studimeve.</p> <p><i>Ev. 2.6 Programet e lëndëve (syllabuset)</i></p> <p><i>Ev. 2.14 Lista e studentëve që kanë bërë mobilitete</i></p> <p><i>Ev. 2.15 Njohja e lëndëve nga programet e mobilitetit</i></p> <p><i>Ev. 2.16 Mobilitete të personelit akademik të huaj pedagogu pritës</i></p> <p><i>Ref. Shënime nga vizita në institucion</i></p>
<p>Kriteri 6. Syllabuset (programet e lëndëve/ moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme duke u bazuar në literaturë të detyruar dhe ndihmëse të 5 viteve të fundit.</p>	<p>FEUT ka procedura të miratuara për përmirësimin e vazhdueshëm të programeve të studimit. Referuar dokumentacionit në DVV dhe takimeve me personelin akademik, GVJ konstatoi se syllabuset përditësohen vazhdimisht, si detyrim ndaj kërkesave ligjore, por edhe për të përditësuar literaturën. Gjatë bisedimeve me stafin akademik, GVJ u informua se FEUT përdor materiale mësimore në gjuhën shqipe, gjuhën angleze dhe tekste të përkthyer nga anglishtja kryesisht.</p> <p><i>Ev. 1.1 Statuti, neni 105, fq.163</i></p> <p><i>Ev. 2.6 Programet e lëndëve (syllabuset)</i></p> <p><i>Ref. Shënime nga vizita në institucion</i></p>
<p>Kriteri 7. Përmbajtja e programit të studimit garanton përftimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara për programin e studimit të ciklit të dytë.</p>	<p>Programi MSH në “Ekonomiks” i pajis studentët që zotërojnë një diplomë Bachelor në fushën e ekonomisë apo fushave të ngjashme, me njohuri më të thelluara teorike dhe praktike të fushës së ekonomikut. GVJ konkludoi që plani mësimor përmban lëndë të detyrueshme dhe me zgjedhje që garantojnë përftimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara për programin e studimit. Specifikisht, ky PS mundëson marrjen e njohurive të thelluara në fushën e ekonomiksit nëpërmjet lëndëve si: Mikroekonomi 3 dhe Makroekonomi 3, por dhe lëndë</p>




	<p>që japin njohuri në fusha specifike si Ekonomiksi Financiar, Ekonomiksi Zhvillimit, Ekonomiksi i Sektorit Publik, Financa dhe Tregti Ndërkombëtare. Ndërsa lëndët me zgjedhje garantojnë përfitimin e dijeve në disa fusha financë, biznes.</p> <p><i>Ev.2.2 Propozim për hapjen dhe organizimin e programeve të studimit të ciklit të dytë</i></p> <p><i>Ev. 2.6 Programet e lëndëve (syllabuset)</i></p>
<p>Kriteri 8. Përmbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.</p>	<p>Programi i studimit "MSH në Ekonomiks" u mundëson studentëve që diplomohen në këtë program të hyjnë në tregun e punës ose të vazhdojnë studimet në programe të ciklit të tretë brenda apo jashtë vendit. Mundësia për të marrë 2 lëndë të ndryshme me zgjedhje nga 9 lëndë me zgjedhje që përmban programi i studimit, u krijojnë studentëve mundësi për të zgjedhur lëndë që u vlejshme për studime të mëtejshme në ciklin e tretë me drejtimin ekonomik, por edhe në drejtimeve të tjera të përafërta. Gjithashtu kjo ofertë u mundëson studentëve që të marrin njohuri në fusha për të cilat ka nevojë tregu i punës. GVJ konstatoi se programi i studimit mundëson si vazhdimin e studimeve të ciklit të tretë ashtu dhe daljen në tregun e punës në profile që janë të kërkuara.</p> <p><i>Ev. 2.2 Propozim për hapjen dhe organizimin e programeve të studimit të ciklit të dytë, fq.2</i></p> <p><i>Ev. 2.6 Programet e lëndëve (syllabuset)</i></p>
<p>Kriteri 9. Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut e punës, strukturat përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e bashkëpunëtorëve dhe partnerëve nga tregu i punës.</p>	<p>Departamenti i Ekonomiksit /FEUT tërheq mendimin e punëdhënësve përmes një pyetësi, për të marrë përshtypjet e tyre në lidhje me cilësinë e arsimit që ofron departamenti/FEUT dhe të vlerësojë cilësinë e programit akademik. Pyetësi ka të bëjë me studentët e diplomuar nga FEUT dhe të punësuar në sipërmarrje/institucione apo organizata të ndryshme. Pyetësi menaxhohet nga NJSBC dhe Zyra e Karrierës në bashkëpunim me Njësinë kryesore. Mendimet e studentëve të diplomuar dhe punëdhënësve shërbejnë për të përmirësuar përmbajtjen e programit të studimit. Referuar DVV dhe vizitës në institucion GVJ konkludoi ky është një instrument shumë i përshtatshëm për të kuptuar më mirë kërkesat e tregut të punës si dhe për të adresuar në të ardhmen ndryshime në planin mësimor në përputhje me kërkesat e tregut të punës.</p> <p><i>Ev. 6.2.3 Paketa e instrumentave të cilësisë, fq. 18-19</i></p>

	<i>Ev. 1.10 Studim i tregut të punës për studentët e diplomuar</i> <i>Ref. Shënime nga vizita në institucion</i>			
Kriteri 10. Kombinimi i veprimtarive të formimit teorik dhe shkencor, mundësojnë njohuri të avancuara për studime, kërkime, analiza dhe vijim të aktivitetit shkencor në ciklin e tretë të studimeve	GVJ konstatoi se plani mësimor i programit të studimit u mundëson studentëve marrjen e njohurive të thelluara teorike në Mikroekonomi, Makroekonomi, Ekonometri si dhe lëndë me njohuri të thelluara në fusha të ndryshme të ekonomiksit që u mundësojnë studentëve vazhdimin e studimeve në ciklin e tretë dhe/ose përfshirjen në punë kërkimore pranë institucioneve kërkuese. Gjithashtu, GVJ evidentoi se 10 prej studentëve të diplomuar nga ky program studimi janë rregjistruar si studentë në ciklin e tretë për vitin akademik 2021-2022. <i>Ev. 2.2 Propozim për hapjen dhe organizimin e programeve të studimit të ciklit të dytë, fq.2</i> <i>Ev. 2.6 Programet e lëndëve (syllabuset)</i> <i>Ev. 2.17 Lista e studentëve të pranuar në programin e ciklit të tretë</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nga përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X



Standardi II.5

Personeli akademik dhe ndihmësakademik që mbulon programin e studimit përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve”.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbushin kërkesat ligjore në fuqi.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit, të dhënat për stafin e angazhuar në mësimdhënie për programin Msc në “Ekonomiks” për gjatë tre viteve të fundit akademike janë si më poshtë: Për vitin akademik 2019-2020, (13 PAE / 2 PAK), nga këta me grada/tituj shkencore 12/2; Për vitin akademik 2020-2021, (14 PAE / 2 PAK) nga këta me grada/tituj shkencore 14/2. Për vitin akademik 2021-2022, (14 PAE / 1 PAK) nga këta me grada/tituj shkencore 14/1.




	<p>Në personelin akademik që jep mësim në këtë PS janë dhe dy PAE nga Departamenti i Financës dhe Departamenti i Statistikës dhe Informatikës së Aplikuar. Referuar dokumentacionit përkatës, GVJ konstatoi se personeli akademik me kohë të plotë mbulon më shumë se 86% të ngarkesës mësimore në tre vitet e fundit, pra mbi 70%.</p> <p><i>Ev. Aneks Tabelat përmbledhëse _RVB, tabelat 12.1, 12.2 dhe 12.3</i></p>
<p>Kriteri 2. Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme, që angazhohet në realizimin e programit të studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve”, ka nivelin e duhur të kualifikimit akademik për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e moduleve mësimore të programit të studimit.</p>	<p>PAE dhe PAK i anagazhuar në këtë program studimi janë me tituj dhe grada shkencore. Kualifikimi i personelit akademik efektiv që jep mësim në këtë program studimi është:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Në vitin akademik 2021-2022: 4 Prof. Dr; 7 Prof. As. Dr dhe 3 Dr. - Në vitin akademik 2020-2021: 4 Prof. Dr; 6 Prof. As. Dr dhe 4 Dr. - Në vitin akademik 2019-2020: 4 Prof. Dr; 4 Prof. As. Dr dhe 4 Dr, 1 Msc. <p>GVJ konstatoi se personeli akademik i angazhuar përmbush kërkesën ligjore të të pasurit së paku kualifikimin e një cikli pasardhës për të gjithë stafin akademik që mbulon programin e studimit.</p> <p><i>Ev. Aneks Tabelat përmbledhëse _RVB, tabelat 12.1, 12.2 dhe 12.3</i></p>
<p>Kriteri 3. Fusha akademike-kërkimore e përgjithshme dhe specifike e anëtarëve të personelit akademik, që mbulon programin e studimit, janë në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe specifikën e moduleve të tij.</p>	<p>Niveli i kualifikimit, fusha akademike-kërkimore e përgjithshme dhe specifike e anëtarëve të personelit akademik është në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe specifikën e moduleve të tij. Personeli akademik me kontratë që angazhohet në veprimtaritë mësimore, ka gjithashtu të gjitha kualifikimet dhe kompetencën për të zhvilluar me cilësi të lartë programin e lëndës. Mbështetur në CV-të e personelit GVJ konstatoi se fushat e tyre të interesit dhe kërkimit përputhen tërësisht me natyrën e moduleve që mbulojnë në këtë program studimi.</p> <p><i>Ev. Aneks Tabelat përmbledhëse _RVB, tabelat 12.1</i></p> <p><i>Ev. 2.6 Programet e lëndëve (syllabuset)</i></p> <p><i>Ev. 2.7 CV-të e personelit akademik efektiv</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me</p>	<p>GVJ konstatoi se në periudhën 2018-2022, FEUT ka 18 marrëveshje aktive me institucione të ndryshme publike,</p>






<p>institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.</p>	<p>sipërmarrje private dhe organizata për realizimin e praktikave profesionale në të dy ciklet e studimit. Personeli akademik përgjegjës për realizimin e praktikës profesionale ka eksperiencë në fushën e ekonomisë. Praktikant profesionale zhvillohen në institucionet me të cilat FEUT ka marrëveshje të formalizuara ndërinstitucionale, por edhe sipas marrëveshjeve afat shkurtër që diktohen nga nevojat dhe rrethanat e kryerjes së praktikës. Praktika udhëhiqet sipas një programi nga pedagogu përgjegjës i caktuar nga departamenti. GVJ konstatoi gjithashtu se në bashkëpunim me institucionet ku do kryhet praktika, caktohet dhe personeli i duhur e i kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale në institucionin pritës. Praktikant profesionale në ciklin e dytë udhëhiqen vetëm nga PAE me tituj dhe grada.</p> <p><i>Ev. 2.18 Lista e marrëveshjeve për realizimin e Praktikave Profesionale,</i></p> <p><i>Ev. 2.4 Lista e drejtuesve të mikrorezave/praktikave</i></p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmësimorshkencor të përshtatshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit</p>	<p>Dega e shërbimeve në FEUT garanton funksionimin e laboratorëve dhe përditëson programet e nevojshme për realizimin e seminareve /laboratorëve në modulet Ekonometri dhe Metoda kërkimi mbi politikat ekonomike–Modele ekonomike të kompjuterizuara) dhe realizimin e projekteve individuale të studentëve. GVJ konkludoi se angazhimi i stafit ndihmës është i vazhdueshëm dhe në mjaft raste bëhet në bashkëpunim me PAE, në funksion të realizimit dhe mbarëvajtjes së praktikave laboratorike dhe profesionale.</p> <p><i>Ev. 4.10 Të dhëna mbi kapacitetet e sallave dhe pajisjet_2</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

<p>Standardi II.6 Institucioni i arsimit të lartë inkurajon përfshirjen e studentëve dhe partnerëve në përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>





<p>Kriteri 1. Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut e punës, strukturat përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e bashkëpunëtorëve dhe partnerëve nga tregu i punës.</p>	<p>Sipas DVV, specifikisht sipas evidencës “<i>Procedura për përmirësimin e programeve të studimit</i>”, Departamenti i Ekonomiksit ka një procedurë të miratuar për përmirësimin e programeve të studimit. Sipas kësaj procedure përmirësimi i programit të studimit mund të ndodh ndër të tjera dhe për nevoja të tregut të punës, të sipërmarrjeve dhe bashkëpunëtorëve të institucionit. Duke u bazuar dhe tek diskutimet me stafin drejtues dhe atë akademik të këtij PS, GVJ konstatoi se Departamenti i Ekonomiksit ka kontakte të vazhdueshme me institucione partnere si: Banka Qendrore, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, INSTAT, Autoriteti i Konkurrencës dhe institucione të tjera, të cilat japin sugjerime të rëndësishme në lidhje me tregun e punës.</p> <p><i>Ev. 2.27 Procedura për përmirësimin e programeve të studimit</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni inkurajon dhe përfshin në diskutime në kuadër të përmirësimit të programit të studimit edhe studentët dhe strukturat e tyre. Propozimet diskutohen dhe reflektohen, nëse ato janë në funksion të përmirësimit të programit të studimit.</p>	<p>Marrja e mendimit të studentëve nëpërmjet pyetësorëve, takimeve të drejtpërdrejta të realizuara nga Përgjegjësi i Departamentit ose Dekani i Fakultetit, konsiderohen si kontribute të rëndësishme për përmirësimin e përmbajtjes së lëndëve/moduleve apo ngarkesës në kredite/orë apo raportet e veprimtarive formuese.</p> <p>Sipas DVV rezulton se në vitin 2021 një grup kërkimor i Departamentit të Ekonomiksit realizoi një studim mbi tregun e punës për studentët e diplomuar në të tre ciklet e studimit që mbulon departamenti. 12% e studentëve të ciklit të dytë janë shprehur që program i studimit ka nevojë për përmirësime. Gjatë vizitës në institucion GVJ konfirmoi që IAL do të merret në konsideratë rekomandimet gjatë rishikimit të PS.</p> <p><i>Ev. 1.9 Studim i tregut të punës për studentët e diplomuar në të gjitha ciklet e studimit të degës Ekonomiks, Dhjetor 2021</i></p> <p><i>Ref. Shënime nga vizita në institucion</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni mban kontakte dhe konsultohet në mënyrë të vazhdueshme me studentët e diplomuar dhe merr prej tyre propozime për përmirësimin e programit të studimit.</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion, GVJ u informua për mënyrën e kontaktimit me të diplomuarit, e cila realizohej përmes zyrës së karrierës. Gjithashtu, gjatë vizitës në institucion GVJ konstatoi se çdo vit organizohet takimi me studentët e Alumni, ku diskutohen tema të ndryshme që kanë të bëjnë me nevojën e përshtatjes dhe të rinovimit të programeve si dhe nevojën që ato të përhapin idetë dhe praktikat e reja. Studentët e diplomuar (alumni) vazhdimisht japin mendime dhe opinione në kuadër të përmirësimit të përmbajtjes së lëndëve/moduleve të programit të</p>






	<p>studimit, si dhe mbështesin aktivitete të ndyshme të këtij departamenti.</p> <p><i>Ev. 1.7 Organigrama FEUT</i></p> <p><i>Ev. 2.28 Formulari për përditësimin e të dhënave ALUMNI</i></p> <p><i>Ref. Shënime nga vizita në institucion</i></p>			
<p>Kriteri 4. Në bashkëpunim me institucione kërkimore e shkencore, publike e private, njësitë e pushtetit vendor etj., institucioni përditëson, përshtat dhe riorganizon programe të posaçme me fushë specifike studimi e kërkimi</p>	<p>UT ka procedura të miratuara që mundësojnë përshtatjen dhe riorganizimin e programeve të studimit në fusha specifike studimi dhe kërkimi. GVJ konstatoi se Departamenti i Ekonomiksit nuk ka identifikuar krijimin apo riorganizimin e një program të tillë.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

<p>Standardi II.7</p> <p>Programi i studimit garanton orientim në fushën e studimeve dhe kërkimit shkencor.</p>	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Programi i studimit përcakton qartë prioritetet dhe objektivat kryesorë të studimit dhe kërkimit shkencor në përputhje me objektivat madhorë të institucionit.</p>	<p>Në programin e studimit përcaktohen qartë objektivat kryesore të tij në funksion edhe të kërkimit shkencor nëpërmjet marrjes së njohurive të thelluara dhe të avancuara në fushën e ekonomiksit të cilat janë pjese e objektiveve madhore të institucionit.</p> <p><i>Ev. 1.2 Strategjia e zhvillimit të UT-së (2018-2023)</i></p> <p><i>Ev. 1.3 Propozim për hapjen dhe organizimin e programeve të studimit të ciklit të dytë</i></p>
<p>Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë nxit, bashkërendon dhe administron veprimtaritë e mësimdhënies, veprimtaritë kërkimore ose artistike, duke respektuar lirinë akademike të personelit akademik dhe fushën e veçantë të studimit.</p>	<p>Gjate vizites në institucion në takimin me stafin e këtij programi u evidentua respektimi i lirisë akademike të percaktuara në aktet nenligjore. Bazuar në nivelin dhe nevojat e studentëve, pedagogë të caktuar na argumentuan axhustime në program sidomos me zhvillimin e modeleve aplikative gjate trajtimit të projekteve të kursit apo perdorimin e modeleve ekonometrike në laborator. GVJ konstatoi se stafi akademik gëzon liri akademike gjatë veprimtarisë së mësimdhënies dhe mbarvajtjes së kërkimit shkencor.</p>

	<i>Ev. 1.1 Statuti, neni 50-51, fq. 30-32</i> <i>Ref. Shënime nga vizita në institucion</i>			
Kriteri 3. Programi i studimit mundëson, nxit dhe motivon studentët të angazhohen në studime, projekte dhe aktivitete kërkimore.	Për vetë specifikën e këtij programi i fokusuar në ekonomiks ai u jep mundësi studenteve të motivohen në përgatitjen e projekteve të kursit duke u dhënë atyre karakterin e një punimi teoriko shkencort dhe aplikativ. Fakulteti i Ekonomise dhe Departamenti i Ekonomiksit tashme kanë një eksperience disa vjeçare edhe në organizimin e konferencave studentore duke u dhënë mundësi studenteve të përgatisin prezantime teoriko shkencore edhe në fushen e ekonomisë.			
Kriteri 4. Programi i studimit fokusohet në hartimin dhe zbatimin e politikave studimore e shkencore rajonale dhe kombëtare.	Plani strategjik i programit bazohet në strategjinë e zhvillimit të UT për vitet 2018-2023. Për vetë zhvillimet e intensive të ndodhura gjatë 3-4 viteve të fundit dhe që prekin thelbin e këtij program (tërmeti i vitit 2019, situatë pandemike, kriza financiare dhe energjitike e këtij viti) mendojme se është evidente hartimi i një politike studimore kombëtare dhe rajonale në funksion të fokusit të programit. <i>Ev. 2.1 Plani mësimor i programit të studimit</i> <i>Ev. 2.6 Programet e lëndëve (syllabuset)</i>			
Kriteri 5. Për realizimin e aktiviteteve studimore, kërkimore e shkencore, njësi bazë mbështetet financiarisht nga institucioni dhe administron të ardhurat nga aktivitete të ndryshme	Departamenti i Ekonomiksit në përbushje të aktiveiteteve kërkimore shkencore ka pasur si burim financimi fondet e projekteve Erasmus+ si dhe mbështetje nga institucioni. Nga takimi në institucion u informuam që në dispozicion të Departament janë akorduar shumë prej 1 milion leke për mbështetje të kërkimit shkencor dhe botimeve por nuk eidentuam praktike e përdorimit të këtij fondi. <i>Ev. 2.20 Projektet FE _Përfshirja e stafit të Dep.Ekonomiksit</i> <i>Ev. 2.21 Lista e projekteve të financuara nga Dep. fondi i ekselencës</i> <i>Ev. 2.23 Thirrje për projektet 2022</i> <i>Ev. 2.24 Thirrje për projekte 2022</i> <i>Ref. Shënime nga vizita në institucion</i>			
Shkalla e përbushjes së standardit	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X



Standardi II.8

Institucioni i arsimit të lartë nëpërmjet programit të studimit garanton njohuri të thelluara, studime dhe kërkim shkencor, ndërkombëtarizim të studimeve dhe kërkimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni mbështet grupet lëndore dhe projektet kërkimore shkencore të reja dhe siguron bashkëpunimin me struktura të tjera kërkimore për realizimin e objektivave të programit të studimit në kërkim shkencor.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit, evidentohet se Institucioni është aktiv në realizimin e projekteve dhe iniciativave shkencore. Bazuar në dosjen e aplikimit evidentojme se për periudhen 2018-2022 në kuader të FE janë 48 aplikime aplikime për projekte në kuader të thirrjeve kombetare (18 të tilla) dhe nderkombetare (27 të tilla). UT krahas thirrjes për projekte mbështet financiarisht edhe financimet përmes sigurimit të fondeve publike të dhena nga AKKSHI apo AKFAL për projekte rajonale dhe nderkombetare. Personeli akademik i departamentit konfirmoi gjithashtu përfshirjen e tyre në zbatimin e disa projekteve me financim të huaj që janë në nivel Njësie kryesore/Institucioni.</p> <p><i>Ref. Shënime nga vizita në institucion</i></p> <p><i>Ev. 2.20 Projektet FE _Përfshirja e stafit të Dep.Ekonomiksit</i></p> <p><i>Ev. 2.21 Lista e projekteve të financuara nga Dep. fondi i ekselencës</i></p> <p><i>Ev. 2.23 Thirrje për projektet 2022</i></p> <p><i>Ev. 2.24 Thirrje për projekte 2022</i></p> <p><i>Ref. Shënime nga vizita në institucion</i></p>
<p>Kriteri 2. Njësia përgjegjëse angazhohet për t'iu përgjigjur kërkesave për analiza, studime e projekte me karakter kërkimor shkencor dhe angazhon personelin akademik dhe studentët për realizimin e këtyre objektivave.</p>	<p>FE si njesi kryesore dhe Departamenti i Ekonomiksit si njesi bazë e zhvillimit të programit është aktive në përfshirjen e personelit akademik dhe studentët në realizimin e studimeve dhe analizave të ndryshme. Janë 3 projekte në proces implementimi ku janë përfshirë 15 staf akademik. Nga ana tjetër, studentët janë përfshirë në kuader të konferencave të fundit nderkombetare në realizimin e studimeve të perbashketa. Gjatë periudhës së praktikës profesionale dhe përgatitjes së mikrotezës, shikohet edhe angazhimi i studenteve në përgatitjen e punimeve shkencore.</p> <p><i>Ev. 2.21 Lista e projekteve të financuara nga Dep. fondi i ekselencës</i></p> <p><i>Ev. 2.25 Workshope për projektet kërkimore</i></p> <p><i>Ref. Shënime nga vizita në institucion</i></p>
<p>Kriteri 3. Në fushën e programit të studimit, njësia</p>	<p>Institucioni, gjatë viteve të fundit, ka qenë aktiv në organizimin e aktiviteteve promovuese, konferencave shkencore të organizuara</p>

<p>përgjegjëse organizon konferenca ose aktivitete, të cilat ndihmojnë personelin dhe studentët për arritjen e objektivave</p>	<p>në institucion ose jashtë tij, ku pjesëmarrja e studentëve ka qenë e kënaqshme. Një nga konferencat e organizuara më së fundmi ishte Konferenca Ndërkombëtare me temë “Rebound, Rebuild and Reinvent for a Sustainable and Equitable Development”, e cila zhvilloi punimet në seancë plenare dhe 12 seanca paralele, ku profesorë vendas e të huaj, ndanë këndvështrime e gjetje nga kërkimi i tyre shkencor në fusha të ndryshme.</p> <p><i>Ev. 2.19 Lista e konferencave të realizuara në periudhën 2018-2022</i></p> <p><i>Ref. Shënime nga vizita në institucion</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>


<p>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>
---	------------------------------	-------------------------------------	------------------------------------	---



III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1	
Institucionin ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve moduleve.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e aplikimit të institucionit si dhe nga takimi me stafin akademik që zhvillon kete program verejme se institucioni garanton lirinë akademike të personelit për të organizuar veprimtaritë mësimdhënëse dhe synon trajnimin e tyre, duke u siguruar një mjedis për integrimin e kërkimit shkencor me mësimdhënien. Gjithashtu në kuader të zhvillimit të mesimit online gjate periudhes pandemike UT ka hartuar udhezuesin perkates të për zhvillimin e mesimit në distance, ku trajtohet edhe metodologjia e mesimdhënies. GVJ konfirmoi që IAL i ka hartuar udhëzuesit përkatës për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies dhe personeli akademik ka të gjithë infrastrukturën e nevojshme për zbatimin e këtyre metodave.</p> <p><i>Ev. 1.1 Statuti, neni 107, fq. 62-63; neni 7, pika 2.1, fq. 4</i></p> <p><i>Ev. 1.5 Plani i Kërkimit Shkencor të Universitetit të Tiranës (2018-2022), fq. 14</i></p> <p><i>Ev. 3.1 Guida _metoda interaktive mesimdhënie_ FEUT, fq. 3-4</i></p> <p><i>Ev. 4.12 Të dhëna mbi kapacitetet e sallave dhe pajisjet_2</i></p> <p><i>Ev. 3.2 Udhëzues-i-UT-për-mësimin-në-distancë</i></p> <p><i>Ev. 3.3 Rregullore provimet online</i></p>
<p>Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik.</p>	<p>Bazuar në organigramën e institucionit dhe FE, në manualin e cilësisë të UT si dhe në takimet e realizuara në institucion, monitorimi dhe vlerësimi periodik i aftësisë mësimdhënëse të stafit akademik dhe ndihmës të programit realizohet në nivel institucional nga Komisioni i Perhershëm për Sigurimin e Standardeve të cilësisë (KPSSC) dhe Komisioni i Perhershëm i Kurrikules. Duhet theksuar se institucioni në zbatim të ligjit gjate 2 viteve të fundit ka pershtatur dhe hartuar dhe kuadrin rregullator të monitorimit dhe vleresimit të cilësisë nepermjet miratimit të “Manualit të Cilesise”; Rregulloren ”Per sigurimin e cilësisë në UT “ dhe “Paketen e instrumenteve të cilesise” ku u</p>

	<p>ngrit edhe Njësia e Sigurimit të Brendshme të Cilësisë (NJSBC). Bazuar në keto vendime të UT edhe FE si njesi kryesore ka ngritur Degen e Sigurimit të cilësisë si dhe Njësia e Sigurimit të Brendshme të Cilësisë (NJSBC), që operon në bazë të rregullores perkatëse.</p> <p>Këto dy struktura përgjegjëse monitorojnë dhe vlerësojnë periodikisht mësimdhënien nëpërmjet performancës akademike që kryen Departamenti si dhe anketimeve me studentët e programit në fund të çdo semestri. Ky vlerësim paraqitet në formën e një raporti të veçantë dhe u paraqitet instancave përkatëse për analizë të mëtejshme dhe miratim. Vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies e prezanton nëpërmjet raporteve periodike pranë instancave vendimmarrëse përkatëse më të larta si dhe pranë Departamentit të Ekonomiksit.</p> <p>GVJ konstatoi se institucioni ka ngritur struktura përkatëse të cilat monitorojnë dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik. Gjithashtu, GVJ konstatoi se institucioni ka miratuar “Manualin e vlerësimit të performancës së personelit akademik” të cilin e vlerësoi si një tregues të rëndësishëm për të siguruar cilësinë në mësimdhënie dhe në kërkimin shkencor.</p> <p><i>Ev. 1.1 Statuti, neni 51, fq. 33-34</i></p> <p><i>Ev. 3.4 Manuali i vlerësimit të performancës së personelit akademik, fq. 9-11</i></p> <p><i>Ev. 3.5 Rregullore për vlerësimin në pune të personeli ndihmës akademik dhe administrativ</i></p> <p><i>Ev. 6.2.3 Paketa e instrumentave të cilësisë</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimeve.</p>	<p>Bazuar në kuadrin rregullator të UT dhe FE, nëpërmjet strukturave përkatëse, realizohet vlerësimi periodik i mesimdhënies dhe veprimtarisë akademike dhe administrative nga ana e studentëve përmes metodave të drejtpërdrejta dhe të tërthorta.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Metoda të tërthorta: kryesisht në formën e pyetesoreve me studentët, për të gjitha lëndët dhe të gjithë pedagogët. Ky anketim zhvillohet dy herë në vit në fund të çdo semestri. Rezultatet e anketimit bëhen të ditura stafit nëpërmjet raportit të dalë për këtë qëllim, i cili analizohet në mbledhjen e Departamentit dhe që shërben për të përmirësuar punën në të ardhmen. Nga shqyrtimi i modeleve të pyetesoreve që





	<p>plotesonin studentet si për pedagogun ashtu edhe për lenden perkatese rezulton se nepermjet tyre arrihet të vleresohen të gjithë elementet e procesit. Studentet nepermjet pyetesorit të veçante vleresonin edhe procesin e praktikës profesionale. Rezultatet e tyre i vë në dispozicion të drejtuesve të Institucionit, atyre të Fakulteteve dhe Departamenteve ku edhe analizohen si dhe reflektohen në vlerësimin e performancës së çdo pedagogu në përfundim të vitit akademik;</p> <ul style="list-style-type: none"> • Metoda të drejtpërdrejta: përfshijnë vlerësimin me pikë për stafin në bazë të formularit të caktuar. Në skedën përkatëse të vlerësimit të pedagogut u evidentua një praktikë vlerësimi të një pedagogu të ri në mbarim të kontrates se perkoheshme që sherben si bazëper neneshkrimin e kontrates perfundimtare. Vlerësimi behej për mesimdhënien punen kerkimore dhe kontributin në institucion; <p>GVJ konstaton që programi i studimit ka përdorur monitorime të ndyshme dhe të ndërthorta për të patur një vlerësim periodik sa më të plotë.</p> <p><i>Ev. 1.1 Statuti, neni 41, fq. 27; neni 141, fq. 74; neni 125, fq. 69</i></p> <p><i>Ev. 6.12 GVB-FE_Akreditimi Programeve</i></p> <p><i>Ev. 6.2.3 Paketa e instrumentave të cilësisë</i></p> <p><i>Ev. 1.8 Rregullore e UT-së e përditësuar, neni 50-51</i></p> <p><i>Ref. Shënime të vizitës në institucion</i></p>
<p>Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie, bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.</p>	<p>Strukturat përgjegjëse për monitorimin e mësimdhënies, NJBSC të FE dhe Departamenti i Ekonomiksit përgatitin dhe shpërndajnë në formën e një raporti vlerësimet periodike mbi cilësinë e mësimdhënies, i cili u vihet në dispozicion strukturave drejtuese në nivel Fakulteti dhe Departamenti por edhe pedagogëve, sikurse dhe aktorëve të tjerë të interesuar. Gjithashtu, çdo aktivitet kontrolli shoqërohet me raport dhe njoftim tek personat përkatës. GVJ konstaton që IAL ka ngitur stuktura të përkatëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie duke bërë publike rezultatet e vlerësimit.</p> <p><i>Ev. 6.2.2 Rregullore për sigurimin e cilësisë, neni 32, fq.18</i></p> <p><i>Ev. 6.11 Raporti FEUT 2019-2020, fq 3 – 4</i></p> <p><i>Informacion nga Faqja Zyrtare: https://unitir.edu.al/akreditimi-i-programve-te-studimit-te-ut-se/; https://unitir.edu.al/wp-</i></p>





	content/uploads/2020/04/vendim-nr.84-ok.pdf			
Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmeve të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembujt të praktikave të mira, nxit dhe inkurajon personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies	<p>Institucioni ka strukturat e nevojshme dhe procedurat e përshtatshme për të matur vijueshmërinë dhe cilësinë në mësimdhënie, duke përdorur forma të ndryshme monitorimi lidhur me vlerësimin dhe përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies. Të gjitha gjetjet dhe praktikave të mira diskutohen në nivel departamenti duke nxitur kështu dhe përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies. Nga ana tjetër kemi promovim të stafit të programit për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies nepermjet mobiliteteve në kuader të programit ERASMUS + si edhe të trajnimeve pedagogjike të mësimdhënies nepermjet trajnimeve perkatese. Eksperienca dhe kualifikimi i stafit akademik që zhvillon kete program është edhe një faktor i rëndësishëm në realizimin me cilesi të objektivave të tij.</p> <p><i>Ev. 1.1 Statuti i UT, neni 47 pika g dhe neni 51 pika 1.d dhe pika 2</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X


Standardi III.2	
Institucioni garanton zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikave të mira.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyra kurse, projektet, praktikave profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.	<p>Mësimdhënia në programin MSH në “\ Ekonomiks” bazohet në rregulloren mësimore në nivel institucional, rregulloren e Fakultetit të Ekonomisë si dhe në rregulloren e këtij programi në të cilat përcakton format e mësimdhënies dhe vlerësimin e dijeve të studentëve. Procesi mësimor zhvillohet nëpërmjet formave të mirënjohura: leksione, seminarë, detyra kurse, ushtrime, etj, të organizuara në 15 javë, ku janë parashikuar provime me shkrim, praktika dhe tema e diplomës. Lëndët klasifikohen vetëm si lëndë të detyruara.</p> <p>Në këtë program lëndët zhvillohen sipas syllabusit përkatës dhe në liri të plotë të personelit akademik. Për të ruajtur objektivitetin e vlerësimit forma e kontrollit në program është me shkrim dhe e sekretuar. Në politikën e Institucionit është praktikë që nota e</p>

	<p>studentit të jetë e “ndërtuar”, kjo do të thotë që studentit testohet gjatë semestrit në secilën lëndë përveç provimit përfundimtar në sezon. Shumatorja e pikëve të mbledhura përbën vlerësimin e tij përfundimtar. Forma e vlerësimit referuar ECTS përcaktohen me notë (1 deri 10) dhe ekuivalentin e notave nga F në A. Ky sistem vlerësimi përfshin 100 pikë, të cilat janë të ndara kryesisht në:</p> <ul style="list-style-type: none"> • 10 % frekuentimi dhe vlerësimi gjatë semestrit; • 30 % provim i ndërmjetëm apo detyra e kursit që zhvillohet në mes të semestrit; • 60% provimi përfundimtar që zhvillohet në fund të semestrit. <p>Mënyra e vlerësimit të studentëve është e prezantuar në syllabusin e çdo lënde. GVJ pasi pa me kujdes DVV konkludon përdorimin e metodve të përshtatshme dhe të larmishme që i përshtaten programit të studimit.</p> <p><i>Ev. 1.4 Rregullore e programit të studimit MSH në Ekonomiks, neni 12, fq.7</i></p> <p><i>Ev. Aneks Tabelat përmbledhëse_RVB, tabela 13</i></p> <p><i>Ev. 2.1 Plani mësimor i programit të studimit</i></p> <p><i>Ev. 3.6 Struktura Mësimore për Vitin Akademik 2021–2022, Master i Shkencave dhe Master Profesional, Viti i Parë</i></p> <p><i>Ev. 3.7 Struktura Mësimore për Vitin Akademik 2021–2022, Master i Shkencave dhe Profesional Viti i Dytë</i></p>
<p>Kriteri 2. Personeli akademik pranon duhet të respektojë dhe t’i përgjigjet diversitetit dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies, në përputhje me fushën dhe natyrën e programit të studimit në përgjithësi dhe moduleve e aktiviteteve formuese në veçanti, reagimet e studentëve dhe është i hapur për të</p>	<p>Personeli akademik që mbulon këtë program ka aftësitë pedagogjike bashkëkohore në mësimdhënie rrjedhë kjo edhe e eksperiencës relativisht të gjatë në procesin e mësimdhënies (shih dhe vlerësimet më lart). Nga ana tjetër, nga takimi me studentët e këtij programi, GVJ evidentoi faktin e marrjes parasysh në tre raste të kërkesave të studentëve lidhur me përmirësimin e procesit të mësimdhënies për të kryer më shumë seanca aplikative të modeleve ekonometrike duke rritur nivelin kerkues e shkencor të mësimnxënies nga studentët. Në mbështetje të një performace me të mire mesimdhënieje stafit të programit i kanë shërbyer edhe mobitetet e realizuara në kauder të disa programeve ERASMUS + të viteve të fundit. për stafin e ri akademik janë organizuar edhe trajnime specifike metodologjike.</p> <p><i>Ev. 2.6 Programet e lëndëve (syllabuset)</i></p> <p><i>Ref. Shënime të vizitës në institucion</i></p>



përmirësuar mësimdhënien e tij.	
<p>Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin e tij akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike, mundëson përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxëniet, objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësve.</p>	<p>Bazuar në takimin me stafin e Departamentit të Ekonomiksit rezultoi se FE i UT mbështet stafin akademik në përmirësimin e metodës pedagogjike kryesisht nëpërmjet vizitave pranë universiteteve homologe të huaja, si dhe mobiliteteve në kuadër të projekteve ERASMUS + ose CERGE.</p> <p>Bazuar në dokumentacionin e aplikimit, Institucioni ka organizuar trajnime të strukturuar në nivel universiteti dhe Fakulteti me ekspertë të fushës së pedagogjisë. Në funksion të përmirësimit të procesit të mësimdhënies në buxhet e FE të UT planifikohen fonde për përmirësimin e bazës laboratorike, shtimin e fondit të librave etj. Studimi i tregut të organizuar nga departamenti ka vijuar edhe me intervista të strukturuar me drejtues institucionesh në funksion kjo edhe të përmirësimit të metodave të mësimdhënies. Në kuadër edhe rreth zhvillimeve të viteve të fundit stafi akademik ka përdorur edhe platformat e njohura të mësimdhënies onliNë si e-learning Microsoft Teams apo Google Classroom. GVJ është e mendimit se IAL jo vetëm që mbështet personelin e tij akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike, por dhe mundëson përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike që ndihmojnë në mësimdhënie. Gjatë takimeve me drejtues të fakultetit u theksua dhe fakti që FEUT ka si prioritet dhe praktikë të rëndësishme trajnimin e pedagogëve të rinj në fushën e pedagogjisë dhe metodave të mësimdhënies. GVJ vlerësoi formimin e Qendrës Virtuale të Trajnimit dhe Zhvillimit Profesional si një praktikë të mirë dhe strukturë të rëndësishme që do të mundësojë zhvillimin e programeve të trajnimit të strukturuar, mbështetur në nevojat e personelit akademik.</p> <p><i>Ev. 4.5 Mobilitetet e stafit akademik (2018-2022)</i></p> <p><i>Ev. 4.4.2 Bursat e mësimdhënies të CERGE</i></p> <p><i>Ev. 4.4 Trajnimi i 48 pedagogëve të rinj</i></p> <p><i>Ev. 3.15 Qendra Virtuale e Trajnimit Vendim-nr.48</i></p> <p><i>Ev. 3.2 Udhëzues-i-UT-për-mësimin-në-distancë</i></p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve,</p>	<p>Personeli akademik që mbulon këtë program ka ekspertizën e duhur për një proces mësimdhënie të suksesshëm. Bazuar në CV-të e stafit akademik që mbulon këtë program, vëmë re që pothuajse të gjithë kanë një formim akademik dhe profesional në fushën e</p>



<p>përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies sipas tematikave dhe profilit.</p>	<p>Ekonomiksit dhe te fushave te ngjashme. Referuar dokumentacionit të dorëzuar dhe vizitës në institucion GVJ konstatoi përdorimin e metodave interaktive dhe diskutimet në mësimdhënie të cilat janë shembull i aftësive të personelit akademik në mbështetje të mësimdhënies në forma të larmishme për studentët.</p> <p><i>Ev. 2.7 CV-të e personelit akademik efektiv</i></p> <p><i>Ev. Aneks Tabelat përmbledhëse_RVB, tabela 6.1</i></p> <p><i>Ev. 2.22 Puna shkencore 2018-2022</i></p> <p><i>Ev. 2.6 Programet e lëndëve (syllabuset)</i></p> <p><i>Ref. Shënime të vizitës në institucion</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.</p>	<p>Vlerësimi i formave të mësimdhënies përfshihet si pjesë e raportit të përgatitur në nivel Departamenti lidhur me problematikën e dalë nga anketimi me studentët e cila analizohet në njësinë bazë. Problematikat e dala nga anketimi i studentëve diskutohen në këtë njësi me synim rritjen e cilësisë së mësimdhënies. Në takimin me studentët e programit ata prezantuan edhe sugjerimin që kishin bërë në Departament për disa lëndë që kishin një nivel të lartë teorik shkencor për tu trajtuar në një nivel me aplikativ të cilat ishin marrë në konsideratë nga pedagogët përkatës të lëndëve. Ky sugjerim theksonte përdorimin më të madh të rasteve studimore dhe modeleve ekonometrike. E tillë konsiderohet rritja e orëve të aplikimit praktik në lëndët e modelimit dhe ekonometrisë, e evidentuar nga takimi me studentët.</p> <p><i>Ev. 6.2.3 Paketa e instrumentave të cilësisë</i></p>
<p>Kriteri 6. Personeli akademik përdor metoda interaktive dhe diskutimi duke i bërë tërheqëse orët e mësimi.</p>	<p>Ekspierienca në mësimdhënie e stafit të programit bën që të përdoren format interaktive duke ndërthurur trajtimin teorik me atë aplikativ. Një zhvillim të mëtejshëm të këtyre metodave e përben dhe realizimi i mësimi online gjatë situatës pandemike. një ndihmese në kete drejtim e ka dhenë edhe realizimi i disa workshop-eve me pjesëmarrjen edhe të studenteve të organizuara nga Departamenti i Ekonomiks ku synohet terheqja e mendimit të studenteve.</p> <p><i>Ev. 2.6 Programet e lëndëve (syllabuset)</i></p> <p><i>Ref. Shënime të vizitës në institucion</i></p>
<p>Kriteri 7. Format dhe metodat e mësimdhënies inkurajojnë</p>	<p>Nga takimi me studentët e programit u evidentua një bashkëpunim reciprok i frytshëm mes tyre dhe personelit</p>


sensin e autonomisë te studentit, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzimin dhe mbështetjen nga mësimdhënësi dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre	akademik. Vetë karakteri aplikativ i disa lëndëve, sidomos të modelimit dhe menaxhimit, rrisin pavarësinë e studentit në këtë proces. GVJ mendon se format dhe metodat e mësimdhënies inkurajojnë sensin e autonomisë te studentit, duke siguruar një marrëdhënie respekti të ndërsjellë mes lektorit dhe studentëve. <i>Ev. 2.6 Programet e lëndëve (syllabuset)</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.3


Njësitë përgjegjëse garantojnë zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional, duke vënë në dispozicion të gjithë infrastrukturën fizike, didaktike e logjistike e nevojshme për realizimin me sukses të aktivitetit mësimor e shkencor.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Procesi mësimor e shkencor realizohet në hapësira të mjaftueshme dhe cilësore, të cilat janë të pastra dhe mirëmbahen rregullisht.	<p>Ky program studimi realizohet në godinen A dhe B tashme të rikonstruktuar të FE të UT. GVJ vizitoi infrastrukturën e kësaj godine dhe konstatohet që në dispozicion të procesit mësimor janë ambjente të pershtatshme që plotesojnë maksimalisht procesin normal të mesimit. të gjitha sallat e leksioneve, seminareve, biblioteka e FE janë të pajisura me se miri me mjetet e nevojshme didaktike dhe teknologjike. Investimi i fundit që tashme ka perfunduar ka rritur me tej cilesinë e infrastruktures mesimore si për studentet ashtu edhe për stafin akademik. Edhe zyrat e personelit akademik ishin konceptuar dhe realizuar në formen e permbajtjes bashkekohore me qellim rritjen e eficences. Të gjitha ambjentet janë tashme të perfshira në sistemin ngrohje ftohje qendror, falë kjo e investimit të sapoperfunduar. Edhe labororet, salla e konferencave dhe takimeve me studentet janë të pajisura me të gjithë mjetet e nevojshme dhe kapacitetet e perballimit të numrit të studenteve dhe stafit.</p> <p><i>Ev. Aneks Tabelat përmbledhëse _RVB, tabela 16</i></p> <p><i>Ev. 3.8 Biblioteka FEUT</i></p> <p><i>Ev. 3.9 Mjedise mësimore FEUT</i></p> <p><i>Ref. Shënime të vizitës në institucion</i></p>


<p>Kriteri 2. Ambientet e dedikuara për procesin mësimor janë funksionale dhe të pajisura me logjistikën e nevojshme për realizimin me cilësi të procesit mësimor, por edhe praktikave.</p>	<p>Ambientet ku zhvillon mësimin ky program studimi janë funksionale dhe ofrojnë logjistikën e nevojshme në shërbim të procesit mësimor. Labororet ne perdorim te Departamentit të Ekonomiksit ofrojne kapacitetin e nevojshëm për të realizuar nevojat e programit në shfrytëzimin e kësaj teknologjie. Për zhvillimin e mësimit pedagogët përdorin video projektorët të cilët së bashku me kompjuterin janë të instaluar në sallën e leksionit.</p> <p><i>Ev. 3.9 Mjedise mësimore FEUT.</i></p> <p><i>Ev. 4.12 Të dhëna mbi kapacitetet e sallave dhe pajisjet_2</i></p> <p><i>Ref. Shënime të vizitës në institucion</i></p>
<p>Kriteri 3. Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sisteme të ndryshme informatike, infrastrukturë të konsoliduar IT të nevojshme për realizimin e procesin mësimor.</p>	<p>Nga vizita në institucion GVJ evidentoi që të gjitha sallat e leksioneve, seminareve dhe laboratorit perkates perdorin sisteme bashkekohore të informatikes në funksion të realizimit të procesit mesimor. Paisjet kompjuterike dhe aksesoret e tyre kanë të instaluar softe aplikative të kohes si program modelimi STATA; EViews etj.</p> <p><i>Ev. 3.10 Platforma MS Teams</i></p> <p><i>Ev. 3.10.1 Leksion model_MS TEAMS</i></p> <p><i>Ev. 4.15 Manuali pedagogut e_student</i></p> <p><i>Ev. 3.11 Rregullore-për-funksionimin-e-sistemit-informatik</i></p>
<p>Kriteri 4. Literatura bazë dhe ndihmëse, e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale), garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme të parashikuara për programin e studimit.</p>	<p>Në mbështetje të procesit të mesimnxenies FE i UT ka në funksionim edhe biblioteken e tij ku studentet kanë mundesi të marrjes se njohurive të programit si fizike (nepermjet teksteve perkatese) ashtu edhe digjitale. Përveç materialeve fizike, studentët kanë akses të plotë në librarinë online JSTOR që mund të aksesohet nga ambjentet e universitetit, e cila ofron një numër të konsiderueshëm artikujsh, revista shkencore, libra referimi, etj. Bazuar në dokumentacionin e aplikimit nga institucioni si dhe në viziten që GVJ realizoi në ambjentet e FE të UT evidentojme që për modulet/lenDET e programit studenteve u ofrohet dhe literatura bazë dhe ndihmëse siç edhe janë të percaktuara në syllabuset perkatese.</p> <p><i>Ev. 2.6 Programet e lëndëve (syllabuset)</i></p> <p><i>Ev. 3.10.1 Leksion model_MS Teams</i></p> <p><i>Ev. 4.7 Jstor_University of Tirana 2020 IPA marrëveshje</i></p> <p><i>Ref. Shënime të vizitës në institucion</i></p>
<p>Kriteri 5. Biblioteka e institucionit garanton numër</p>	<p>Bazuar në vizitën që GVJ realizoi në bibliotekë rezulton se ka literaturë relativisht të mjaftueshme, tekste mësimore në funksion të</p>



<p>të mjaftueshëm botimesh të viteve të fundit në drejtimet kryesore të programit të studimit dhe hapësira të mjaftueshme dhe komode për përdorim nga studentët gjatë procesit mësimor.</p>	<p>studentëve dhe stafit akademik. Në evidentuam listen e titujve të disponueshëm për pedagogët dhe studentët dhe seksioni në ndihmë të programeve të shkencave ekonomike. Bazuar në listën e inventarit të librave në fushën e finances, biblioteka ofron një fond relativisht të mjaftueshëm librash në shqip (rreth 2500 tituj) dhe anglisht (rreth 2700) që janë në ndihmë të studentëve si dhe rreth 240 numr revistash periodike. Sipas rregullores se programit të ciklit të trete në biblioteke janë të depozituar edhe kopje të punimeve të doktoratures të mbrojtura pranë Fe të UT.</p> <p>Studentet kanë në përdorim biblioteken digjitale JSTOR me akses në mjaft të gjere në revista akademike (mbi 12 milion artikuk) apo libra (mbi 85,000 të tilla).</p> <p>FE i UT tashme është pjese e platformes online RASH (Rjeti Akademik Shqiptar) që mundeson kerkimin dhe gjetjen e revistave, e-books, dhe punimeve të tjera. Kapaciteti i bibliotekes është afro 100 vende në dy salla perkatese të paisura me kompjuteradhe nen kujdesin e personelit të saj.</p> <p>Orari i punes se bibliotekes është 8.30 deri 19.30 orar i pershtatshem për studentet e ketij programi që e zhvillojNë mesimin pasdite</p> <p><i>Ev. 4.6 Biblioteka FEUT_mjediset</i></p> <p><i>Ev. 3.13 Lista e teksteve të reja të hyra në bibliotekë për PS</i></p> <p><i>Ref. Shënime të vizitës në institucion</i></p>
<p>Kriteri 6. Në funksion të mësimdhënies dhe mësimnxënies, personeli akademik dhe studentët aksesojnë libraritë on-line të fushave të ngjashme ose të përafërta me programin e studimit.</p>	<p>Personeli akademik dhe studentët kanë akses online në bibliotekën e institucionit duke shfrytëzuar literaturën e fushës përkatëse për tekste universitare, libra dhe artikuj shkencorë. Sektori i IT i universitetit mundëson integrimin e teknologjisë së informacionit në bibliotekë të dy sistemeve me fonde të hapura dhe fonde të mbyllura.</p>
<p>Kriteri 7. Infrastruktura laboratorike e nevojshme për realizimin e laboratorëve, detyrave të kursit, diplomave dhe studimeve specifike, shfrytëzohet në mënyrë të vazhdueshme nga studentët.</p>	<p>Nga vizita në laboratorët e përmendur me lart, bëhet i mundur realizimi i njohurive aplikative i lëndëve përkatëse si dhe i punimeve të detyrave të kursit apo diplomimit të tyre. GVJ konstatoi se të gjithë laboratorët janë të pajisur me të gjitha mjetet dhe infrastrukturën e nevojshme që studentët të kenë akses në aktivitetet e tyre akademike.</p>



<p>Kriteri 8. Në funksion të mësimdhënies, personeli akademik përdor platforma on-line (elearning) dhe mbështet e nxit personelin akademik e studentët për përdorimin e tyre.</p>	<p>Në funksion të procesit mësimor personeli akademik dhe studentët përdorin platformën online në hedhjen e materialeve mësimore dhe informimin e studentëve mbi procesin e mësimdhënies dhe mësimnxënies. Pedagogë të caktuar përdorin platformat elektronike të komunikimit on-line në raste të caktuara për komunikim me studentët, siç janë: google classroom, zoom, si dhe platformen e-learning Microsoft Teams; platformen e-learning Canvas-etj. GVJ mbështetur në dokumentacion dhe vizitën në institucion konstatoi që nga viti 2020 personeli akademik dhe studentët vazhdimisht komunikojnë në platformat online.</p> <p><i>Ev. 3.2 Udhëzues-i-UT-për-mësimin-në-distancë</i> <i>Ref. Shënime të vizitës në institucion</i></p>			
<p>Kriteri 9. Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sistemet e komunikimit të brendshëm për akses në dokumentacionin elektronik dhe hapësirë vetjake të dedikuar.</p>	<p>Personeli akademik dhe studentët përdorin komunikimin elektronik që disponon institucioni të permendur me siper për marrje materialesh mësimore studimore apo shkencore duke komunikuar kështu në kohe reale. GVJ mbështetur në vizitën në institucion konstatoi që personeli akademik dhe studentët kanë komunikim të brendshëm elektronik dhe hapësirë vetjake të dedikuar.</p>			
<p>Kriteri 10. Personeli akademik orienton studentët në përzgjedhjen e temave të diplomave, asiston dhe mbështet në zhvillimin e tyre</p>	<p>Personeli akademik orienton studentët në përzgjedhjen e temave të diplomave, asiston dhe mbështet në zhvillimin e tyre që në fillim të periudhës përkatëse që perkon me semestrin e parë të vitit të dytë dhe gjatë përgatitjes së tyre. U evidentua edhe në takimin me studentët që ishin në këtë fazë, orientimi i studentëve nga pedagogët udhëheqës që ishin miratuar, si dhe procedurat e shkruara që orientonin studentët në këtë proces. GVJ është e mendimit se PS përdor mënyrat e duhura për të orientuar studentët në përzgjedhjen e temave të diplomave, asiston dhe mbështet në zhvillimin e tyre.</p> <p><i>Ev. 1.4 Rregullore e programit të studimit MSH në Ekonomiks</i> <i>Ev. 3.13 Format mikroeteze</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>




Standardi III.4



Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programin e studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimin të cilësisë së mësimdhënies.</p>	<p>Në përputhje me objektivat strategjike të institucionit, UT përcakton në Statut dhe rregullore, prioritetin për sigurimin e cilësisë, si dhe ngritjen e Njësisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (organ kolegjal).</p> <p>NJSBC është organi që bashkërendon veprimtarinë e vet me strukturat përgjegjëse në çdo fakultet, në kuadër të përmirësimin të cilësisë së mësimdhënies. Departamenti i Ekonomiksit ka përcaktuar koordinatore të programit të cilët, në bashkëpunim me NjSBC, e mbikqyrin procesin mësimor. Përveç këtyre strukturave, kontrolli dhe mbikqyrja bëhen edhe nga departamenti dhe Fakulteti në bashkëpunim me NjSBC. Këto njësi bëjnë edhe përhapjen dhe promovimin e eksperiencave të përparuara në mësimdhënie dhe mësimnxënie. Nga vëzhgimet e GVJ-së, NJSBC paraqet një zyrë të re, e cila ka si qëllim asistimin aktiv në procese të ndryshme për sigurimin e cilësisë.</p> <p><i>Ev. 6.2.2 Rregullore për sigurimin e cilësisë, neni 10, fq.6</i> <i>Ev. 1.1 Statuti, neni 138, fq.71</i> <i>Ev. 6.3 Vendim senati për krijimin e komisioneve të përhershme</i> <i>Ev. 6.2 Vendim SA Për miratimin-dokumentave-për-sigurimin-e-cilësisë-në-Universitetin-e-Tiranës</i></p>
<p>Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë është përgjegjëse për cilësinë e mësimdhënies dhe rritjes së vetëdijes të personeli akademik dhe studentët për cilësinë në programin e studimit që ofron.</p>	<p>Fakulteti i Ekonomisë si njësi kryesore dhe Departamenti i Ekonomiks si njësi bazë ndjekin në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe të vazhdueshme nivelin e cilësisë së mësimdhënies në këtë program studimi. Përgjegjësinë e drejtpërdrejtë të mbarëvajtjes së programit dhe cilësisë së tij e ka Departamenti i Ekonomiksit i cili bën analiza periodike dhe raporton tek Dekanati i Fakultetit të Ekonomisë dhe pranë NjSBC-së, e përcaktuar kjo edhe në planin e punës që hartojnë njësitë përkatëse për vitin akademik. GVJ mbështetur në dokumentacion e vënë në dispozicion konstatoi që IAL nëpërmjet NJSBC-së asiston në vlerësimin e vazhdueshëm të programeve dhe të lëndëve, zbatimit, rishikimit, përditësimit të tyre, nëpërmjet krijimit dhe përmirësimin të vazhdueshëm të</p>

	<p>performancës së mekanizmave zyrtare për miratimin, vlerësimin periodik dhe për monitorimin e programeve dhe diplomave.</p> <p><i>Ev. 1.1 Statuti, neni 141, fq.74</i></p> <p><i>Ev. 6.2.2 Rregullore për sigurimin e cilësisë, neni 23, fq.14; neni 25, fq. 15</i></p> <p><i>Ev. 6.5.1 Raporti vjetor DE 2019-2020</i></p> <p><i>Ev. 6.5.2 Raporti vjetor DE 2018-2019</i></p>
<p>Kriteri 3. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies.</p>	<p>FEUT është i përkushtuar të punësojë staf akademik me eksperiencë kombëtare dhe ndërkombëtare duke pasuruar kështu programet me metoda të reja mësimore dhe të nxënies aktive. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse inkurajojnë promovimin e metodave inovative dhe aktive, si dhe kreative të mësimdhënies dhe të nxënies, të orientuara drejt studentëve. Një aspekt tjetër që mbështet mësimdhënien novatore janë shkëmbimet dhe lëvizshmëria e studentëve dhe stafit.</p> <p>Studentët fitojnë njohuri si në klasë ashtu edhe jashtë saj: fitojnë njohuri përmes teksteve të lëndëve, leksioneve, diskutimeve në grupe të vogla, prezantimeve individuale dhe grupore dhe përmes projekteve kërkimore, leksioneve publike, ndërveprimit me ekspertët/praktikantët që vizitojnë kampusin, dhe veprimtari të bazuara në detyra kurse. GVJ konstatoi mbështetjen nga strukturat dhe njësitë përgjegjëse të eksperimentimit dhe zhvillimit të metodave të reja inovative të mësimdhënies.</p> <p><i>Ev. 3.1 Guida _metoda interaktive mësimdhënie_FEUT</i></p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik dhe ai mbështetës kualifikohen në mënyrë të vazhdueshme në fushën e kërkimit shkencor për të ndihmuar përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit dhe vizita në institucion GVJ evidentoi përpjekje të stafit të programit për të rritur kualifikimin e tyre dhe marrë eksperiencë të reja në procesin mësimor e shkencor. Kjo është realizuar nëpërmjet vizitave që anëtarë të stafit kanë realizuar në kuadër të projekteve të shkëmbimit ERASMUS, pjesëmarrje të stafit në disa projekte kërkimore shkencore si dhe në prezantime të punimeve të tyre në konferenca kombëtare dhe ndërkombëtare si dhe në ato të organizuara nga vete Departamenti i Ekonomiksit. Gjate takimit me stafin e programit në identifikua dhe mbështetje financiare për antare të tij në pjesëmarrjen në konferenca ndërkombëtare. GVJ shqyrtoi me kujdes listën e publikimeve, të trajnimeve, dhe të përfshirjes në projekte kombëtare dhe ndërkombëtare dhe është i mendimit se IAL ka</p>



	<p>ndërmarrë hapa konkrete në mbështetje të stafit akademik në përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.</p> <p><i>Ev. 2.16 Mobilitete të personelit akademik</i></p> <p><i>Ev. 2.20 Projektet FE _Përfshirja e stafit të Dep.Ekonomiksit</i></p> <p><i>Ev. 2.22 Puna shkencore 2018-2022</i></p>
<p>Kriteri 5. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe implementimit të metodave të reja.</p>	<p>Anëtarë të stafit të këtij programi kanë marrë pjesë në trajnime në nivel institucioni për metodologjinë e mesimdhënies që ndihmon në rritjen e kualifikimit të tyre me përdorimin e risive në fushën e teknologjisë digjitale etj. Këtij qëllimi i ka shërbyer dhe veprimtaria e Qendres Virtuale të Zhvillimit Profesional dhe Trajnimit ku kanë marrë pjesë antare të stafit akademik që mbulon këtë program.</p> <p>GVJ mbështetur në dokumentacion dhe në vizitën në IAL konstatoi që Njësia bazë ka trajnuar vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe zbatimit të metodave të reja duke e vlerësuar si një pikë të fortë në nivel institucional.</p> <p><i>Ev. 4.4 Trajnimi i 48 pedagogëve të rinj</i></p> <p><i>Ref. Shënime të vizitës në institucion</i></p>
<p>Kriteri 6. Personeli akademik dhe personeli ndihmësakademik janë përgjegjës për zbatimin e programit të studimit dhe angazhohen për përmirësimin e mësimdhënies dhe implementimin e metodave të reja.</p>	<p>Nga takimi me stafin që mbulon këtë program u evidentua angazhim serioz i tij në zbatimin me përgjegjshmëri të realizimit të programit mësimor, duke i dhënë rendësi procesit të mësimdhënies nëpërmjet përdorimit të metodave aplikative sidomos në lëndët karakterizuese. Këtu ritheksojmë përdorimin e metodave aplikative bashkëkohore që përdoren në fushat e ekonomisë.</p> <p>GVJ është e mendimit se Njësia bazë ka struktura përkatëse të cilat ndihmojnë në vlerësimin e performancës së çdo stafi të cilat shërbejnë në evidentimin e problematikave ose pikave të forta të stafit akademik dhe ndihmës.</p> <p><i>Ev. 1.1 Statuti, neni 51, fq. 33, neni 74, fq. 46</i></p> <p><i>Ev. 4.4.2 Bursat e mësimdhënies të CERGE</i></p>
<p>Kriteri 7. Personeli akademik dhe personeli ndihmësakademik testojnë metoda të reja në mësimdhënie, analizojnë efektet e pritshmëritë dhe raportojnë në mënyrë periodike për rezultatet në</p>	<p>Eksperiencia në mësimdhënie e numrit me të madh të personelit akademik që mbulon këtë program është një faktor i rëndësishëm për realizimin e procesit të mësimdhënies sa me bashkëkohor dhe të përmirësuar me arritjet në këtë drejtim. Marrja e eksperiencave nga stafi të metodave bashkëkohore të kolegeve të tyre pranë universiteteve të huaja është realizuar nëpërmjet mobiliteteve në kuadër të projekteve ERASMUS ku institucioni është parter.</p>






strukturat dhe njësitë përgjegjëse.	<p><i>Ev. 1.1 Statuti, neni 7, pika 2.a, fq. 4</i></p> <p><i>Ev. 3.16 Lista e pjesëmarrjes në leksion_sistemi</i></p> <p><i>Ref. Shënime të vizitës në institucion</i></p>			
Kriteri 8. Institucioni, në kuadër të bashkëpunimeve dhe përfshirjes së partnerëve në procesin mësimor, angazhon në faza të ndryshme të programit të studimit lektorë dhe kërkues shkencorë për shkëmbim të ideve dhe metodave të mësimdhënies dhe kërkimit shkencor	<p>Bazuar në dokumentacionin e përcjellë për këtë program dhe vizitës në institucion, u evidentua fakti se institucioni ka miratuar një numër profesorësh të fushës akademike apo personalitete të njohura në organizatat publike dhe private apo perfaqesues të projekteve të huaja (GIZ, UNDP) për të zhvilluar leksione të hapura për tema të veçanta dhe të trajtuara në mënyrë komplekse dhe inovative. GVJ mbështetur në dokumentacion konstatoi që në kuadër të ndërkombëtarizimit shumë lektorë të huaj të institucioneve partnere kanë vizituar institucionin, dhe janë angazhuar në mësimdhënie dhe leksione të hapura duke kontribuar kështu në mësimnxënien.</p> <p><i>Ev. 3.14.1 Leksione të hapura 2</i></p> <p><i>Ev. 2.16 Mobilitete të personelit akademik të huaj _pedagogu pritës</i></p> <p><i>Ev. 2.16.1 Marrëveshje dypalëshe</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.5



Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e kërkimore dhe garanton zbatimin e tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale përcaktohen në rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.	Kriteret dhe mënyra e testimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale janë të përcaktuara qartë në rregulloret e posaçme, të cilat janë pjesë zbatuese si në nivelin institucional (Rregullore e UT), njësisë kryesore (Rregullore e Fakultetit të Ekonomisë) dhe rregulloren e këtij programi si dhe në manualin e zhvillimit të provimit. Këto dokumenta janë të publikuara dhe studentët kanë akses në to. Më të specifikuara mënyrat e testimit jepen në syllabuset e lëndëve përkatëse. GVJ mbështetur në dokumentacion dhe në vizitën në IAL konstatoi që studentët njoftoheshin për kriteret dhe mënyrën e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale.






	<p><i>Ev. 1.4 Rregullore e programit të studimit MSH në Ekonomiks, neni 16, fq.9</i></p> <p><i>Ev. 2.6 Programet e lëndëve (syllabuset)</i></p> <p><i>Ref. Shënime të vizitës në institucion</i></p>			
<p>Kriteri 2. Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e ofruar dhe vizitën në institucion, GVJ evidenton se studentët e programit informohen mbi mënyrën e vlerësimit të njohurive nëpërmjet informacionit të marrë në webin e institucionit pasi rregulloret në këtë drejtim janë të përfshira në te, dhe informacionit që marrin që në fillim të semestrit përkatës nëpërmjet syllabuseve të lëndëve përkatëse të pedagogëve përgjegjës për zhvillimin e tyre. GVJ mbështetur në dokumentacion dhe në vizitën në IAL konstatoi që nëpërmjet syllabuseve ata informohen lidhur me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive që lidhet me tipologjinë e secilës lëndë.</p> <p><i>Ref. Shënime të vizitës në institucion</i></p>			
<p>Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara</p>	<p>Vlerësimi i njohurive të studentëve realizohet në format tashmë të konsoliduara dhe përfshijnë elementë të vlerësimit të vazhdueshëm në seminar, testimin e ndërmjetëm, detyrat e kursit, provimin përfundimtar etj, elementë këto që uevidentuan të përcaktuara në syllabuse në kriteret standarte.</p> <p><i>Ev. 1.4 Rregullore e programit të studimit MSH në Ekonomiks, neni 16, fq.9</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes sëstandardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<p>Standardi III.6</p> <p>Institucioni garanton vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti..</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik</p>	<p>Studentët vlerësohen sipas disa kriterëve gjatë gjithë semestrit. Në përgjithësi, ekzistojnë dy korniza kohore të dedikuara për provimet e ndërmjetme dhe provimet përfundimtare. Studentëve u kërkohet të punojnë në raste studimore, të bëjnë projekte ose të bëjnë një prezantim sipas çdo lënde detyrat përkatëse siç</p>

<p>dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar.</p>	<p>përcaktohet në syllabusin e çdo lënde të ofruar në kurrikulën e programit të studimit. Gjatë vizitës në institucion dhe në bazë të dokumentacionit të vënë në dispozicion, GVJ konfirmoi që IAL ka përdorur një sërë kriteresh të shtrira përgjatë gjithë semestrit të cilat reflektohen dhe në vlerësimin final.</p> <p><i>Ev. 2.6 Programet e lëndëve (syllabuset)</i></p> <p><i>Ev. Aneks Tabelat përmbledhëse _RVB, tabela 15</i></p> <p><i>Ref. Shënime të vizitës në institucion</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat eliminojnë forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.</p>	<p>Duke nisur që nga viti akademik 2016-2017, UT ka filluar përdorimin e vlerësimit në mënyrë elektronike (nëpërmjet Clean Score) i provimeve /testimeve, si një nga format bashkëkohore të kontrollit të njohurive dhe vlerësimit të studentëve. Sipas GVJ, IAL ka vënë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, për të shmangur format e ndryshme të abuzimit.</p> <p><i>Ev. 3.3 Rregullore provimet-online; https://unitir.edu.al/nenshkrimi-i-memorandumit-te-mirekuptimit-midis-fondacionit-shqiptaro-amerikan-per-zhvillim-ministrise-se-arsimit-dhe-sportit-universitetit-te-tiranes-dhe-universitetit-europian-te-tiranes/</i></p>
<p>Kriteri 3. Testimi përfundimtar i vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet nga komisionet e posaçme me së paku 2 anëtarë, të ngritura nga njësitë përgjegjëse, ku njëri prej tyre është titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>Për realizimin e testimeve dhe vlerësimin e dijeve të studentëve Departamenti Ekonomiks, bazuar në rregulloret përkatëse, në bashkëpunim me sekretarinë mësimore, miratojnë komisionet e provimit me një numër anëtarësh stafi jo më pak se 2, ku njëri është titullari i lëndës dhe tjetri është pedagog i fushës përkatëse. GVJ evidentoi nënshkrimin e anëtarëve të komisionit në procesverbalet e provimeve të lëndëve, si dhe praktikave profesionale të firmosura nga 2 anëtarët e komisionit të provimit dhe Përgjegjësi i Departamentit të Ekonomiksit. GVJ mbështetur në dokumentacion konstatoi që testimi përfundimtar i vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet sipas kriterit përkatës.</p> <p><i>Ev.1.1 Statuti, neni 51, fq.33</i></p> <p><i>Ev. 1.8 Rregullore e UT-së e përditësuar neni 46, fq. 27, neni 48, fq. 27</i></p>
<p>Kriteri 4. Testimi i vlerësimit i njohurive, dijeve me shkrim, zhvillohet në mënyrë anonime me sekretim ose kodifikim dhe institucioni</p>	<p>Zhvillimi i testimit të vlerësimit bazohet në anonimitetin dhe monitorim nga Departamenti Ekonomiks. Kushtet e zhvillimit të provimit janë optimale dhe hapësirat ndërmjet studentëve në këtë proces janë të përshtatshme. Në raste zhvillimit të testimit në laborator shtohet dhe personel mbikëqyrës gjatë zhvillimit të provimit. Referuar dokumentacionit të dorëzuar dhe vizitës në IAL,</p>



<p>siguron infrastrukturë të posaçme të monitoruar me personel dhe/ose kamera sigurie.</p>	<p>GVJ konstatoi se testimi i vlerësimit i njohurive realizohet sipas kriterit përkatës.</p> <p><i>Ev. 1.8 Rregullore e UT-së e përditësuar neni 46, fq. 27, neni 48, fq. 27</i></p> <p><i>Ev. 5.6 Urdhëri i Dekanit "Mbi procedurën e zhvillimit të provimeve në FE"</i></p> <p><i>Ref. Shënime të vizitës në institucion</i></p>
<p>Kriteri 5. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/ feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxënimit për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.</p>	<p>GVJ konstatoi se IAL siguron vlerësimin e njohurive dhe dijeve në provim, i cili shoqërohet me komente. Çdo provim përmban seksionin e vlerësimit të pedagogut për të argumentuar vlerësimin e tij. Vlerësimi me 40% të pikëve të dijeve gjatë vitit jo vetëm i "mban të angazhuar" vazhdimisht studentët, por u mundëson të diskutojnë dhe të këshillohen me pedagogët përkatës për të përmirësuar mësimnxënien e tyre sidomos kjo për detyrat e kursit të cilat në shumicën e lëndëve karakterizuese janë edhe aplikative. GVJ evidentoi formatin e disa testeve dhe konstatoi që format e pyetjeve dhe ushtrimeve praktike përmbajnë elementë standard të vlerësimit: pyetje me alternativa, pyetje me koment, ushtrime etj.</p>
<p>Kriteri 6. Njësitë përgjegjëse dhe stafi akademik evitojnë dhe nuk tolerojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.</p>	<p>Bazuar në kuadrin rregullator në nivel institucional dhe të njësisë kryesore dhe bazë, Departamenti Ekonomiks monitoron zhvillimin normal të testimit duke u përpjekur që ai të jetë realist dhe vlerësimi të jetë meritë e angazhimit të studentëve me njohuritë e kërkuara duke eliminuar sa më shumë format e kopjimit apo të abuzimit në këtë drejtim.</p> <p><i>Ev. 1.8 Rregullore e UT-së e përditësuar, nenet 89-90, fq. 41-42</i></p> <p><i>Ev. 3.17 Kodi i Etikës i UT, neni 5, fq. 3</i></p> <p><i>Ev. 1.8 Rregullore e UT-së e përditësuar, neni 85 pika 3 dhe neni 27, pika 4</i></p> <p><i>Ev. 1.1 Statuti, neni 83, pika 4;</i></p> <p><i>Ev. 3.17 Kodi i Etikës UT, neni 7, fq. 5</i></p>
<p>Kriteri 7. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen mbi meritën dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.</p>	<p>Realizimi me korrektësi i testeve gjatë vitit akademik dhe në fund të tij është një garanci për vlerësimin e saktë të studentëve. në nenet 46,47,48 dhe 49 të rregullores se UT përcaktohet procedura e vlerësimit të studenteve. në të përcaktohet se përgjigjet e testimit merren nga studentët brenda 15 ditëve nga zhvillimi i tij dhe ata kanë të drejtën e reklamimit të tij brenda 5 diteve nga shpallja e tyre.</p> <p><i>Ev. 1.8 Rregullore e UT-së e përditësuar, neni 49, fq. 28</i></p>

	<p><i>Ev. 1.4 Rregullore e programit të studimit MSH në Ekonomiks</i></p> <p><i>Ev. 5.6 Urdhëri i Dekanit "Mbi procedurën e zhvillimit të provimeve në FE"</i></p>			
<p>Kriteri 8. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.</p>	<p>Nga takimi me studentët, GVJ evidentoi faktin se përpara se pedagogu të dërgojë procesverbalin në sekretarinë mësimore lihet një ditë reklamimi për ta nëse ndonjë ka paqartësi apo pretendime mbi vlerësimin. Kjo u konstatua dhe nga bashkëbisedimet që GVJ kishte me stafin dhe studentët e këtij programi.</p> <p><i>Ev. 1.8 Rregullore e UT-së e përditësuar, nent 51, fq. 29</i></p> <p><i>Ev. 5.6 Urdhëri i Dekanit "Mbi procedurën e zhvillimit të provimeve në FE"</i></p> <p><i>Ref. Shënime të vizitës në institucion</i></p>			
<p>Kriteri 9. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet</p>	<p>Praktikat e ankimimit të studentëve lidhur me vlerësimin kanë qenë të pakta në numër, ndërsa nuk ka pasur të tilla për studentët e këtij programi. Por, në rastet e evidentuara, Departamenti ngre komision vlerësimi të posaçëm dhe procesi dokumentohet deri në fund. GVJ konstatoi që PS ndiqte një procedurë efektive të dokumentuar dhe arkivuar.</p> <p><i>Ev. 1.8 Rregullore e UT-së e përditësuar, nent 51, fq. 29</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

Standardi III.7



Zhvillimi i programit të studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët, duke dhënë njëkohësisht njohuri të thelluara të kompetencave profesionale e shkencore.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Programi i studimit zhvillohet në mënyrë të tillë që të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë</p>	<p>GVJ mbështetur në dokumentacion përkatës konstatoi që ky program është hartuar duke mbajtur në konsideratë zhvillimet bashkëkohore në fushën e ekonomiksit, aftësimin e studenteve me njohuri aplikative dhe praktike, në funksion të përmbushjes së kërkesave dhe nevojave të tregut të punës, në nivel kombëtar dhe rajonal.</p>





<p>aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve.</p>	<p>Programi bazohet mbi njohuritë e marra në ciklin e parë të studimit në Ekonomiks, ku FE i UT tashme ka një historik dhe eksperience sa pozitive aq edhe të gjate. Nga shqyrtimi i syllabusve vihet re që ka një trajtim fillimisht të koncepteve bazë në ekonomiks që janë marrë në programin Bachelor. Ky trajtim është i domosdoshëm në kushtet kur në këtë program kanë mundësinë që ta ndjekin edhe studentë që nuk kanë mbaruar studimet e ciklit të parë në fushën e ekonomiks.</p> <p>Programi arrin të pajisë studentët me kompetenca të përgjithshme në fushën e ekonomiksit. Programi synon që të rrisë edhe kompetencat profesionale të studentëve me fokus rritjen e aftësive praktike që përfshijnë fushën e aplikimeve të programeve në mikroekonomik, makroekonomi, ekonometri, etj. Në këtë kuadër praktika profesionale dhe përgatitja e mikrotezes që synohet të jetë aplikative, i shërbejnë këtij objektivi dhe rrisin më shumë përgatitjen profesionale të studentëve.</p> <p><i>Ev. 1.3 Propozim për hapjen dhe organizimin e programeve të studimit të ciklit të dytë, fq. 1-2</i></p> <p><i>Ev. 2.1 Plani mësimor i programit të studimit</i></p> <p><i>Ev. 2.6 Programet e lëndëve (syllabuset)</i></p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane sociale, komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj).</p>	<p>GVJ mbështetur në dokumentacion përkatës konstatoi që programi Master i Shkencave në Ekonomiks garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fusha të nderthurura me teknologjisë dhe informacionin, shkencat humane dhe sociale, shkencat e komunikimit dhe ndërveprimit. Njëkohësisht gjejnë relativisht trajtime në zhvillimin e aftësive në fushën e informacionit në trajtimin e rasteve studimore në lëndët që bazohen në modele dhe programe informatike të aplikuara në këtë fushë. Gjatë vizitës në institucion GVJ konstatoi se studentët njohin mirë dhe përdorin disa programe kompjuterike të dedikuara për studentët e Ekonomiksit si eviews, stata, spss, të cilat përdoren në lëndën e Ekonometrisë dhe Metodave të kërkimit mbi politikat ekonomike.</p> <p><i>Ev. 2.12 Kriteret e pranimi për vitin akademik 2020-2021_Cikli i II-të</i></p> <p><i>Ev. 2.6 Programet e lëndëve (syllabuset)</i></p> <p><i>Ev. 4.12 Të dhëna mbi kapacitetet e sallave dhe pajisjet_2</i></p> <p><i>Ev. 3.20 Model detyrë kursi</i></p> <p><i>Ev. 3.20 Model diplome</i></p>

	<i>Ref. Shënime të vizitës në institucion</i>
Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës.	Nga takimi me stafin e programit dhe studentët, GVJ evidentoi që në orën e fundit të leksionit bashkëbisedohej mes pedagogut dhe studentit realizimi i programit të lëndës (bazuar në syllabusin e paraqitur që në fillim të semestrit). GVJ pasi pa me kujdes DVV dhe të gjitha programet e lëndore (syllabuset) konkludoi që PS analizon kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti. <i>Ev. 3.21 Format e vlerësimit</i> <i>Ev. 2.6 Programet e lëndëve (syllabuset)</i>
Kriteri 4. Në përfundim të çdo lënde/moduli, personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për implementimin e tyre dhe testin përfundimtar.	Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion si dhe nga vizita në institucion (takimet me personelin akademik dhe studentët), GVJ konstaton që në përfundim të çdo moduli përkatësisht lënde, nga personeli akademik janë evidentuar çështjet më të rëndësishme të trajtuara si dhe janë orientuar studentët në problematikat më të rëndësishme për të realizuar me sukses testin përfundimtar. Ky konkluzion nxirret edhe nga cilësia e notës mesatare, por edhe nga shkalla e lartë e punëzënjes së të diplomuarve në përputhje me programin e studimit. <i>Ev. 5.17 Orari i konsultimeve</i> <i>Ref. Shënime të vizitës në institucion</i>
Kriteri 5. Personeli akademik (i brendshëm ose i ftuar) realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë jashtë strukturës së programit të studimit.	Stafi akademik i departamentit është i angazhuar në vazhdimësi në veprimtari shkencore jashtë programit të studimit. Lektorët e lëndëve programojnë zhvillimin e orëve të hapura dhe seminarëve me të ftuar të ndryshëm nga bota e biznesit si dhe diskutimin e çështjeve lidhur me zhvillimet më të fundit në fushën e studimit. GVJ është e mendimit se ky kriter është një nga pikat e forta në nivel institucioni dhe programi studimi. <i>Ev. 3.14.1 Leksione të hapura 2</i>
Kriteri 6. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale.	Bazuar në dokumentacion dhe takimin e zhvilluar me stafin e programit, konstatohet që anëtarë të tij realizonin zhvillimin e programit në tema të caktuara nëpërmjet punëve laboratorike. Më e theksuar kjo realizohet në lëndët e "Ekonometri", etj, lëndë këto që në aplikimin e tyre kërkojnë edhe një angazhim shtesë jashtë kornizës së syllabusit duke u zhvilluar në laborator. Gjatë vizitës në institucion GVJ konfirmoi që mësimdhënia realizohet në ambiente përkatëse sipas nevojave të lëndës. <i>Ev. 4.16 Ndërveprimi në sistemin Microsoft Teams</i>

	<p><i>Ev. 3.22 Dokumentat e praktikës</i></p> <p><i>Ev. 3.23 Institucionet e praktikave profesionale</i></p> <p><i>Ref. Shënime të vizitës në institucion</i></p>
<p>Kriteri 7. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara.</p>	<p>GVJ pasi pa me kujdes DVV dhe të gjitha programet e lëndore (syllabuset) konkludoi që lëndët janë hartuar në mënyrë të tillë që të kontribuojë në rezultatet e programit të studimit. Diskutimi dhe puna në grup shërbejnë si metoda interaktive të mësimdhënies dhe mësimnxenies, duke ndihmuar studentët në zhvillimin e aftësive analitike konceptuale dhe inovative për zgjidhjen e rasteve të ndryshme të studimit si problematika të mundshme të ekonomisë. Është e rëndësishme të theksohet se një fokus i veçantë i kushtohet punës në grup, të mësuarit, shkrimit, kërkimit dhe aftësive të prezantimit të studentëve si aftësi të nevojshme për pozicionet përkatëse të punës.</p> <p><i>Ev. 3.18 Model detyra shtëpie</i></p> <p><i>Ev. 3.20 Model detyrë kursi</i></p>
<p>Kriteri 8. Personeli akademik krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të avancuara kërkimore e shkencore dhe mbështet.</p>	<p>Stafi i programit diskuton gjatë zhvillimit të programit por sidomos në fund të tij çështje specifike që kryesisht kanë të bëjnë me aplikimin e njohurive të marra kryesisht në lëndët karakterizuese që lidhen me ekonomiksin. Kjo u evidentua në takimin me stafin që mbulon këtë program. Gjatë bisedimeve me grupin e studentëve, GVJ konstatoi përfshirjen e studentëve në disa konkurse të organizuara nga institucioni ose partnerë të tij, ku ata kishin mundësi të shpalosnin idetë e tyre inovative, dhe thellimin shkencor. GVJ vlerëson pozitivisht këtë kriter.</p> <p><i>Ev. 2.5 Plani strategjik i departamentit të Ekonomiksit</i></p> <p><i>Ref. Shënime të vizitës në institucion</i></p>
<p>Kriteri 9. Institucioni nxit zhvillimin e ideve inovative, studime të avancuara kërkimore e shkencore nga studentët dhe i mbështet financiarisht ato.</p>	<p>Stafi akademik që mbulon këto program realizon një bashkëbisedim dhe komunikim të frytshëm me studentët për të marrë nga ata sugjerimet me qëllim rritjen e cilësisë mësimdhënëse. Një element i rëndësishëm në funksion të këtij qëllimi është edhe pyetësi që plotësohet nga studentët në fund të semestrit ku në të ka rubrikë për këtë qëllim. Gjatë takimit me studentët GVJ u informua për përfshirjen në aktivitete shkencore të studentëve të këtij programi dhe mundësitë që institucioni iu ofronte.</p> <p><i>Ev. 4.11.1 Buxheti i miratuar 2020, fq. 8</i></p> <p><i>Ev. 4.6 Biblioteka FEUT_mjediset</i></p>





	<i>Ev. 4.12 Të dhëna mbi kapacitetet e sallave dhe pajisjet_2</i> <i>Ref. Shënime të vizitës në institucion</i>			
Kriteri 10. Personeli akademik ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve	Eksperiencia që personeli akademik merr gjatë mobiliteteve në institucionet/universitete partnere reflektohet në përmirësimin e formave të mësimdhënies dhe nxit studentët për mobilitete tek partnerët. Në kuadër të programit Erasmus+ janë rreth 80 marrëveshje aktive të cilat ndër të tjera synojnë të rrisin shkëmbimin e personelit akademik dhe studentëve. Gjatë shkëmbimit të eksperiencave promovohen universitetet dhe vendet për të rritur shanset dhe motivimin e studentëve për një eksperience jashtë vendit. FEUT ka gjithashtu marrëveshje me institucione publike dhe sektorin privat që synojnë krjimin e hapësirave dhe mundësive të ndryshme për studentët dhe stafin akademik, duke rritur mundësinë për pjesëmarrje në projekte të përbashkëta, bursa studimi dhe mobilite. GVJ mbështetur në dokumentacion dhe vizitën në institucion konstatoi që personeli akademik ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X



Standardi III.8

Institucioni ndjek një procedurë të qartë të diplomimit të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.


Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton procedurë të posaçme për provimin final ose mbrojtjen e diplomës, para diplomimit të studentëve dhe e bën atë publike.	Studentët e këtij programi, pas përmbylljes së gjithë detyrimeve dhe mbrojtjes së praktikës, kanë të drejtën e mbrojtjes së diplomës përmes një punimi Mikroteze. Procedura e mbrojtjes përfundimtare, diplomimit, është e përcaktuar në rregulloren e UT (neni 60; 61 dhe 62) dhe rregulloren e Fakultetit të Ekonomisë. Ky proces është me i detajuar në udhëzuesin e mbrojtjes së diplomës. Në këtë udhëzues jepen detaje lidhur me strukturën e punimit të mikrotezës, listën e pedagogëve udhëheqës, listën e sugjeruar të temave të mundshme orientuese etj. Mbështetur në DVV, GVJ konstatoi që programi i studimit harton procedurë të posaçme për provimin final ose

	<p>mbrojtjen e diplomës, para diplomimit të studentëve dhe e bën atë publike.</p> <p><i>Ev. 2.1 Plani mësimor i programit të studimit</i></p> <p><i>Ev. 1.8 Rregullore e UT-së e përditësuar, neni 59, fq. 31; neni 60, fq. 32</i></p>
<p>Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të provimit final dhe mbrojtjes së diplomës.</p>	<p>Departamenti i Ekonomiksit, si njësi bazë e programit, së bashku me strukturat ndihmëse, informojnë, ndjekin dhe monitorojnë procesin e mbrojtjes së diplomës me punimin e Mikrotezës. Pas marrjes së informacionit studentët plotësojnë formularin e aplikimit ku përcaktojnë fushën e studimit, strukturën paraprake të tij dhe propozimin për udhëheqësin e punimit. Në Departamentin e Ekonomiksit përcaktohen udhëheqësit për çdo student, të cilët kanë përgjegjësi për mbarëvajtjen e këtij procesi, cilësinë dhe përfundimin në afat. Ky proces u evidentua edhe gjatë vizitës në institucion. Referuar dokumentacionit të dorëzuar, GVJ është e mendimit se PS garanton realizimin e provimit final dhe mbrojtjes së diplomës duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme.</p> <p><i>Ref. https://feut.edu.al/studentet/dokumenta-te-nevojshme-per-studentet</i></p>
<p>Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final, bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë dy viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/ modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.</p>	<p>Lidhur me diplomimin e studentëve, me propozim të përgjegjësit të Departamentit dhe miratimit nga Dekani, ngrihet Komisioni i Provimit të Formimit i cili në vlerësimin e punimit të Mikrotezës bazohet në katër kriteret kryesore:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Ecurinë dhe nivelin e vlerësimit të marrë në mësimet gjatë vitit akademik; • Vlerat teorike shkencore dhe profesionale të punimit; • Vlerësimin që jep pedagogu udhëheqës i punimit të studentit në formularin përkatës; • Nivelin e prezantimit të punimit nga studenti. <p>GVJ konstatoi se kjo praktikë rezulton e plotësuar nga evidentimi me studentë të programeve të tjera që kanë përfunduar programi, pasi studentët e këtij programi ende nuk e kanë përmbyllur programin.</p> <p><i>Ev. 1.1 Statuti, neni 92, pika 2, fq. 57</i></p> <p><i>Ev. 1.4 Rregullore e programit të studimit MSH në Ekonomiks</i></p>





<p>Kriteri 4. Personeli akademik orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të tezës/diplomave.</p>	<p>Në funksion të fushës së punimit të propozuar nga studenti, Departamenti i Ekonomiksit miraton listën e pedagogëve udhëheqës për temat e studentëve. Udhëheqësit e punimeve të Mikrotezës gjatë periudhës së përgatitjes së tij nga studenti mbajnë komunikim të vazhdueshëm duke i orientuar përgjatë kësaj kohe. Roli udhëheqës i pedagogut është këshillues dhe orientues lidhur me përmbushjen e objektivave të qëllimit të punimit, shfrytëzimin e literaturës bashkëkohore nga studenti dhe përfshirja e analizës teorike praktike në punim. Referuar dokumentacionit të dorëzuar, GVJ konstaton një organizim dhe mbështetje efikase të studentëve në përgatitjen e provimit final dhe diplomave.</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.</p>	<p>Gjatë përpunimit të të dhënave të punimit studentët kanë të gjitha mundësitë teknike dhe asistencën e nevojshme për të realizuar këtë fazë të rëndësishme të punimit në laboratorët që ofron institucioni, bibliotekën dhe çdo infrastrukturë të dobishme për ta. Referuar dokumentacionit të dorëzuar dhe vizitës në institucion, GVJ konstatoi se stafi i këtij program ishte mjaft i dedikuar në mbështetjen e kërkimit shkencor të studentëve.</p> <p><i>Ev. 4.12 Të dhëna mbi kapacitetet e sallave dhe pajisjet_2</i></p>
<p>Kriteri 6. Udhëheqësi i diplomës asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e temës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.</p>	<p>Në programin e studimit studentët diplomantë udhëhiqen nga pedagogë të cilët kanë për detyrë ta orientojnë studentin për krijimin e bazës së nevojshme teorike, e cila do ta ndihmojë atë në interpretimin sa më profesional të rezultateve si dhe krijimin e një baze të dhënash të lidhur sa më ngushtë me objektivat e temës së diplomës. Në çdo rast studenti konsultohet me pedagogun udhëheqës në kërkim të zgjidhjeve që synon të realizojë. GVJ është e mendimit se duke patur një numër të limituar studentësh që ndjekin temën e diplomës, asistimi në nxjerrjen e rezultateve si dhe sigurimi i cilësisë së punimit është më i lehtë.</p> <p><i>Ev. 3.25 Formulari i vlerësimit të diplomës</i></p>
<p>Kriteri 7. Në përfundim të provimit ose mbrojtjes së diplomës, studenti vlerësohet me notë.</p>	<p>Komisioni i Provimit të Formimit bazuar në katër kriteret e përmendura më lart, bën vlerësimin e punimit të Mikrotezës me notë përfundimtare. Mbështetur në DVV, GVJ konstatoi se IAL ndjek hapat e duhur deri në pajisjen me diplomë të të diplomuarve, dhe lëshimin e një vërtetimi për diplomën e fituar, të shoqëruar me certifikatën e notave në rast kërkese.</p> <p><i>Ev. 3.25 Formularin nga pedagogu udhëheqës</i></p> <p><i>Ev. 1.8 Rregullore e UT-së e përditësuar, neni 60, fq.32</i></p>



<p>Kriteri 8. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin.</p>	<p>Përmbajtja dhe forma e diplomës dhe suplementit të diplomës është e përcaktuar në Statutin e UT, në përputhje me udhëzimet e Ministrisë së Arsimit dhe Sporteve. Studentët, që kanë plotësuar detyrimet e programit të studimit, pajisen në përfundim të studimeve me diplomën dhe listën e notave, të cilat janë dokumenta zyrtare. Referuar dokumentacionit të dorëzuar, GVJ konstatoi që në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin, të cilën e tërheq pranë sekretarisë mësimore. Ky kriter përmbushet plotësisht.</p> <p><i>Ev. 1.1 Statuti, neni 110-111, fq. 64-65</i></p> <p><i>Ev. 1.8 Rregullore e UT-së e përditësuar, neni 61, fq. 32</i></p> <p><i>Ev. 2.8 Suplementi i Diplomës</i></p> <p><i>Ev. 2.8.1 Formati i diplomës</i></p>			
<p>Kriteri 9. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.</p>	<p>Referuar dokumentacionit të dorëzuar, GVJ konstatoi që në përfundim të programit të studimit çdo student pajiset me diplomën sipas profilit përkatës, suplementin e diplomës; listën e notave dhe sipas kërkesës me një kopje të syllabuseve për të gjitha lëndët e përfshira në programin e studimit.</p>			
<p>Kriteri 10. Institucioni ruan për një periudhë të pacaktuar kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet, rast pas rasti, informacione për studentin, nëse kërkohen</p>	<p>Nga vizita në institucion rezulton se procesi i ruajtjes së gjithë dokumentacionit bazohet në kërkesat ligjore dhe aktet nënligjore në fuqi. Gjithashtu të dhënat e tij ruhen edhe në sistemin informativ të institucionit.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

<p>Shkalla e përmbushjes së standardevë të fushës III</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>
--	-----------------------	------------------------------	-----------------------------	--




**IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA
PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT**

Standardi IV.1

Institucioni i arsimit të lartë ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit, vlerësimit dhe përzgjedhjes së personelit për programin e studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmësmësimor-shkencor dhe administrativ.</p>	<p>FE në UT ka në strukturën e tij edhe Drejtorinë e Burimeve Njerëzore, e cila është përgjegjëse për administrimin e dosjeve të personelit akademik (me kohë të plotë dhe të pjesshme) dhe administrativ i punësuar në FE bazuar edhe në detyrat dhe përgjegjësitë e shprehur në Kreun V në Statutin e UT-së.</p> <p>Gjithashtu në të dhënat e vëna në dispozicion nga institucioni jepet informacion edhe për angazhimin në procesin e mësimdhënies të çdo anëtari të departamentit sipas semestrave dhe vitit akademik. Gjatë vizitës në institucion GVJ konstatoi se në në zyrën e burimeve njerëzore dosjet e personelit akademik si me kohë të plotë dhe me kohë të pjesshme ishin të plota. Institucioni kishte një dokumentacion të ruajtur dhe të përditësuar me të dhënat e stafit akademik i cili ishte i angazhuar në kuadër të këtij program studimi.</p> <p><i>[Ev. 1.7 Organigrama FEUT; Ev. 1.1, neni 51, fq.33; Ev. 4.1 Ngarkesa vjetore e personelit akademik për vitin akademik 2021-2022, Ev. 4.1.1 Ngarkesa vjetore e personelit akademik për vitin akademik 2021-2022; Ref. Shënime të vizitës në institucion]</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni harton dhe zbaton procedura për rekrutimin e personelit akademik, në përputhje me bazën ligjore në fuqi dhe aktet e brendshme rregullatore të institucionit.</p>	<p>Rekrutimi i stafit akademik, ndihmës-akademik, personelit administrativ në Departamentin e Ekonomiksit bëhet në mbështetje të Legjislacionit të Punës në Republikën e Shqipërisë, të ligjit nr.80/2015 “Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë”, akteve ligjore dhe nëngjore të shprehur në Statut neni 67 dhe 68. Kërkesa për rekrutim të stafit akademik (me kohë të plote dhe të pjesshme) dhe stafit ndihmës – akademik buron nga Departamenti. Punësimi realizohet me procedurë konkurrimi të hapur përmes garantimit të një procesi të drejtë dhe transparent. Për të plotësuar nevojat e veprimtarisë mësimore, Departamenti çdo vit, pas planifikimit të ngarkesës vjetore për stafin PAE fton edhe personel akademik me kontratë të përkohshme ose paraqet kërkesën e tij për staf PAK dhe i paraqet Dekanatit listën me propozimet për personelin akademik pas një diskutimi paraprak</p>


	<p>në department. Kriteret për rekrutim të personelit akademik janë të klasifikuara në, kritere të përgjithshme; dhe kritere specifike të propozuara nga departamenti.</p> <p>GVJ konstatoi gjatë vizitës në institucion që IAL zbaton me rigorozitet procedurat për rekrutimin e stafit, të cilat janë të hapura, transparente dhe i japin përparësi përthithjes së personelit akademik me tituj dhe grada.</p> <p><i>[Ev. 1.1 Statuti, Neni 67, fq. 42-43; Ev. 1.6 Rregullore e Administrates së Rektoratit, neni 10, fq.5; Evidencë 1.1, Statuti, neni 67-70, fq.42-44; Ev. 4.2 Procedura e rekrutimit të personelit akademik; Ev. 4.3 Njoftim për vend pune Ekonomiks; Ref. Shënime të vizitës në institucion]</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni harton procedura e kritere të posaçme e specifike për rekrutimin e personelit, të cilat janë pjesë e akteve rregullatore dhe i bën ato publike.</p>	<p>Departamenti i Ekonomiksit është përgjegjës për hartimin e kriteve të veçanta në procesin e rekrutimit të stafit akademik me kohë të plotë ose të pjesshme. Disa nga kriteret specifike janë: eksperiencia në mësimdhënie, veprimtaria kërkimore-shkencore dhe publikimet, pjesëmarrja në projekte, etj. GVJ konstatoi që rregullorja për burimet njerëzore përmban kritere të posaçme e specifike për rekrutimin e personelit.</p> <p><i>[Evidencë 1.1 Statuti, neni 67, pika 3, fq.42-43]</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kritere të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit</p>	<p>Mbështetur në dokumentacionin e dorëzuar nga UT, takimin me personelin akademik dhe personelin e ZBNj, GVJ konstatoi që institucioni ka miratuar dhe zbaton procedura rekrutimi dhe vlerësimi që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e kërkuar të kualifikimit. Procedura e rekrutimit fillon me konstatimin e vendeve vakante nga ana e njësisë bazë e cila harton një Kërkesë për Rekrutim Stafit akademik drejtuar dekanit dhe rektorit. Njëkohësisht, njësitë bazë specifikojnë edhe kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve, kritere që variojnë sipas nevojave specifike të programit të studimit. Kriteret i dërgohen zyrës së BNJ dhe pasi përpunohen prej saj, përcillen te rektori i cili i miraton ato. Shpallja e njoftimeve për vendet vakante publikohet jo vetëm në web faqen e Institucionit por sipas tyre edhe në rrjete sociale e deri në televizione dhe periodikë. Rektori ngre një komision të kryesuar nga dekani i njësisë kryesore të programit të studimit, i cili është përgjegjës për procedurën e rekrutimit e cila kalon në dy faza: faza e parë lidhet me shqyrtimin paraprak të kërkesave të kandidatëve që janë dorëuar pranë zyrës së BNJ, kurse faza e dytë është intervistimi i kandidatëve që plotësojnë</p>

	<p>kriteret e fazës së parë. Komisioni përgatit një raport vlerësimi të kandidatëve e cila i përcillet Rektorit dhe punësimi bëhet pasi merret miratimi i Rektorit.</p> <p><i>[Ev. 1.1 Statuti, neni 67, pika 3, fq.42-43; Ev. 4.2 Procedura e rekrutimit të personelit akademik; Ref. Shënime të vizitës në institucion]</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X



Standardi IV.2

Institucioni i arsimit të lartë ka përgjegjësinë primare për cilësinë e personelit që mbulon programin e studimit dhe mbështetjen për kryerjen e detyrave në mënyrë eficiente dhe efektive

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni angazhohet për krijimin e mjedisit dhe mundësive të përshtatshme dhe të barabarta për kryerjen e detyrave të personelit në mënyrë profesionale.</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion, GVJ konstatoi në vend kushtet e punës dhe mjedisin që i mundësonte personelit akademik, ndihmës akademik dhe administrativ kryerjen e detyrave të tyre përkatëse. Mjediset e Institucionit gjenden në një vendndodhje të mirë në qytetin e Tiranës, lehtësisht të aksesueshme. Zyrat ishin të pajisuar me mobilimin dhe pajisjet teknologjike të nevojshme dhe të gjitha ambientet e Institucionit mbuloheshin nga rrjeti wireless që ofronte Internet për stafin dhe studentët.</p> <p><i>[Ev. 4.4 Pamje e mjediseve të punës të Departamentit të Ekonomiksit; Ev. Aneks Tabelat përmbledhëse _RVB, tabela 16; Ref. Shënime të vizitës në institucion]</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe zhvillimin e mëtejshëm profesional të personelit që mbulon dhe administron programin e studimit.</p>	<p>Mbështetur në evidencat për trajnimet GVJ konstatoi që IAL organizon trajnime në fushën e kërkimit shkencor dhe trajnime profesionale për personelin për zhvillimin akademik e profesional të tyre. Në fushën e kërkimit trajnimet konsistojnë kryesisht tek metodologjitë e kërkimit dhe janë të dedikuara sipas kualifikimit që ka personeli. Ndërsa trajnimet profesionale kanë karakter administrativ për mësimdhënie/trajnim. Për periudhën Nëntor 2021-Qershor 2022 janë realizuar rreth 20 trajnime dhe seminare me personelin akademik, ndihmësakademik dhe administrativë mbështetur në nevojat e identifikuar. Personeli i FEUT-së ka marr pjesë në këto trajnime, ndërkohë që disa trajnerë/lektorë të kësaj qendre janë personel akademik me kohë të</p>



	<p>plotë në FEUT-së GVJ konstatoi nga dokumentacioni dhe gjatë vizitës në institucion që IAL ka organizuar sistematikisht trajnime me personelin akademik duke adresuar nevojat e tyre.</p> <p><i>[Ref. Shënime gjatë vizitës në institucion; Ev. 1.2 Strategjia e zhvillimit të UT-së (2018-2023), fq. 15, fq. 20, fq.24; Ev. 1.5 Plani i Kërkimit Shkencor të Universitetit të Tiranës (2018-2022), objektivi 2, fq.14; Ev. 4.5 Mobilitetet e stafit akademik (2018-2022); Ev. Aneks Tabelat përmbledhëse _RVB, tabela 1 dhe 4].</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni organizon programe specifike për metodat inovative të mësimdhënies e përdorimit të teknologjive të reja, për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimor-shkencor.</p>	<p>Referuar dokumentacionit të dorëzuar dhe vizitës në institucion, GVJ konstatoi që IAL ka organizuar gjithashtu trajnime specifike për kualifikimin e stafit për përdorimin e teknologjive të reja në procesin mësimor si (platformat Teams); si dhe trajnime mbi metoda inovative të mësimdhënies, etj. Shembuj konkretë janë dhe angazhimi i personelit akademik të Departamentit të Ekonomiksit nëpërmjet Bursave për Integrimin e Karrierës të CERGE-EI/Çeki në periudhën 2018-2022, e cila ka sjellë qasje të reja në klasë, nëpërmjet përdorimit të teknikave moderne, të fokusuara te studenti për të revolucionarizuar mendimin e studentëve dhe të kuptuarin e proceseve ekonomike. Gjithashtu, institucioni ka trajnuar pedagogët e rinj në fushën e pedagogjisë dhe metodave të mësimdhënies.</p> <p><i>[Ev. 4.4.2 Bursat e mësimdhënies të CERGE; Ev. 4.4.1 Trajnimi në Hollandë; Ev. 4.4 Trajnimi i 48 pedagogëve të rinj; Ref. Shënime të vizitës në institucion]</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni dëshmon një angazhim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programit të studimeve të ciklit të dytë</p>	<p>Mbështetur tek dokumentat e paraqitura në DVV (Tabelat 1, 2 dhe 6 në evidencën (0.2 Aneks Tabelat përmbledhëse _RVB (shqip), si dhe nga takimet në vizitën në institucion, GVJ konstaton se Departamenti i Ekonomiksit, i cili është edhe njësi bazë përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit, ka një angazhim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të këtij programi, duke përmbushur edhe kërkesat ligjore për numrin dhe nivelin e kualifikimit të stafit të angazhuar në mësimdhënie për këtë program studimi.</p> <p>Për vitin akademik 2019-2020, (13 PAE/2 PAK), nga këta me grada/tituj shkencore 12/2;</p> <p>Për vitin akademik 2020-2021, (14 PAE/2 PAK) nga këta me grada/tituj shkencore 14/2.</p> <p>Për vitin akademik 2021-2022, (14 PAE/1 PAK) nga këta me grada/tituj shkencore 14/1.</p>






	GVJ gjykon që ngarkesa është në përputhje me Udhëzimin nr. 29, datë 10/09/2018 "Për veprimtarinë dhe ngarkesën mësimore të personelit akademik në IAL". [Ev. Aneks Tabelat përmbledhëse RVB, tabelat 12.1 dhe 1]			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.3

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik e kwrkivor, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme mësimore për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse teorike, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.	Mbështetur në dokumentacion, GVJ konstaton se FEUT e zhvillon veprimtarinë mësimore në ndërtesat e veta të cilat kanë një infrastrukturë të kompletuar, komode dhe të përshtatshme për grupet mësimore të këtij programi studimi dhe numrin e studentëve në to, në përputhje me natyrën specifike të këtij programi dhe moduleve të tij. Në kampus ka edhe ambiente në shërbim të mësimi si bibliotekë, sallë interneti, etj. Gjatë vizitës në institucion si dhe mbështetur tek dokumentacioni i dorëzuar në DVV, GVJ konstaton se në funksion të fakultetit / departamentit ka në dispozicion salla për leksione dhe për seminare, 1 sallë interneti, 1 sallë për bibliotekë dhe laboratorë kompjuterësh përveç ambienteve të tjera mbështetëse për programin si mjedis për fotokopje, zyra informimi, zyra për stafin dhe drejtuesit, etj. GVJ konstatoi se të gjitha mjediset plotësojnë normativat teknike dhe janë të përshtatshme për mësimdhënie për këtë program studimi. [Evidencë 4. 12 Të dhëna mbi kapacitet e sallave dhe pajisjet_2; Evidencë 4. 14 Orari mësimor; Evidencë 4. 13 Foto nga sallat; Ev. Aneks Tabelat përmbledhëse RVB, tabela 10; Ref. Shënime të vizitës në institucion]
Kriteri 2. Mjediset mësimore, si: klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të	Gjatë vizitës në institucion si dhe mbështetur tek dokumentat në DVV, GVJ konstatoi se ambientet mësimore në FEUT ishin të pajisura me videoprojektorë, sisteme audio, lidhje interneti wireless dhe tabela inteligjente që krijojnë kushtet për realizimin cilësor të procesit mësimor teorik e praktik. Laboratorët kanë poste të pajisura


<p>teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.</p>	<p>me PC dhe programet përkatëse të nevojshme për zhvillimin e punës laboratorike.</p> <p><i>[Ev. 4. 12 Të dhëna mbi kapacitet e sallave dhe pajisjet _2; Ev. 4. 14 Orari mësimor; Ev. 4. 13 Foto nga salat; Ref. Shënime të vizitës në institucion]</i></p>
<p>Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimi teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.</p>	<p>Në funksion të programit të studimit ka në dispozicion laboratorë informatike. Ata janë të pajisur me kompjutera ku janë instaluar programe profesionale si: Alpha dhe Financa 5, SPSS apo programi i Business English, të cilat mund të ndihmojnë dhe aftësojnë studentët nga ana praktike. Ato janë në dispozicion të studentëve për t'u shfrytëzuar për realizimin e detyrave të kursit apo punimet e diplomës. Shfrytëzimi i këtyre laboratoreve nuk ishte i kufizuar vetëm gjatë orarit mësimor, por edhe sipas kërkesave dhe nevojave të studentëve të programit të studimit.</p> <p><i>[Ev. 4. 12 Të dhëna mbi kapacitet e sallave dhe pajisjet; Ev. 4. 14 Orari mësimor; Ev. 4.13 Foto nga sallat]</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron.</p>	<p>Gjatë vizitës në institucionin GVJ konfirmoi që IAL ka 15 laboratorë informatike, në pajisjet e të cilave janë instaluar programet e nevojshme për të realizuar një proces mësimdhënie efektiv. Studentët kanë akses në laboratore dhe mund t'i përdorin për të realizuar detyrat e kursit, esetë dhe punimet e diplomës.</p> <p><i>[Ev. 4. 12 Të dhëna mbi kapacitet e sallave dhe pajisjet _2; Ev. 4. 14 Orari mësimor; Ref. Shënime të vizitës në institucion]</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera (vërtetuar nëpërmjet marrëveshjeve të posaçme të bashkëpunimit), që mjediset janë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e</p>	<p>Në dokumentacionin e dorëzuar në DVV, GVJ gjen disa marrëveshje bashkëpunimi me institucione akademike dhe subjekte biznesi të cilat mundësojnë zhvillimin e praktikave nga ana e studentëve.</p> <p>Marrëveshjet e bashkëpunimit për praktikat profesionale janë hartuar me qëllim që studentët përveç anës teorike të mësojnë dhe anën praktike. Po kështu, gjatë vizitës në Institucion, studentët konfirmuan angazhimin e FEUT për praktikat e tyre. <i>[Ev. 2.4 Lista e praktikave të studentëve; Ev. 2.18 Lista e marrëveshjeve; Ev. 3.22 Dokumentat e praktikës]</i></p>

praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike				
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X



Standardi IV.4

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve mjedise mbështetëse të mësimnxënies, bibliotekën, mjedise të posaçme të mësimnxënies dhe literaturën e nevojshme në mbështetje të procesit të mësimnxënies për studentët e programit të studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.	GVJ vizitoi bibliotekën dhe konstatoi që ambjenti ishte i hapur, me ndriçim natyral, me tavolina të vendosura në distancë për një shfrytëzimi të mjedisit në mënyrë optimale. Fondi i librave ishte i hapur dhe mund të konsultohet lirshëm nga studentët. Në sallën e bibliotekës ishin të instaluar dhe PC, të cilat mund të përdoren për të aksesuar bibliotekat online. Studentët mund të regjistrohen dhe të tërheqin libra nga fondi i bibliotekës. <i>[Ev. 4.6 Biblioteka FEUT_mjediset; Ev. 4.10 Informacion nga Biblioteka e FEUT; Ev. 1.7 Organograma FEUT; Ev. Tabelat përmbledhëse RVB, tabela 10; Ref. Shënime të vizitës në institucion]</i>
Kriteri 2. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me literaturë fizike, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.	Nga vizita në institucion rezulton se Biblioteka është përgjithësisht e pajisur me literaturë fizike (rreth 5280 tituj) në shqip dhe anglisht, që përfshijnë tekste mesimore, libra, revista periodike/buletine të institucioneve punime mikroteze dhe doktorature etj. Sherbimi në bibliotekë mbulohet nga 3 punonjes dhe ofrohet në dy ambjentet e veçuara, në vendin e terheqjes se librave dhe sallën e hapur për studim. <i>[Ref. Shënime gjatë vizitës në institucion; Evidenca 4. Lista e librave në Bibliotekën e FEUT në funksion të programit MSH në Ekonomiks]</i>
Kriteri 3. Institucioni duhet të krijojë kushte për akses të	Shërbimet aktuale që ofron biblioteka u ofrojnë akses të barabartë përdoruesve potencial (studentëve dhe stafit akademik) dhe pa



<p>barabartë e pa pagesë për studentët, në bibliotekat on-line të fushës së programit të studimit.</p>	<p>kosto pasi ata antaresohen pranë saj. Gjithashtu, biblioteka ofron sherbimin online fale marreveshjes se bashkepunimit të UT me Fondacionin Shqiptaro Amerikan pe Zhvillim (AADF) për abonim në biblioteken digjitale JSTOR me akses në mbi 12,000 revista ekonomike, apo rreth 85,000 libra. Biblioteka e Fakultetit të Ekonomise tashme është edhe pjese e programit COBIS që u mundeson perdoruesve të saj akses në baza të dhenash apo informacion të dobishen në fushen e ekonomise për të analizuar dhe perdorur në punime kerkimore shkencore. GVJ konfirmon plotësimin e kushteve për akses të barabartë e pa pagesë për studentët, në bibliotekat on-line të fushës së programit të studimit.</p> <p><i>[Ev. 4.7 Jstor_University of Tirana 2020 IPA marreveshje; Ev. 4.8 UT_manual perdorimi Jstor; Ref. Shënime të vizitës në institucion]</i></p>
<p>Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizime nga ana e të gjithë studentëve.</p>	<p>Gjatë vizitës në bibliotekë GVJ konstatoi që në PC e vendosura në sallë ishin instaluar programet e nevojshme kompjuterike, të cilat mundësojnë shfrytëzimin e literaturës nga ana e studentëve. Konkretisht, kompjuterat janë të pajisur me programe kompjuterike si apache, eclipse, Microsoft office, eviews, stata, spss dhe mund të shfrytëzohen pa kufizim nga të gjithë studentët.</p> <p><i>[Ref. Shënime gjatë vizitës në institucion; Ev. 4.10 Informacion nga Biblioteka e FEUT; Ev. 4.11 Të dhëna mbi kapacitetet e sallave dhe pajisjet_2]</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni duhet të hartojë e zbatojë një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës, përditësimin e fondit ekzistues në mbështetje të programit.</p>	<p>Procedurat për pasurimin e bibliotekës janë parashikuar në dokumentin mbi funksionimin e bibliotekës. Në bazë të dokumentacionit të dorëzuar GVJ konstatoi që IAL pasuron vazhdimisht fondin e librave përmes blerjeve në vite. Referuar RVB-sc, kërkesa bëhet e specifikuar nga titullarët e lëndëve ku përfshihet titulli, autori, shtëpia botuese, viti i botimit dhe numri i kopjeve. Përgjegjësi i departamentit përcjell nevojat e departamentit tek administratori i FEUT-së. Në periudhën 2020-2022 fondit të bibliotekës iu shtuan gjithësej 342 tituj ose 874 copë libra. Fondi për departamentin e Ekonomiksit ka qenë 37 tituj ose 101 copë libra. Për çdo vit financiar kërkohet prej njërive bazë të përcjellin nevojat për pasurimin e literaturës në fondin e bibliotekës.</p> <p><i>[Ev. 4.11 Buxheti i miratuar 2019, fq.8, pika 6; Ev. 4.11.2 Buxheti i miratuar 2021, fq.10, pika 6; Ev. 4.10.1 Lista e plotë e librave të bëra hyrje në bibliotekë në periudhën 2019-2021]</i></p>






<p>Kriteri 6. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj</p>	<p>Salla e Bibliotekës së Institucionit konsiderohet njësi ndihmëse në funksion të arritjes së objektivave primare të programeve të studimit dhe si të tilla oraret e tyre duhet të koordinojnë me oraret e ofrimit të mësimin në programet e studimit. Ajo ishte gjithashtu e pajisur me printer dhe fotokopje në funksion të kërkesave të studentëve. Oraret e funksionimit të sallave në periudha normale ishin nga ora 8.30 – 19.30. Ajo qendron e hapur ne fundjave per sezonin e provimeve. <i>[Ref. Vizita në institucion]</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>



Standardi IV.5

Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.</p>	<p>Administrimi i informacionit që lidhet me studentet dhe aktivitetin e tyre mbulohet nga sekretaria mesimore e FE të UT. GVJ gjate vizites realizoi takime dhe monitorime pranë sekretarise mesimore, ku evidentoi administrimin korrekt të informacionit për studentet që në fazen e regjistrimit të tyre deri në procesin e diplomimit. GVJ evidentoi regjistrat themeltar që mbahet për studentet e ketij programi, dosjet e studenteve në fillim të procesit mesimor, regjistrat e grupeve, procesverbalet e vleresimit, hedhjen e tyre në regjistrin themeltar etj. Një zhvillim pozitiv se fundmi është edhe perfitimi i dy sherbimeve nga studentet nepermjet platformes qeveritare e-Albania ku studentet kanë mundesi të marrin dy dokumente të rendesishme; Listen e notave dhe Vertetimin e diplomes</p> <p><i>[Ref. Shënime gjatë vizitës në institucion; Ev. 1.8 Rregullore e UT-së e përditësuar, nene 42, fq.25; Ev. 3.11 Regjistri themeltar i studentëve; Ev. 3.12 Rregjistri i arritjeve akademike të studentit; Ev. 3.13 Rregjistri i lëshimit të diplomave Ev. 4.15 Manuali pedagogut e _student]</i></p>

<p>Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmësakademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.</p>	<p>Referuar RVB, strukturat përgjegjëse për ruajtjen e dokumentacionit të personelit akademik e ndihmës akademik janë Zyra e Burimeve Njerëzore dhe Protokoll Arshiva.</p> <p><i>[Ev. 4.17 Dosja e personelit akademik me kontratë; Ref. Shënime të vizitës në institucion]</i></p>
<p>Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Personeli dhe studentet pas kërkeses se tyre kanë akses informacioni që zoterohet nga Sekretaria mesimore. Se fundmi është ngritur dhe funksionon Sistemi i Menaxhimit të Informacionit (SIM) që u jep mundësi aksesit përdoruesve (pedagoge, student Dege e IT etj).</p> <p><i>[Ev. 4.15 Manuali pedagogut e student]</i></p>
<p>Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit dhe studentëve.</p>	<p>FE siguron informacionin e nevojshëm edhe nepermjet platformave e-learning në Google classroom dhe Microsoft Teams. Rrjetet sociale të njohura tashmë në tregun e informacionit janë mjete të tjera në funksion të marrjes dhe dhënies së informacionit që mbështetet me infrastrukturën e duhur. Sistemet e përmendura me lart mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit mes personelit akademik dhe ndihmës me studentët <i>[Ev. 4.16 Ndërveprimi në systemin Microsoft Teams]</i></p>
<p>Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet drejtuese dhe titullarët.</p>	<p>GVJ konstatoi mbështetur në DVV që platforma dixhitale MS Teams mundëson monitorimin e aktivitetit akademik në kohë reale. Nga sistemi janë gjeneruar raporte të cilat kanë tregues të rëndësishëm për monitorimin e të gjithë aktivitetit akademik. GVJ konstatoi gjithashtu që raportet janë gjeneruar kryesisht në periudhën kur mësimi është zhvilluar online.</p>
<p>Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy</p>	<p>GVJ vizitoi faqen e internetit të UT-së/FEUT-së, dhe konstatoi që institucioni ka të publikuar në mënyrë të përmbledhur dhe të strukturuar shumë mirë të gjithë informacionin që lidhet me veprimtarinë e universitetit, programet e studimit, personelin akademik sipas fakulteteve dhe departamenteve; informacionin mbi pranimet, bursat, transferimet dhe aplikimin e studentëve;</p>

gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe	informacionin mbi kërkimin shkencor, projektet dhe partnerët; si dhe shërbimet për studentët. Informacioni është i publikuar në dy gjuhë: shqip dhe anglisht dhe është i përditësuar. [Ref. https://feut.edu.al/ ; Ref. https://unitir.edu.al/]			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.6	
Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të programit të studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programit të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorzuar në DVV, UT përcakton në Statutin pikat që lidhen me buxhetin dhe aspektet financiare ("Statuti i UT", nenet, 24, 45). Sipas statutit buxheti hartohet nga Administratori i Universitetit bazuar në një plan afatmesëm 3 vjeçar, Planin Strategjik të Institucionit dhe nga propozimet e marra nga strukturat e Njësive Kryesore dhe Njësive Bazë. Ai aprovohet nga Bordi i Administrimit i UT dhe është i realizuar në përputhje me standardet ligjore. [Ev. 1.1 Statuti, neni 144, fq.75; Ev. 4.18 Buxheti UT_2019; Ev. Ev. 4.11 Buxheti i miratuar 2019; Ev. 4.11.1 Buxheti i miratuar 2020; Ev. 4.11.2 Buxheti i miratuar 2021; Ev. 4.19 Raport financiar UT_2020_2021]
Kriteri 2. Plani i financimit të një programi studimi duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programit, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për	Siç u evidentua në kriterin 1, institucioni harton pasqyra financiare të konsoliduara dhe në këto pasqyra evidentohen të gjitha shpenzimet për paga dhe sigurime shoqërore, shpenzimet operative dhe shpenzimet kapitale, bursat e studentëve, investimet për mirëmbajtjen e mjediseve, blerjen e pajisjeve laboratorike, shpenzimet për pasurimin e bibliotekës, aksesin në bibliotekat "online", etj. Në pasqyrat financiare janë të përfshira gjithashtu të ardhurat nga të gjitha burimet, të cilat janë lehtësisht të lexueshme. UT nuk harton plane financimi të veçanta për çdo program studimi. Megjithatë ajo mban parasysh kostot e institucionit dhe këto


<p>bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat on-line, detyrimet financiare, grantet vendëse apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programit të studimit dhe zëra të tjerë, sipas natyrës specifike të tij.</p>	<p>reflektohen në propozimin e Njësive kryesore për kuotat dhe tarifat e studimit.</p> <p><i>[Ev. 4.11 Buxheti i miratuar 2019; Ev. 4.11.1 Buxheti i miratuar 2020; Ev. 4.11.2 Buxheti i miratuar 2021; Ev. 4.20 Kuotat-Master-i-shkencave_2021_2022]</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni kryen auditim të përvitshëm, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij. Raporti financiar përmban një pasqyrë të hollësishme financiare të të ardhurave nga tarifat e shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare për studentët ose ndarjen e burimeve financiare.</p>	<p>Procesi i auditimit realizohet nga njesia e posaçme që në nivel institucioni është Drejtoria e Auditimit të Brendshëm dhe që tashme varet drejtperdrejt nga Bordi i Administrimit. Kjo njesi realizon auditime të përvitshme me fokus menaxhimin e fondeve në dispozicion të institucionit ku janë evidentuar ecuritë dhe problemet financiare. Në bazë të metodologjive të percaktuar UT harton planin Buxhetor afatmesem i cili miratohet në Senatit Akademik dhe shërben si bazë për projekt Buxhetet vjetore. Ky projekt Buxhet bazohet në propozimet e cdo njesie kryesore, në rastin konkret FE i UT. Vetë projekt buxheti i FE bazohet në të dhenat ekonomiko financiare të njesive bazë që janë 6 Departamentet perkatese. Pra zbatohet parimi i hallkes bazë në planifikim</p> <p><i>Evidence 4.11.Buxheti i miratuar për vitin 2019; 2020; 2021;</i></p> <p><i>Evidence 4.21 Program auditi;</i></p>
<p>Kriteri 4. Në mbyllje të çdo cikli të plotë studimi, institucioni dokumenton raportet financiare për tri vitet e kaluara akademike dhe planifikon ndërhyrjet e posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programit për të garantuar ecurinë dhe mbarëvajtjen normale të tij.</p>	<p>Mbështetur në DVV, GVJ konfirmoi që institucioni përmes Bordit të Administrimit diskuton dhe miraton të gjitha raportet dhe analizat financiare periodike të hartuara nga Drejtoria Ekonomike dhe e Shërbimeve Mbështetëse në Rektorat dhe Administratori i UT-së. Raportet i përcillen për dijeni Senatit Akademik dhe MAS. Këto raporte ruhen dhe bëhen publike në faqen e transparencës së UT-së.</p> <p><i>[Ev. 4.19 Raport financiar_UT_2020_2021; Ev. 4.18 Buxheti_UT_2019]</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni duhet të dëshmojë se garanton</p>	<p>UT si institucion si dhe FE i UT si njesia kryesore e këtij programi kanë qendrushmeri financiare duke mbuluar shpenzimet me të</p>

qëndrueshmërinë financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave të domosdoshme në të ardhmen	ardhurat, rrjedhoje kjo kryesisht e numrit të madh të studenteve dhe fitimit të projekteve të ndryshme me institucione homologe vendase dhe të huaja. <i>[Ev. Aneks Tabelat përmbledhëse _RVB, tabela 18]</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1	
Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.</p>	<p>Programi i studimit Msc në Ekonomiks, me 120 ECTS është konceptuar dhe zhvillon veprimtarinë e tij në përputhje të plotë me Ligjin e Arsimit të Lartë Nr 80/2015 dhe VKM Nr 41 dt 24.01.2018, për Elementët e Programit të Studimit të Ofruar nga ILA-të, si dhe një sërë dokumentash ligjorë dhe rregullatorë si:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Statuti UT; - Rregullorja e UT; - Rregullorja e FEUT; - Rregullorja e Departamentit; - Rregullorja e Programit të Studimit; <p>Të gjitha këto akte mbulojnë të gjithë veprimtarinë e punës së njësisë kryesore dhe bazë nga hyrja e studentëve në programin master, deri në diplomimin e tyre</p> <p><i>[Ev. 1.2 Strategjia e zhvillimit të UT-së (2018-2023), fq.18;</i> <i>Ev. 1.1 Statuti, neni 92, fq.57; neni 94, fq. 58-59, nenet 109-110, fq. 64;</i> <i>Ev. 1.4 Rregullore e programit të studimit MSH në Ekonomiks neni 10, fq. 5-6; neni 18, fq.10;</i> <i>Ev. 5.1 Kriteret-e-pranimit-për-vitin-akademik-2022-2023-Cikli-i-II-të]</i></p>
<p>Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje, garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Studentët që nga momenti i hyrjes deri në dalje nga studimet gëzojnë të drejtën të trajtohen në mënyrë të njëjtë në të gjithë elementët dhe strukturat përgjegjëse të njësisë kryesore dhe bazë të programit Msc në Ekonomiks, të marrin pjesë në përputhje me Ligjin e Arsimit të Lartë, Statutin dhe Rregulloret në një sërë organesh kolegjiale nga Senati, në proceset e akreditimit përmes pjesëmarrjes në grupet e Vlerësimit të Brendshëm, në Këshillin e Etikës, etj. Studentët janë pjesë e Bordit të Administrimit, gëzojnë të drejtën e votës në zgjedhjet për trupën drejtuese të departamenteve / fakulteteve dhe universitetit si dhe përzgjidhen përmes votës së shokëve të tyre në</p>



	<p>Qeverinë Studentore dhe Këshillat Studentorë. Studentët gëzojnë gjithashtu të drejtën të përfitojnë bursa studimi, bursa Erasmus, të përfshihen në projekte, të marrin pjesë në aktivitete e seminare extracurriculare, etj.</p> <p><i>[Ev. 1.1 Statuti neni 94, fq. 58-59; Ev. 1.1 Statuti, nenet 125-126, fq. 69-70;</i></p> <p><i>Ev. 1.2 Strategjia e zhvillimit të UT-së (2018-2023), fq.6;</i></p> <p><i>Ev. 5.2 Kuotat-e-veçanta-trojet_2021_2022]</i></p>
<p>Kriteri 3. Kriteret, procedurat e pranimit e përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjeshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.</p>	<p>Universiteti i Tiranës dhe Fakulteti Ekonomisë bëjnë të aksesueshme në faqet e tyre zyrtare në internet të gjithë informacionin që ndihmon të gjithë të interesuarit (aplikantët për studime dhe studentët aktuale) për të marrë vendime dhe kuptuar proceset. Krahas informacioneve që kanë të bëjnë me aspektet rregullatore të universitetit dhe fakultetit, që ndihmojnë studentët për të kuptuar gjithë procesin nga aplikimi, përzgjedhja, rregjistrimi, transferimi dhe njohja e krediteve, diplomimi, në WEB gjenden programet e studimit, departamentet, stafi akademik dhe shumë informacione të tjera përfshirë dhe email e kontaktit të pedagogëve.</p> <p>Në këtë link të WEB https://feut.edu.al/studentet studentët gjejnë të gjitha informacionet e nevojshme për jetën e tyre studentore, si dhe shumë nga procedurat, formularët për praktikën dhe diplomën. Gjithashtu, departamenti i Ekonomiksit ka hartuar dhe publikuar "Guidën e Departamentit" e cila përmban informacion të plotë mbi programin e studimit "MSH në Ekonomiks". GVJ është i mendimit se IAL bën të mundur publikimin e të gjithë informacioneve të nevojshme.</p> <p><i>[Ev. 5.3 Kuotat e pranimit cikli dytë_vendim SA;</i></p> <p><i>Ev. 1.1 Statuti, kreu VII, organizimi i studeimeve në UT, fq. 55-66;</i></p> <p><i>Ev. 1.4 Rregullore e programit të studimit MSH në Ekonomiks;</i></p> <p><i>Ev. 5.4 Guida e departamentit Ekonomiksit;</i></p> <p><i>Ref. Shënime të vizitës në institucion]</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve, për t'u pranuar në ciklin e dytë të studimeve.</p>	<p>Referuar dokumentacionit të dorëzuar, GVJ konstatoi që IAL harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve, për t'u pranuar në ciklin e dytë të studimeve, specifikisht në MSH në Ekonomiks, të cilat gjenden në faqen zyrtare të UT-së dhe në faqen zyrtare të FEUT-së.</p>


	[Ev. 1.1 Statuti, neni 94, fq. 58-59; Ev. 5.1 Kriteret-e-pranimit-për-vitin-akademik-2022-2023-Cikli-i-II-të, fq.15; 5.5 Lista e kandidatëve fitues në studimet e ciklit të dytë]			
Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni i arsimit të lartë udhëzon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit	GVJ mbështetur në dokumentacion konstatoi që IAL përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni udhëzon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit nëpërmjet informacionit në website-n e tij, pritjes dhe informimit nga këshilluesit e karrierës, komunikimit me zyrën e pranimeve, takimeve me studentët e ciklit të parë para diplomimit në të gjitha programet e studimit të FEUT-së, etj.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.2	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.	Bazuar në dokumentacionin e aplikimit pran ASCAL-it të institucionit si dhe nga takimi me studentet dhe stafin akademik të programit gjate vizites në instituion konkludojme që studentët e regjistruar në këtë program marrin informacion lidhur me ecurinë apo progresin akademik të tyre permes disa kanaleve të komunikimit. Informacionin e pergjithshem studentet e marrin nepermjet faqes se internetit të UT dhe sidomos të FE të UT në të cilat perditesohen informacionet dhe dalin njoftimet me të fundi. Po në kete rruge komunikimi merret informacion për orarin mesimimor grafikun e provimeve datat e eventeve të tjera etj. Informacion me specifik të modulit të programit studentet e marrin në fillim të zhvillimit të lendes nepermjet titullarit perkates në seminarin udhezues që zhvillohet javen e pare të mesimit. Ketu njihen me syllabusin e modulit, literaturen bazëdhe ndihese, format e vleresimit etj. një kanal tjetër komunikimi lidhur me mesimdhenien janë edhe perdorimi i adresave elektronike të pedagoqeve dhe studenteve të



	<p>cilat mund të jenë individuale por edhe adresa të grupeve mesimore ku informohen lidhur me vleresimet, njoftimet për reklamim, etj. Gjithashtu, studentët marrin nformacione dhe në faqen zyrtare të pedagogut përkatës.</p> <p>[Ev. 1.8 Rregullore e UT-së e përditësuar, nenet 45-54, fq. 26-30; neni 59, fq. 31;</p> <p>Ev. 1.4 Rregullore e programit të studimit MSH në Ekonomiks, neni 16, fq.9, neni 18, fq. 10;</p> <p>Ref. Shënime të vizitës në institucion]</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.</p>	<p>Një nga përfitimet më të rëndësishme të Procesit të Bolonjës, është mobiliteti studentëve brenda dhe jashtë vendit. UT bazuar dhe në Ligjin Nr 80/2015 për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor, në Statutin e tij përkatësisht Neni 109 dhe 112 ka përcaktuar kriteret dhe procedurat e njohjes së krediteve dhe të transferimit të tyre nga një institucion i arsimit të lartë brenda dhe jashtë vendit. Në Rregulloren e Universitetit kapitulli 3 të emërtuar “Ekuivalentimi, tranferimet dhe ndryshimi i sistemit të studimeve” përmes një numri nenesh përcaktohen dhe qartësohen: Ekuivalentimi; Lloji i transferimeve; Procedura e Kërkesës, Propozimi dhe Miratimi i Transferimit; Ekuivalentimi. Si rregull, Drejtuesi i departamentit përcakton komisionin e ekuivalentimit i cili shqyrton të gjitha kërkesat që vijnë qoftë për transferimet, programe të dytë studimi apo është një kërkesë ligjore në kuadër të njohjes së diplomave të huaja</p> <p>Ev. 1.1 Statuti, neni 109, fq. 64;</p> <p>Ev. 1.8 Rregullore e UT-së e përditësuar;</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion dhe referuar DVV, GVJ konfirmoi që IAL i përmbahet kriterëve dhe procedurave të vlerësimit të dijeve dhe aftësive të studentëve të cilat janë të përcaktuara në rregulloren e UT-së dhe rregulloren e programit të studimit. Gjithashtu, syllabuset e secilës lëndë, japin informacion të detajuar për vlerësimin e njohurive dhe aftësive. Të gjitha këto dokumente u bëhen të njohura studentëve me fillimin e studimeve në FEUT. Pas takimit me stafin dhe studentët, GVJ shpreh përbushjen e këtij kriteri.</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe</p>	<p>Nga takimi me studentët e këtij programi u konfirmuam se ata ishin njohur me kriteret dhe procedurat e përgatitjes dhe mbrojtjes së punimit të mikrotezës që në fillim të vitit të dytë si nëpërmjet udhëzuesit të institucionit, ashtu edhe nga pedagogët përkatës dhe</p>

<p>diplomimit në programin e studimit.</p>	<p>njëkohësisht udhëheqësit e punimeve. Gjithashtu, një informacion në këtë drejtim studentët marrin edhe nga faqja e internetit të UT dhe FE të UT. Afatet e diplomimit janë të parashikuara në rregulloren e UT-së.</p> <p><i>Ev. 1.3 Propozim për hapjen dhe organizimin e programeve të studimit të ciklit të dytë, fq. 8;</i></p> <p><i>Ev. 1.8 Rregullore e UT-së e përditësuar, neni 59, fq. 31;</i></p> <p><i>Ev. 3.13 Format mikroteze;</i></p>			
<p>Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit</p>	<p>FE është aktive në lidhje me informimin e studentëve. Faqja website ofron një gamë të gjerë informimi në lidhje me programin mësimor, kuotat, kriteret e veçanta, infrastrukturën e tj. Broshura, fletëpalosje vihen në dispozicion të publikut me qëllim informimi. Fushata ndërgjegjësimi ndërmerren nga Departamenti Ekonomiksit, duke organizuar edhe takime me gjimnazistët e shkollave të mesme dhe informimin e tyre për programin e studimit.</p> <p><i>GVJ sugjeron që Njësia Bazë të gjejë mënyra të tjera më efektive që do ndihmonte në përthithjen e studenteve në numër dhe në cilësi.</i></p> <p><i>[5.4 Guida e departamentit Ekonomiksit]</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>


<p>Standardi V.3</p>	
<p>Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxëniet dhe mundësitë e punësimit.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve.</p>	<p>GVJ konstaton një mirë informim të studentëve në lidhje me programin mësimor. Takimi i zhvilluar me ta solli shembuj të informimit që në javën e parë të regjistrimit të tyre me fakultetin, mjediset dhe stafin. Tabela informuese janë vendosur në vende të dukshme për të dhënë informacion në lidhje me oraret mësimore dhe klasat për zhvillimin e tyre. Kujdestari akademik i cili caktohet nga njësia bazë në fillim të çdo viti akademik është përgjegjës për orientimin e studentëve. Sekretaria mësimore është përgjegjëse për regjistrimin e studentëve duke informuar ata në</p>



	<p>lidhje me dokumentacionin plotësues dhe pajisur me kartën e studentit dhe për detyrimet që ata kanë gjatë procesit mësimor. Të drejtat dhe detyrimet e studentëve në lidhje me programin mësimor shprehen qartë edhe në dokumentat bazë. Departamenti Ekonomiksit ka hartuar dhe një guidë, e cila përmban informacion të vlefshëm për programin e studimit dhe strukturat e FEUT-së. Një përmbledhje mbi programin e studimit është publikuar dhe në faqen e FEUT-së.</p> <p><i>[Ev. 5.4 Guida e departamentit Ekonomiksit;</i></p> <p><i>Ref. https://feut.edu.al/programe-studimi/master/master-shkencor/31-ekonomiks/</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/udhëzues të posaçëm për modulet, lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.</p>	<p>Informacioni rezulton të merret në javën e parë të vitit akademik, merret nga çdo titullar i lëndëve, i cili informon në detaje strukturën, përmbajtjen, frekuentimin, vlerësimin, kreditet, objektivat, veprimtaritë formuese dhe qëllimet e lëndës. Studentët këto informacione mund ti marrin edhe nëpërmjet faqes web, nëpërmjet sistemit elektronik dhe ndërmjet sekretarisë mësimore. Ky informacion u konfirmua dhe nga takimet më vete studentët dhe zyrat përkatëse.</p> <p><i>Ev. 2.6 Programet e lëndëve (syllabuset);</i></p> <p><i>Ev. 3.10 Platforma MS Teams;</i></p> <p><i>Ref. Shënime të vizitës në institucion]</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.</p>	<p>Bazuar në RVB dhe vizitën në institucion në takimin me zyrën e këshillimit të studentëve dhe Alumni-t, ata merrnin informacion mbi mundësinë e punësimit pas diplomimit të tyre. Si bazë shërben edhe studimi i tregut të realizuar në institucion. Informacioni i nevojshëm për studentet përditësohet dhe ata e kanë mundësinë ta marrin nëpërmjet të gjitha formave të përmendura më lart.</p> <p><i>Ev. 2.4 Lista e drejtuesve të mikrotezave/praktikave;</i></p> <p><i>Ev. 5.7 Panairi punes 2022;</i></p> <p><i>Ev. 5.8 Projekte me ndikim ne punesimin e studenteve;</i></p> <p><i>Ev. 5.9 Mundesi intershipi;</i></p> <p><i>Ref. Shënime të vizitës në institucion</i></p>


<p>Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.</p>	<p>Informacioni në funksion të studentëve vihet në shërbim të studentëve kryesisht përmes kanaleve të mëposhtme të komunikimit:</p> <ul style="list-style-type: none"> - WEB i UT; - WEB i FEUT; - Pedagogëve; - stendës së FEUT në hyrje të fakultetit; - koordinatorit të programit; - sekretarisë mësimore; <p><i>Ev. 3.6 Struktura Mësimore për Vitin Akademik 2021–2022, Master i Shkencave dhe Master Profesional, Viti i Parë;</i></p> <p><i>Ev. 4.14 Orari për ciklin e dytë;</i></p> <p><i>Ev. 5.4 Guida e departamentit Ekonomiksit</i></p>			
<p>Kriteri 5. Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.</p>	<p>Mësimi online për shkak të pandemisë, krijojë dhe një mënyrë tjetër të komunikimit pedagog-studentë përmes sistemit MS Teams, i cili mundësoi jo vetëm mësimin online, por dhe komunikimin e informacioneve, depozitimim e materialeve të ndryshme didaktike nga pedagogët por dhe upload-imin materialeve, detyrave etj nga studentët. Edhe nga takimi me studentët e programit, opinioni i tyre mbi lehtësinë e marrjes së informacionit ishte pozitiv.</p> <p><i>Ev. 3.2 Udhëzues-i-UT-për-mësimin-në-distancë</i></p>			
<p>Kriteri 6. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin mësimor të studentëve</p>	<p>Fakulteti është duke e përditësuar sistemin e menaxhimit të informacionit, siç edhe shprehen në Raportin e Vlerësimit të Brendshëm. Gjatë vizitës në institucion nuk mundëm të shikonim si në përditshmëri kryhet komunikimi, studentët marrin informacionet që ju duhen, si aksesojnë pedagogët e si komunikojnë me studentët.</p> <p><i>GVJ sugjeron, funksionimin sa më shpejt të sistemit të menaxhimit të informacionit, i cili do të lehtësonte marrëdhënien dhe ndërveprimin student-pedagog-sekretari mësimore.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X	




Standardi V.4

Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilin e studentëve që ndjekin programin e studimit të ciklit të dytë, nga pranimi në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre përmes një sistemi menaxhimi informatik të brendshëm.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve												
<p>Kriteri 1. Institucioni disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve në programin e studimit.</p>	<p>Bazuar në Ligjin e Arsimit të Lartë Nr. 80/2015, Rregulloren e UT çdo fakultet ka brenda njësisë së administratës, Sekretarinë Mësimore. Në Sekretarinë Mësimore mbahen të gjitha statistikat në lidhje me numrin e studentëve: të regjistruar, të diplomuar, largimet, pezullimet, transferimet, ecuria e studentëve; proces-verbalet e provimeve, regjistri themeltar, dosjet e çdo studenti sipas udhëzimeve të MAS. Mbështetur në DVV dhe vizitën në institucion rezulton se numri i studentëve për katër vite akademike është:</p> <table border="1" data-bbox="619 884 1412 1198"> <thead> <tr> <th>Emri i rprogramit</th> <th>Viti Akademik</th> <th>Studentë të regjistruar</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td rowspan="4">Msc në Ekonomiks</td> <td>2018-20019</td> <td>27</td> </tr> <tr> <td>2019-2020</td> <td>22</td> </tr> <tr> <td>2020-2021</td> <td>50</td> </tr> <tr> <td>2021-2022</td> <td>17</td> </tr> </tbody> </table> <p><i>Ev. 5.10 Statistika mbi studentet e diplomuar ne FEUT;</i> <i>Ev. 5.11 Lista e studenteve të c' regjistruar 2020-2021;</i> <i>Ev. 6.6 Raporti vjetor i UT-së 2019-2020, fq. 10-14;</i></p>	Emri i rprogramit	Viti Akademik	Studentë të regjistruar	Msc në Ekonomiks	2018-20019	27	2019-2020	22	2020-2021	50	2021-2022	17
Emri i rprogramit	Viti Akademik	Studentë të regjistruar											
Msc në Ekonomiks	2018-20019	27											
	2019-2020	22											
	2020-2021	50											
	2021-2022	17											
<p>Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit të ciklit të dytë, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimit.</p>	<p>Sipas dokumentacionit të përcjellë dhe vizitës në institucion,u evidentua mbajtja e statistikave vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në program, largimet para përfundimit etj. Kjo u evidentua dhe konfirmua edhe gjatë vizitës në sekretarinë mësimore, në regjistrin themeltartë studentëve të këtij programi. GVJ shqyrtoi dokumentacion përkatës ku pa statistikat e detajet për vitet e fundit, duke përfshirë dhe atë të vitit akademik 2021-2022.</p> <p><i>[Ev. Aneks Tabelat përmbledhëse _RVB, tabela 21;</i> <i>Ev. 5.11 Lista e studenteve të cregjistruar 2020-2021;</i></p>												





<p>Kriteri 3. Institucioni disponon të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimit që nga pranimi, deri në diplomimin e tyre.</p>	<p>Sekretaria mësimore është përgjegjëse për mbajtjen e të dhënave në lidhje me ecurinë e studentëve. GVJ verifikoi në vizitën e kryer në sekretarinë mësimore regjistrin e arritjeve akademike. Verifikimi u bë me të dhënat e dy studenteve të përzgjedhur në mënyrë rastësore në një procesverbal provimi me notat përkatëse të studentëve të zgjedhur të hedhur në regjistrin e arritjeve akademike. Verifikimet gjejnë një përputhje të notave dhe në tërësi plotësimi i tij është në përputhje me kuadrin ligjor</p> <p><i>Ev. 1.8 Rregullore e UT-së e përditësuar, neni 41-42, fq. 25;</i> <i>Ref. Shënime të vizitës në institucion</i></p>			
<p>Kriteri 4. Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.</p>	<p>Gjatë vizitës në IAL, GVJ verifikoi të dhënat statistikore të studentëve të cilat përgatiten dhe ruhen elektronikisht dhe në dosje fizike nga personat e autorizuar. Gjithashtu, kryesekretarja në bashkëpunim me sekretaren mësimore kryen pasqyrimin e notave në bazën elektronike të dhënave. GVJ verifikoi dokumentacionin e ruajtur elektronikisht si dhe përmes kopjeve të printuara, të cilat disponoheshin nga sekretaria mësimore.</p> <p><i>Ev. 1.8 Rregullore e UT-së e përditësuar, neni 42, fq. 25</i></p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni duhet të hartojë raporte analitike periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve</p>	<p>Institucioni dhe njësia kryesore/bazë hartojnë raportet vjetore të analizës mësimore shkencore të hallkave përkatëse, ku në to gjejnë pasqyrim trajtimet e procesit mësimor, cilësia e hyrjeve dhe daljeve të studentëve si dhe detyrat në të ardhmen.</p> <p>GVJ konstatoi se departamenti vlerëson cilësinë e studentëve të programeve të studimit që ofron si në hyrje dhe në dalje dhe ky informacion përfshihet në raportin vjetor të departamentit.</p> <p><i>[Ev. Aneks Tabelat përmbledhëse _RVB, tabela 21;</i> <i>Ev. 5.11 Lista e studenteve të regjistruar 2020-2021; 5.12 Kalueshmeria dhe nota mesatare 2021-2022;</i> <i>Ev. 2.28 Formulari për përditësimin e të dhënave ALUMNI;</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Niveli i përmbushjes</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>




Standardi V.5

Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programit të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë IAL-ve.</p>	<p>Ligji për Arsimin e Lartë Nr 80/2015 përcakton të drejtën e studentëve për t'u përfaqësuar në një sërë organesh vendimmarrëse dhe me rol konsultativ brenda strukturave të universitetit. Kreu IX i Statutit të UT i dedikohet studentëve, në Nenin 125- Të drejtat e studentëve- përcaktohet që studentët gjatë periudhës së studimeve kanë të drejtë të përfaqësohen në organet e UT, me përjashtim të rastit kur ligji e përcakton ndryshe. Bazuar në Nenin 30 të Statutit të UT, në Senatin Akademik bëjnë pjesë dhe studentët, përfaqësuesit e të cilëve zgjidhen përmes votimit të studentëve. Bazuar po në Statut - Neni 32, nga 35 anëtarë që ka senati akademik 4 prej tyre janë studentë.</p> <p>Gjithashtu, studentët janë pjesë e:</p> <ul style="list-style-type: none">- komisionit të sigurimit të standardeve të cilësisë;- komisionit të mbarëvajtjes së veprimtarive dhe marrëdhënieve me studentët;- komisionit të kurrikulave;- komisionit të etikës;- grupeve të vlerësimit të brendshëm të programeve të studimit dhe grupeve të tjera ad hoc që mund të ngrihen në nivel njësie kryesore apo bazë; <p><i>Ev. 1.1 Statuti neni 40, fq. 27; neni 41, fq. 41; neni 42, fq. 28; neni 43, fq. 28; neni 125 pika 1 dhe 2J;</i></p> <p><i>Ev. 5.13 Rregullore për organizimin e zgjedhjeve për autoritetet drejtuese dhe SA në UT 2020, neni 18, pika 3, fq.14;</i></p> <p><i>Ev. 5.14 Rregullore për zgjedhjet e para të Keshillave të Studenteve;</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me</p>	<p>Nga shqyrtimi i dosjes se aplikimit të institucionit pranë ASCAL-it si dhe nga takimi me studentet në viziten e GVJ në institucion evidentohet roli aktiv i studentëve apo i perfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse. Gjithashtu, një rol të rëndësishëm kanë studentet nepermjet vlerësimit periodik që ata bejnë për nivelin e mesimdhënies gje e cila realizohet si nepermjet anketimit anonim ashtu edhe nepermjet diskutimeve me titullaret e lendeve perkatese të programit.</p>




<p>rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.</p>	<p>[Ev. 6.12 GVB FE Akreditimi Programeve; Ev. Aneks Tabelat përmbledhëse _RVB, tabela 24; Ev. 6.12 GVB FE Akreditimi Programeve; Ev. 6.2.3 Paketa e instrumentave të cilësisë;</p>
<p>Kriteri 3. Në hartimin dhe përmirësimin e programit të studimit, institucioni duhet të mbajë parasysh ngarkesën akademike të studentëve në programin e studimit dhe parashikimin e procedurave joburokratike të përparimit të studentëve përgjatë programit, përfshirë njohjen e studimeve të plota apo të pjesëshme të mëparshme.</p>	<p>Nga shqyrtimi i programit të studimit është mbajtur parasysh ngarkesa akademike e studentëve, duke u bazuar në kriteret e ngarkesës mësimore bazuar në kredite. Kjo u konfirmua edhe në takimin me stafin akademik që mbulon programin, si dhe me studentët. Gjithashtu garantohet baza rregullative dhe procedurale lidhur me njohjen e studimeve të plota apo të pjesëshme të mëparshme.</p> <p>Ev. 2.1 Plani mësimor i programit të studimit; Ev. 5.15 Njoftim për mbrojtje praktike dhe diplome; Ev. 3.6 Struktura Mësimore për Vitin Akademik 2021–2022, Master i Shkencave dhe Master Profesional, Viti i Parë; Ev. 2.15 Njohje e lëndëve nga programet e mobilitetit</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to.</p>	<p>Pjesëmarrja e studentëve në Komisionin e Kurrikulave, në Komisionin e Sigurimit të Standardeve të Cilësisë, në Senat në grupet e vlerësimit të brendshëm të programeve është mundësi e drejtpërdrejtë për të ndikuar në rishikimin e përmirësimin e programit, Msc Ekonomiks përfshirë. Pjesë e rëndësishme e pjesëmarrjes së studentëve në vlerësimin e procesit akademik është dhe zhvillimi i procesit të vlerësimit të lëndës, që krijon mundësi e analizave të mëtejshme në terma të përmbajtjes së lëndës, por dhe mënyrës së zhvillimit të saj nga pedagogu, si dhe në drejtim të përmirësimit të vazhdueshëm të kurrikulës.</p> <p>Ev. 6.2.3 Paketa e instrumentave të cilësisë</p>
<p>Kriteri 5. Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit e kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e</p>	<p>Bazuar në Rregulloren e UT, në Rregulloren e Programit të Studimit studentët gëzojnë të drejtën e ankimimit të rezultatit pasi kanë dalë vlerësimi. Nga takimi me studentet nuk u evidentua ndonjë reklamim i tyre lidhur me vlerësimin e dijeve nga pedagogët, por ata shprehën opinion pozitiv për vlerësimet e dijeve të tyre.</p> <p>Ev. 1.8 Rregullore e UT-së e përditësuar, nenet 50-51, fq. 28-29; neni 54, fq. 30-31;</p>





institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës				
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.6	
Personeli akademik i angazhuar në programin e studimit merr pjesë në aktivitetet kërkimore e shkencore dhe motivon pjesëmarrjen e studentëve dhe përfshirjen e tyre në studime e projekte.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Personeli akademik merr pjesë në konferenca ose aktivitete ndërkombëtare në fushën e kërkimit shkencor.	<p>Gjatë takimit me stafin drejtues dhe atë akademik, GVJ u informua në lidhje pjesëmarrjen e stafit akademik në projekte kombëtare e ndërkombëtare, ku renditen rreth 29 pjesëmarrje në projekte ndërkombëtare, 20 artikuj të botuar në revistat e huaja shkencore, 40 referime mbajtur në konferenca jashtë vendit. Gjithashu pedagogët e FEUT janë mjaft aktivë në mobilitetet në kuadër të programit Erasmus+, ku një numër i konsiderueshëm e Departamentit të Ekonomiksit janë bërë pjesë e mobiliteteve në mësimdhënie e trajnime, në universitet e huaja gjatë viteve 2019-2022. GVJ konfirmoi që personeli akademik është mjaft aktiv në pjesëmarrje në konferenca ose aktivitete ndërkombëtare në fushën e kërkimit shkencor.</p> <p><i>Ev. 2.22 Puna shkencore 2018-2022;</i> <i>Ev. 4.5 Mobilitetet e stafit akademik (2018-2022);</i></p>
Kriteri 2. Institucioni lidh marrëveshje partneriteti me institucionet e huaja të arsimit të lartë, institute, me qëllim realizimin e studimeve, projekteve dhe kërkimeve të përbashkëta.	<p>Bazuar në DVV, Universiteti i Tiranës ka 16 projekte në zbatim dhe 35 projekte të përfunduara, ku UT mban rolin e partnerit ose drejtuesit në këto projekte. U konstatua se UT si dhe njësia kryesore/baze kanë qenë aktive në lidhjen e marrëveshjeve me institucione homologe të huaja duke rritur nivelin e ndërkombëtarizimit të veprimtarisë kërkimore shkencore në nivel institucional apo dhe të FE të UT.</p> <p>GVJ mbështetur në dokumentacion dhe vizitën në IAL konkludoi që FEUT dhe personeli akademik i Departamenti të Ekonomiksit është aktiv në përfshirjen në zbatimin e projekteve lokale dhe</p>



	<p>ndërkombëtare të financuara nga AKKSHI, GIZ, Erasmus+, Horizon 2020, etj.</p> <p><i>Ev. 2.20 Projektet FE _Përfshirja e stafit të Dep.Ekonomiksit;</i></p>
<p>Kriteri 3. Personeli akademik motivon studentët të hartojnë, shkruajnë dhe publikojnë studime e punime shkencore.</p>	<p>GVJ u informua në lidhje me financimin e katër projekte kërkimore me buxhetit e UT, ku ishin përfshirë dhe studentë e ciklit të tretë. Mbështetur në DVV dhe vizitën në institucion, GVJ konstatoi se personeli akademik inkurajon dhe motivon gjithashtu studentët e ciklit të dytë, për t'u bërë pjesë e grupeve kërkimore për të mbledhur dhe analizuar të dhëna në projekte që zbatohen nga departamenti.</p> <p><i>[Ev. 2.22 Puna shkencore 2018-2022, aneks 4; Ref. Shënime të vizitës në institucion]</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni mbështet publikimin në revista shkencore ndërkombëtare të punimeve kërkimore shkencore të personelit akademik të institucionit dhe studentëve.</p>	<p>Gjatë takimit me stafin drejtues dhe atë akademik, GVJ u informua në lidhje me miratimin e grantit për prezantimin e një punimi/kërkimi në konferenca ndërkombëtare, i cili mund të përfitohet vetëm nga personeli akademik me kohë të plotë, një herë në dy vjet. Këto pune kërkimore mund të jenë dhe në bashkëautorësinë me studentët. GVJ konstatoi që IAL përdor instrumentat e duhur për të mbështetur stafin akademik në publikimin e punimeve kërkimore shkencore në revista ndërkombëtare.</p> <p><i>[Ev. 1.11 Programi i grantit për prezantimin e punimeve në konferenca; Ref. Shënime të vizitës në institucion]</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni dhe personeli akademik motivojnë dhe mbështetin studentët të angazhohen në studime inovative dhe patentave.</p>	<p>Referuar RVB-së, personeli akademik inkurajon në vazhdimësi studentët për t'u përfshirë në projektet e tyre studimore dhe/ose për të publikuar pjesë të punimeve të diplomës në konferenca apo revista shkencore. Motivimi dhe mbështetja e studenteve realizohet edhe nepermjet marrëveshjeve në kuader të programeve ERASMUS + ashtu edhe në marrëveshjet institucionale që FE i UT dhe Departamenti ka me institucione të ndryshme.</p>
<p>Kriteri 6. Personeli akademik ofron asistencën e nevojshme për kryerjen e analizave, matjeve studimeve dhe përpunimit të rezultateve në kuadër të realizimit të diplomës</p>	<p>U evidentua nga takimi me studentët e programit se asistenca kryesore e stafit akademik në këtë drejtim realizohet gjatë përgatitjeve të detyrave të kursit apo punimeve të diplomës së studentëve, duke shfrytëzuar infrastrukturën që ofron institucioni.</p> <p><i>2.4 Lista e drejtuesve të mikrotezave/praktikave;</i></p>





Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X


Standardi V.7

Mbështetja e institucionit të arsimit të lartë siguron vazhdimësi në studime të thelluara dhe kërkim shkencor.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni ndjek një politikë bashkëpunimi me organizmat shkencorë, kombëtarë, me qëllim rritjen e aktiviteteve dhe mobilitetit të stafit dhe studentëve të programit të studimit.</p>	<p>Referuar DVV UT ka Planin strategjik të kërkimit shkencor për periudhën 2018-2022, të formuluar me të gjithë elementët nga qëllimet deri tek financimi. UT ka nënshkruar 46 marrëveshje dypalëshe me afat 3-10 vjet. Këto marrëveshje konsistojnë në bashkëpunimin për të aplikuar për projekte të përbashkëta kërkimore, zhvillimin e kurrikulës mësimore, shkëmbim materialesh akademike, lehtësimin e procedurave për transferimin e studentëve, bashkëpunim për realizimin e aktiviteteve të përbashkëta, etj.</p> <p><i>[Ev. 1.5 Plani i Kërkimit Shkencor të Universitetit të Tiranës (2018-2022), fq. 14; Ev. 5.16 Marrëveshje të UT; Ev. 2.22 Puna shkencore 2018-2022]</i></p>
<p>Kriteri 2. Implementimi i metodave të kërkimit nga personeli akademik dhe studentët siguron vijueshmëri dhe përgatitje të studentëve për ciklin e tretë të studimeve.</p>	<p>Modulet e lëndëve të caktuara të cilat realizohen nga studentët përgjatë ndjekjes së këtij program studimi kanë një impakt të dukshëm në zhvillimin e kompetencave për të kryer kërkime shkencore dhe për të ndihmuar në implementimin e projekteve të ndyshme. Kjo përvojë profesionale shënon një moment të rëndësishëm të rritjes së kompetencave personale në drejtim të përdorimit të metodave të kërkimit nga studentët që u siguron vijueshmëri dhe përgatitje për ciklin e tretë të studimeve.</p> <p><i>Ev. 2.1 Plani mësimor i programit të studimit; Ev. 2.6 Programet e lëndëve (syllabuset);</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni ndjek një politikë të përfshirjes së studiuesve të rinj në projekte kërkimore vendës dhe të huaj.</p>	<p>GVJ konstaton se kjo qasje ka bërë që lidhja e personelit akademik me përvojë me studiuesit e rinj të jetë efikase, duke krijuar bashkëpunime konkrete dhe cilësore. Gjate 3 viteve të fundit në kuader të njësisë kryesore janë realizuar 6 aplikime për projekte nga të cilat 5 kanë qene të sukseseshme dhe janë në fazen e</p>



	<p>zbatimit. Mbështetja e të rinjve është gjithashtu edhe pjesë e “Plani i Kërkimit Shkencor të Universitetit të Tiranës”.</p> <p><i>Ev. 1.5 Plani i Kërkimit Shkencor të Universitetit të Tiranës (2018-2022), fq. 15-16; Ev. 2.22 Puna shkencore 2018-2022;</i></p> <p><i>Ev. 4.4.1 Trajnimi Stafit Hollandë</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucion ndjek një politikë integruese për kërkuesit shkencorë të huaj.</p>	<p>GVJ konstatoi se institucioni ndjek një politika integruese për kërkuesit shkencorë të huaj. Kjo konfirmohet dhe nga numri i projekteve që po zbaton UT dhe mobilitetet e kërkuesve të huaj të cilat dëshmojnë që partneritetet mundësojnë më shumë hapësira për kërkuesit shkencorë të huaj. Në periudhën 2018-2022 Njësia bazë ka pritur 6 kërkues të huaj.</p> <p><i>[Ev. 1.5 Plani i Kërkimit Shkencor të Universitetit të Tiranës (2018-2022), fq. 15-16; Ev. 2.16 Mobilitete të personelit akademik të huaj _pedagogu pritës]</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni ndjek një politikë favorizuese për mobilitetin e studentëve që angazhohen në veprimtari e aktivitete ndërkombëtare.</p>	<p>Institucioni promovon dhe nxit aplikimet e studenteve për mobilitetet në kuader të projekteve që janë në zbatim duke informuar si nepermjet shpalljeve të aplikimeve në linkun perkates të marreveshjeve në kuader të ERASMUS + ashtu edhe nepermjet thirrjeve në web-in e institucionit. Nga ana tjetër, njesia kryesore/baze e programit informon studentet për aplikime të ketyre mobiliteteve. Në faqen e UT-së dhe Njësive kryesore publikohen njoftimet dhe procedurat që duhet të ndiqen për t’u bërë pjesë e këtij program. Informacioni është lehtësisht i aksesueshëm nga ana e studentëve. Gjatë takimeve me studentet dhe stafin akademik, GVJ konstatoi se departamenti ndiqte politika mbështetëse në lidhje me mobilitetin e studentëve në universitetet partnere.</p> <p><i>Ev. 2.14 Lista e studentëve që kanë bërë mobilitete;</i></p>
<p>Kriteri 6. Institucioni, për të rritur profilin ndërkombëtar, fton për veprimtari kërkimore dhe mësimdhënie, personel akademik dhe studentë të huaj, për periudha të ndryshme kohore</p>	<p>Referuar RVB dhe takimit me stafin akademik, FEUT ka lidhur një sërë marrëveshjesh bashkëpunimi në kuadër të programeve të ndryshme ndërkombëtare si Erasmus+, Horizon 2020, Fullbright etj, që bëjnë të mundur afrimin e pedagogëve të huaj për mësimdhënie, trajnime, leksione të hapura apo pjesëmarrje në konferenca të organizuara nga FEUT. GVJ konstatoi se FEUT ka realizuar disa leksione të hapura me profesor të huaj dhe përfaqësues të institucioneve financiare ndërkombëtare.</p> <p><i>[Ev. 3.14.1 Leksione të hapura 2; Ref. Shënime të vizitës në institucion]</i></p>





Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.8

Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimeve e problematikave, të cilat operojnë në mënyrë permanente e janë lehtësisht të arritshme e të përdorshme nga studentët.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të IAL-ve.</p>	<p>Në përputhje me Statutin e UT, në njësinë kryesore dhe atë bazë funksionojnë një sërë zyrash të cilat mbështesin studentët në plotësimin e një tërësie procesesh dhe aktiviteteve të domosdoshme për procesimin gjatë studimeve master si:</p> <p>Zyra e Informimit të Studentëve; Sekretaria Mësimore; Zyra e Financës; Zyra IT; Koordinatori i programit;</p> <p>Gjithashut edhe guida e studentit të FE të UT ofron informacion të dobishëm për studentet.</p> <p><i>Ev. 1.6 Rregullore e Administrates së Rektoratit, neni 14, fq. 5-6</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.</p>	<p>Referuar dokumentacionit të dorëzuar GVJ kostatoi se IAL ka një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen, asistimin e studentëve për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit. Fakulteti dhe Departamenti kanë arritur të ngren një sistem të tere informimi dhe dinamik.</p> <p>Në shërbim të këtij sistemi informimi është edhe përdorimi i platformave, rrjeteve sociale dhe deri sistemi i ekraneve të instaluar për informim në ambientet e perbashketa të dy godinave të FE të UT.</p> <p><i>Ev. 3.1 Guida _metoda interaktive mësimdhënie_FEUT</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës.</p>	<p>Zyra e Këshillimit të Karrierës informon studentët vazhdimisht mbi mundësitë për praktika mësimore, vende të lira pune, etj. Zyra e Karrierës është e alokuar në hollin hyrës, duke i dhënë</p>





<p>Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.</p>	<p>mundësinë studentëve të aksesojnë dhe ndërveprojmë me specialisten e saj. Në takimin në institucion me stafin e angazhuar në program, evidentuam që pedagogët e departamentit për shkak të reputacionit të tyre janë këshilluesit më profesionistë të karrierës së studentëve të tyre dhe kjo përbën një vlerë të shtuar për institucionin dhe studentët, në atë çka ata mund të përfitojnë gjatë viteve të studimit.</p> <p><i>Ev. 5.7 Panairi punës 2022;</i></p> <p><i>Ev. 6.9 Rregullore mbi themelimin dhe organizimin e zyrës së karrierës (draft);</i></p>
---	--

<p>Kriteri 4. Zyra/njësi e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse</p>	<p>GVJ mbështetur në dokumentacion dhe vizitën në IAL konkludoi që zyra e karrierës në FEUT ka politika dhe procedura të miratuara të ndjekjes së studentëve dhe pas diplomimin. Konkretisht, zyra e Këshillimit të Karrierës ka vënë në dispozicion një specialist i cili në bashkëpunim dhe me departamentin përketes ndjek studentët e diplomuar. Listat e të diplomuarve përditesohen dhe përdoren si kontakte të rëndësishme në organizimin e aktiviteteve të ndryshme. Një urë tjetër lidhëse e të diplomuarve me institucionin janë dhe eventet e përbashkëta në kuadër të alumni si dhe leksionet e hapura në orientimin e karrierës.</p> <p><i>[Ev. 2.28 Formulari për përditësimin e të dhënave ALUMNI; Ev. 6.9 Rregullore mbi themelimin dhe organizimin e zyrës së karrierës (draft); Ref. Shënime të vizitës në institucion]</i></p>
---	---


<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<p>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>





VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMEVE TË STUDIMIT MASTER I SHKENCAVE/ARTEVE

Standardi VI.1	
Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.</p>	<p>Bazuar tek dokumentacioni i vënë në dispozicion si dhe nga takimet me përfaqësues të Drejtorisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Drejtorisë së Kurrikulave, GVJ konstaton se institucioni ka hartuar politika dhe struktura të posaçme për sigurimin e brendshëm të cilësisë në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale</p> <p><i>Evidenca 1.12, Strategjia e UT, fq.4;</i></p> <p><i>Evidenca 6.1 Plani i Veprimit për SBC;</i></p> <p><i>Ev. 6.2 Vendim Senati nr.51, datë 23.12.2020 Për miratimin e paketës së dokumentave për sigurimin e cilësisë në UT;</i></p> <p><i>Ev. 6.2.1 Manuali për Sigurimin e Cilësisë;</i></p> <p><i>Ev. 6.2.2 Rregullore për Sigurimin e Cilësisë;</i></p> <p><i>Ev. 6.2.3 Paketa e Instrumentave;</i></p> <p><i>Ev. 1.1 Statuti i UT, neni 31, pika b, fq.19; neni 41, fq.27;</i></p> <p><i>Ev. 1.6 Rregullore e Administratës së Rektoratit, fq.;</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur dhe funksional Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentë dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.</p>	<p>Bazuar ne Statutin e UT janë ngritur strukturat e sigurimit të brendshëm të cilësisë në nivel universiteti dhe fakulteti. Konkretisht janë në funksion:</p> <ol style="list-style-type: none"> a. Drejtoria e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (nivel universiteti) b. Komisioni i Përhershëm për Sigurimin e Standardeve të Cilësisë (KPSSC) (nivel universiteti) c. Sektori i Njësisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (nivel universiteti) d. Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (nivel fakulteti) <p>Institucioni ka miratuar edhe Rregulloren për Sigurimin e Cilësisë në UT dhe Manualin e Sigurimit të Cilësisë. Veprimtaria e tij</p>




	<p>mbështetet mbi hapa konkrete përmes një plan veprimi afatgjatë (2021-2024).</p> <p><i>Ev. 1.1 Statuti i UT, neni 31, pika b; neni 41;</i></p> <p><i>Ev. 1.6 Rregullore e Administratës së Rektoratit, neni 11, fq.5;</i></p> <p><i>Ev. 6.3 Vendimi 43, SA për Komisionet;</i></p> <p><i>Ev. Aneks RVB, tabela 24;</i></p> <p><i>Ev. 6.4 Vendimi i Dekanatit për krijimin e NJSBC;</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i Jashtëm i Cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë.</p>	<p>UT i është nënshtruar akreditimit të jashtëm periodik. Me vendim të Bordit të Akreditimit nr. 84 datë 27.10.2018 ka marrë një vlerësim pozitiv për cilësinë akademike me afat 4 vjeçar (26.10.2022). Në këtë moment, është në zbatim instrumenti tjetër i sigurimit të cilësisë, akreditimi i programit të studimit, ku është kryer vlerësimi i brendshëm, dhe është në proces vlerësimi i jashtëm.</p> <p><i>Ev. 6. 13 Sondazhi kombëtar i studentëve, takim informues;</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni ka hartuar një politikë të qartë dhe ndjek procedura periodike për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së programit të studimit që ofron, në kuadër të SBC-së. Ato synojnë krijimin e kulturës së cilësisë në rang institucional, të njëjve përbërëse dhe të gjithë aktorëve të brendshëm të institucionit</p>	<p>Bazuar në evidencat përkatëse dhe nga vëzhgimi gjatë vizitës në institucion, Universiteti i Tiranës ka hartuar një politikë të qartë dhe ndjek procedura periodike në kuadër të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, me qëllim përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së programeve të studimeve që ofron. Në dokumentet zyrtare siç është Statuti i UT-së parashikohen qartë procedurat e posaçme për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së programeve që ofrohen.</p> <p>Në rregulloren e sigurimit të cilësisë janë përcaktuar procedurat, afatet, instrumentet dhe burimet për sigurimin e brendshëm të cilësisë. Njëkohësisht, në ndihmë të këtij procesi përveç pyetësorëve periodikë, Departamenti i Ekonomiksit harton në mënyrë të përvitshme analizat vjetore të punës së tij dhe harton dhe planin e masave për përmirësime të mundshme.</p> <p><i>Ev. 6.2.1 Manuali për sigurimin e cilësisë;</i></p> <p><i>Ev. 6.1 Plani i Veprimit për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë 2021-2024;</i></p> <p><i>Ev. 6.5 Raporti vjetor i Departamentit viti akademik 2021-2022;</i></p> <p><i>Ev. 6.6 Raporti vjetor i UT-së;</i></p>





	Ev. 6.7 FEUT-Rregullore për sigurimin e cilësisë; Ev. 6.8 Miratimi i planit NJSBC 2021-2022; Ref. Shënime nga vizita në institucion			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.2	
Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ngrre njësi të posaçme për monitorimin, shqyrtimin, mbikëqyrjen, rishikimin e programit të studimit të ciklit të dytë.	<p>Për monitorimin, shqyrtimin, mbikëqyrjen dhe rishikimin e programeve të studimit, rezulton që UT ka të ngritura njësi të posaçme kryesore: Komisioni i Përhershëm për Sigurimin e Standardeve të Cilësisë (KPSSC) dhe Komisioni Përhershëm i Kurrikulës etj.</p> <p>Njëkohësisht, në nivel njësie kryesore, është ngritur dhe funksionon realisht Dega e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë. Në këtë kuadër, dhe në mbështetje edhe të njësive të mësipërme, koordinimi i Përgjegjësit të Departamentit me zv. Dekanin që mbulon kërkimin shkencor, ndihmon në realizimin e analizave të punës mësimore-kërkimore dhe hartimin e raporteve përkatëse, të cilat më pas integrohen në raportimet vjetore si FE. GVJ konstatoi se detyrat dhe përgjegjësitë e këtyre strukturave mbështeten në rregulloret përkatëse dhe veprimtaria e tyre monitorohet nga organet kolegjiale.</p> <p><i>Ev. 1.1 Statuti, neni 41-42,</i> <i>Ev. 1.6 Rregullore e Administrates së Rektoratit, neni 11, fq.45-54;</i> <i>Ev. 1.7 Organigrama FEUT;</i> <i>Ev.6.4 Vendim Dekanati për Krijimin e NJSBC-së;</i> <i>Ev.6.7 FEUT-Rregullore per sigurimin e cilësisë;</i> <i>Ev. Aneks Tabelat përmbledhëse _RVB, tabela 24;</i></p>
Kriteri 2. Institucioni përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara për	Institucioni përdor mekanizma dhe procese të cilat zhvillohen mbi bazën e nje kuadri ligjor të përcaktuar qartë në dokumentat bazë. Departamenti i Ekonomiksit shqyrton veprimtarinë mësimore dhe harton raportet vjetore duke pasqyruar problematikat dhe hapat



shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programit të studimit të ciklit të dytë.	konkrete në drejtim të përmirësimit. GVJ konstaton se ndiqen dhe zbatohen me korrektësi të gjithë udhëzimet dhe standartet e përcaktuara nga MAS. <i>Ev. 6.2.3 Paketa e instrumentave të cilësisë, fq. 2-5; fq.20-21;</i> <i>Ev. 6.2.3 Paketa e instrumentave të cilësisë, fq. 2-5; fq.20-21; fq.7-8; Ev. 6.9 Vlerësim i studentëve që diplomohen_raporti;</i> <i>Ref. Shënime nga vizita në institucion</i>
Kriteri 3. Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë dhe mbarëvajtjen e programit të studimit.	Mbështetur në DVV dhe vizitës në institucion, GVJ konstatoi se në nivel institucional u shpërndanë dy pyetësorë: pyetësor për studentët mbi studimin e tregut të punës dhe një pyetësor me qëllim vlerësimin e mësimdhënies dhe aspekte të tjera në funksion të saj nga studentët. Gjithashtu, instrumentat e përdorur nga paketa e instrumentave janë: (1) "Vlerësimi i lëndës nga studentët"; (2) "Vlerësimi i studentëve që diplomohen"; (3) "Raport i vetëvlerësimit të lëndës nga pedagogu"; (4) "Formular i vlerësimit nga personeli akademik". <i>Ev. 6.2.3 Paketa e instrumentave të cilësisë;</i> <i>Ref. https://feut.edu.al/lajmerime/1617-pyetesor-per-studentet-mbi-punesimin;</i> <i>Ref. https://unitir.edu.al/njoftim-per-studentet-e-universitetit-te-tiranes-2/</i>
Kriteri 4. Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.	Rezultatet e pyetësorëve nga studentët përpunohen në formë statistikore dhe konform Manualit të Cilësisë dhe Rregullores së Sigurimit të Cilësisë. Të dhënat i percillen Departamentit për informim dhe përmirësim. Rezultatet reflektohen edhe në raportet vjetore që hartohen në nivel departamenti dhe njësi kryesore dhe vijon më pas me përcjelljen e tyre Ministrinë e Arsimit dhe Sporteve.
Kriteri 5. Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë	Nga shqyrtimi i dokumentacionit GVJ konstatoi që në raportet e vlerësimit përfshihen rezultatet e pritshme të vlerësimit dhe rezultatet e arritura. Ndërsa për të adresuar mangësitë Njësitë kryesore/Njësitë bazë hartojnë plane veprimi të veçanta ku pasqyrohen rekomandimet, masat që duhen të merren dhe progresi që është bërë. Hartimi i raporteve për këtë program studimi është në proces, pasi ky është akreditimi i parë. Kjo u konfirmua dhe nga takimi me zyrën përgjegjëse.




Shkalla e përbushjes së standardit	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X


Standardi VI.3

Institucioni i arsimit të lartë përdor procedura e metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për hapjen, zhvillimin dhe ecurinë e programit të studimit, diplomimin dhe daljen në tregun e punës apo studimeve të mëtejshme të studentëve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Vlerësimi i brendshëm i programit të studimit kryhet në mënyrë periodike nga njësia e brendshme e cilësisë që lidhet me këtë program studimi. Institucioni i arsimit të lartë e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin institucional në kuadër të akreditimit apo vetëvlerësimeve të brendshme periodike.</p>	<p>Drejtorja e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë kryen në mënyrë periodike vlerësimin e programit të studimit. Sektori i sigurimit të brendshëm të cilësisë në bashkëpunim me NJSBC në FE, ndërmerr në fund të çdo semestri anketime për programin mësimor. Të dhënat e mbledhura shërbejnë për hartimin e raporteve të vetvlerësimit të brendshëm në proces akreditimi. GVJ zhvilloi një takim me anetarët e GVB dhe konstaton se hartimi i raportit është realizuar përmes hulumtimit dhe bashkëpunimit me të gjitha strukturat në tre nivelet</p> <p><i>Ev. 6.5.1 Raporti vjetor i Departamentit viti akademik 2019-2020;</i> <i>Ev. 6.11 Raporti FEUT 2019-2020;</i> <i>Ev. 6.6 Raporti vjetor i UT-së 2019-2020;</i></p>
<p>Kriteri 2. Për kryerjen e vlerësimit, institucioni përdor metoda e instrumente të ndryshme, të posaçme e të përshtatshme në përputhje me natyrën dhe specifikën e fushës akademike të programit të studimit.</p>	<p>Për kryerjen e vlerësimit Institucioni zhvillon metoda dhe forma të cilat variojnë në funksion të qëllimit dhe objektivave që ka çdo strukturë e ngritur. Cilësia e mësimdhënies monitorohet dhe vlerësohet nga Departamenti i Ekonomiksit përmes diskutimeve në mbledhje dhe në analizën periodike që ndërmerr. GVJ mbështetur në dokumentacion dhe vizitën në IAL konstatoi që instrumentat e përdorur i përshtaten fushës akademike të programit të studimit dhe përdoren periodikisht nga IAL.</p> <p><i>Ev. 6.2.2 Rregullore për sigurimin e cilësisë, neni 31, fq. 17-18;</i> <i>Ev. 6.2.3 Paketa e instrumentave të cilësisë;</i> <i>Ref. Shënime nga vizita në institucion</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda të</p>	<p>GVJ konstaton zbatimin e metodave të drejtpërdrejta në drejtim të vlerësimit të cilësisë së programit të studimit.</p> <p>Konkretisht përmendim:</p>





<p>drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstytucionale apo kombëtare si provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.</p>	<ul style="list-style-type: none"> - Vlerësimi i rezultateve të mësimdhënies (kalueshmëria dhe nota mesatare për çdo lëndë dhe grup mësimor); - Vëzhgime në auditor gjatë realizimit të provimeve; - Monitorime periodike të zhvillimit të procesit mësimor në auditor; - Nota mesatare në hyrje dhe dalje; - Vlerësimi i përdorimit të infrastrukturës në funksion të procesit mësimor. - Monitorimi i punësimit të studentëve të diplomuar, etj. <p><i>Ev. 6.5.1 Raporti vjetor i Departamentit viti akademik 2019-2020;</i> <i>Ref. Shënime nga vizita në institucion</i></p>			
<p>Kriteri 4. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuara (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përftuara nga ky program</p>	<p>Duke u bazuar tek DVV, “Paketa e instrumentave të cilësisë” përmban 10 instrumenta dhe disa nga instrumentat që kanë filluar të përdoren nga Njësitë bazë të mbështetura nga NJSBC janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Vlerësimi për pedagogun; - Vlerësimi i lëndës nga studentët; - Vlerësimi i studentëve që diplomohen; - Vlerësimi nga personeli akademik që vlerëson nivelin e kënaqësisë së personelit akademik për të ndihmuar në përmirësimin e tyre profesional; <p>GVJ mbështetur në dokumentacion dhe takimet në institucion konstatoi që instrumentat e tërthorta përdoren në mënyrë periodike dhe i shërbejnë përmirësimit të cilësisë të programit të studimit.</p> <p><i>Ev. 6.2.3 Paketa e instrumentave të cilësisë;</i> <i>Ref. Vizitës në institucion</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				X




Standardi VI.4

Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, stafin e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni duhet të parashikojë dhe garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>Mbështetur në gjithë dokumentet zyrtare të tij, UT parashikon dhe garanton në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit. Një nga aktorët e rëndësishëm të brendshëm janë studentët, të cilëve ju garantohej edhe pjesëmarrja aktive në organet vendimmarrëse në të gjitha nivelet, por edhe në struktura si Komisioni i përhershëm për sigurimin e standardeve të cilësisë, Komisioni i përhershëm i kurrikulës apo angazhohen edhe në Grupet e vlerësimit të brendshëm për vlerësime institucionale dhe të programit të studimit. Në dokumentet zyrtare si Statuti dhe rregullore të tjera institucionale, UT ka të sanksionuar një politikë dhe procedurë të brendshme të përcaktuar qartë në funksion të përmirësimin të cilësisë së programeve të studimit.</p> <p><i>Ev. 6.2.2 Rregullore për sigurimin e cilësisë, kreu III, nenet 13-27, fq. 9-16;</i></p> <p><i>Ev. 1.1 Statuti, neni 13, fq. 18; neni 41, fq. 27; neni 141, fq.74;</i></p> <p><i>Ev. 6.12 GVB FE Akreditimi Programeve;</i></p> <p><i>Ev. 6.2.3 Paketa e instrumentave të cilësisë, fq. 18-19;</i></p> <p><i>Ref. Shënime nga vizita në institucion</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.</p>	<p>Referuar DVV dhe vizitës në institucion, GVJ konfirmon që FEUT ka struktura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë, të cilat kanë detyra të përcaktuara qartë në statut dhe aktet e tjera rregullatore të IAL. Në statutin e UT dhe manualin për sigurimin e brendshëm të cilësisë specifikohen qartë organizimi dhe përbërja e KSBC-së, funksionet kryesore të saj. GVJ konstatoi që detyrat dhe përgjegjësitë e përcaktuara garantojnë ushtrimin me përgjegjësi të sigurimit të cilësisë.</p> <p><i>Ev. 6.2.2 Rregullore për sigurimin e cilësisë, kreu III, nenet 13-27, fq. 9-16;</i></p> <p><i>Ev. 1.1 Statuti, neni 13, fq. 18; neni 41, fq. 27; neni 141, fq.74;</i></p> <p><i>Ref. Shënime nga vizita në institucion</i></p>



<p>Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarët e personelit akademik, ndihmës akademik e administrativ dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>GVJ konstaton në bazë të dokumentave të shqyrtuara se, në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit Msc në “Ekonomiks” janë përfshirë staf akademik, ndihmës akademik, administrativ dhe student</p> <p><i>Ev. Aneks Tabelat përmbledhëse _RVB, tabela 24;</i> <i>Ev. 6.7 FEUT-Rregullore për sigurimin e cilësisë;</i> <i>Ev. 6.8 Miratimi i planit NJSBC 2021-2022;</i> <i>Ref. Shënime nga vizita në institucion</i></p>			
<p>Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.</p>	<p>Në respekt të Ligjit Nr.9887 datë 10.03.2008, ndryshuar me ligjin Nr. 48/2012 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, gjatë procedurave që kryhen nga strukturat përkatëse të sigurimit të cilësisë për vlerësimin e programit të studimit, respektohet integriteti akademik, etika dhe liria akademike. Të gjithë pyetësorët që kryhen me studentët në mënyrë periodike janë të tilla që ruajnë anonimatit dhe konfidencialitetin e tyre.</p>			
<p>Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj</p>	<p>Nga evidentimi i bërë, rezulton që në aspektin e aktivizimit si pjesë e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë të aktorëve të jashtëm, kryhet Panairi i Karrierës të organizuara nga UT/FE ku marrin pjesë subjekte publike dhe private. Njësia bazë dhe kryesore marrin vlerësime që lidhen me njohuritë, afësitë komunikuese dhe ndërpersonale, aftësitë në punë dhe komente se si mund të orientohen më mirë dijet që marrin studentët me veprimtaritë praktike dhe rekomandime për përmirësimin e programeve të studimit. GVJ mbështetur në evidenca konkludon që këta ekspertë mund të kontribuojnë në përmirësimin e cilësisë së programit të studimit.</p> <p><i>Ev. 6.2.3 Paketa e instrumentave të cilësisë, fq. 12-13; fq. 18-19;</i> <i>Ref. Shënime nga vizita në institucion</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuq përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>



Standardi VI.5

Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.</p>	<p>Vlerësojmë se politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit nga UT/FE janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit. UT ka krijuar programin e transparencës e cila është publike ne faqen web të tij. Në faqet web të FE dhe UT bëhen publike Analiza e Pyetësorëve, Statuti, Rregullorja, Vendime të Senatit Akademik, Vendime të Bordit të Administrimit, aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë. Edhe njësia bazë, në faqen e vet bën publike dokumentacionet bazë që lidhen me këtë program studimi.</p> <p><i>Ref. Shënime nga vizita në institucion;</i></p> <p><i>Ev. 6.2.2 Rregullore për sigurimin e cilësisë, neni 5, pika 6, fq.12; neni 32, pika 4</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.</p>	<p>GVJ konstatoi që UT ka publikuar në faqen zyrtare raportet e vetvlerësimit dhe raportet e ekspertëve të jashtëm pas përfundimit të procesit të akreditimit institucional dhe të programeve të studimit. Gjithë aktorët e interesuar dhe publiku mund të njihen me këto raporte përmes faqes zyrtare të institucionit.</p> <p><i>[Ref. https://unitir.edu.al/akreditimi-i-programve-te-studimit-te-ut-se/]</i></p>
<p>Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.</p>	<p>Rezulton që rezultatet e vlerësimit shoqërohen me plan masash konkrete për përmirësimin e mangësive dhe dobësive që janë evidentuar nga procesi i anketimeve me studentët dhe vetvlerësimi i personelit akademik.</p> <p><i>Ref. Shënime nga vizita në institucion</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe impaktin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë, në</p>	<p>GVJ konstaton perpjekje nga ana e UT-se në lidhje me efektivitetin e procesit të vlerësimit të brendshëm të cilësisë në programin e studimit. Angazhimi i të gjithë hallkave në këtë</p>

përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.	<p>proces është shprehje e qartë e vëmendjes që ky institucion i jep këtij procesi.</p> <p><i>Ev. 6.5.1 Raporti vjetor i Departamentit viti akademik 2019-2020;</i></p> <p><i>Ev. 6.5.2 Raporti vjetor i Departamentit viti akademik 2018-2020;</i></p> <p><i>Ev. 6.11 Raporti FEUT 2019-2020;</i></p> <p><i>Ev. 6.11.1 Raporti FEUT 2020-2021;</i></p> <p><i>Ev. 6.6 Raporti vjetor i UT-së 2019-2020</i></p>
---	--

Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin e afatgjatë të cilësisë së programit të studimit	<p>Gjatë takimit me grupin e sigurimit të cilësisë, GVJ u informua se NJSBC ka organizuar takime informuese me personelin akademik dhe përfaqësues të studentëve në organet kolegjiale, me qëllim ndërgjegjësimin e tyre mbi rëndësinë e pjesëmarrjes në procesin e vlerësimit të brendshëm të programeve të studimit dhe riakreditimin periodik institucional. GVJ konstatoi që NJSBC ka hartuar një plan veprimi për periudhën 2021-2022, mbi të cilin ka informuar Njësitë bazë dhe GVB-të.</p> <p><i>[Ev. 6.8 Miratimi i planit NJSBC; Ref. Shënime nga vizita në institucion]</i></p>
---	--

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të dytë Master i Shkencave në "Ekonomiks"

a. Pikat e forta dhe afirmime:



1. Në vitin 2021, institucioni ka krijuar Qendrën Virtuale të Trajnimit dhe Zhvillimit Profesional e cila ka shërbyer si njësi përgjegjëse për trajnimin e personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe implementimit të metodave të reja. Aktivizimi i një qendre të tillë konsiderohet një nismë e suksesshme e cila do jetë në mbështetje të vazhdueshme për stafin e ri dhe atë me eksperiencë për të ndarë praktikatat më të fundit të mësimdhënies;
2. Organizimi i leksioneve të hapura dhe përfshirja e të ftuarve nga bota e bizneseve dhe më gjerë, të cilët ofrojnë ekperiencë të ndryshme të vlefshme për tregun e punës dhe për forcimin e edukimit sipërmarrës, janë një pikë tjetër e fortë e këtij programi studimi;
3. Personeli akademik i Departamenti të Ekonomiksit është aktiv në përfshirjen në zbatimin e projekteve lokale dhe ndërkombëtare të financuara nga AKKSHI, GIZ, Erasmus+, Horizon 2020, etj, e cila qëndron si një pikë e fortë e këtij departamenti;
4. Institucioni ka marrëveshje bashkëpunimi konkrete për realizimin e praktikës profesionale, të cilat renditen ndër institucionet publike dhe private më prestigjioze në nivel kombëtar;
5. Mësimdhënia në programin e studimit mbulohet plotësisht nga stafi me kohë të plotë i Departamentit të Ekonomiksit. Institucioni ka siguruar të ketë një staf të kualifikuar dhe të qëndrueshëm, ku nga 38 pedagogë efektivë 5 mbajnë titullin Profesor, 11 titullin Profesor i Asociuar;

b. Pika të dobta:

1. UT nuk ka një sistem të integruar të menaxhimit të brendshëm të informacionit. i cili do ju mundësonte studentëve marrjen e të gjithë informacionin personal që lidhet me programin e studimit. Ky sistem është i domosdoshëm dhe për lehtësimin dhe përditësimin e informacionit nga ana e personelit akademik dhe administrativ; (*Standardi V.3, Kriteri 6*)
2. Rregjistrimet në këtë program studimi janë në numër të ulët në krahasim me kapacitetet që ofron ky PS (29 studentë viti akademik 2018-2019; 25 studentë viti akademik 2019-2020; 50 studentë viti akademik 2020-2021; 17 studentë viti akademik 2021-2022); (*Standardi V.2, Kriteri 5*)

Rekomandime

1. Ndonëse UT nuk ka një sistem të integruar të menaxhimit të brendshëm të informacionit, ky institucion po punon për përmirësimin e programit që menaxhon informacionin për studentët (e_student) dhe për stafin. Institucioni duhet të sigurojë që programi i menaxhimit të informacionit për studentët dhe për stafin akademik dhe administrativ të jetë aktiv duke filluar



- nga viti akademik i ardhshëm;
2. Duke qënë të vetëdijshtëm për një rënie të trendit të përgjithshëm të kërkesës për përgjedhjen e programeve si “Ekonomiksit”, Departamenti i Ekonomiksit si Njësia Bazë përgjegjëse e programit të studimit duhet të gjejë mënyra të tjera më efikase që do ndihmojnë në përthithjen e studenteve në numër dhe në cilësi;



Conclusions of the evaluation of the second cycle study program, Master Science in “Economics”

a. Strengths and Affirmations:

1. In 2021, the institution created the Virtual Training and Professional Development Center, which serves as the responsible unit for academic staff training for teaching skills improvement and implementation of new teaching methods. This center is considered a good practice that offers a continuous support to the new- and experienced-staff on sharing the latest teaching methods;
2. The organization of open lectures and the involvement of guests’ lecturers from the business world and beyond, offering valuable experiences from the labor market and by strengthening entrepreneurial education, is another strong point of this study program;
3. Academic staff of the Department of Economics is active in the involvement of local and international projects financed by AKKSHI, GIZ, Erasmus+, Horizon 2020, etc., being a strong point of this department;
4. The institution has concrete cooperation agreements for the realization of professional practice, with relevant partners listed as the most prestigious public and private institutions at the national level;
5. Teaching activity in this study program is fully covered by the full-time staff of the department itself. The institution has ensured to maintain a qualified and stable staff, where out of 38 effective lecturers, 5 hold the title of Professor, and 11 the title of Associate Professor;



b. Weaknesses:

1. UT does not have an integrated internal information management system, which would enable students to obtain all personal information related to the study program. This system is also necessary for the facilitation and the updating of the needed information by academic and administrative staff; (*Standard V.3, Criteria 6*)
2. Enrollments in this study program are low in numbers compared to the capacities offered by this SP (29 students in the academic year 2018-2019; 25 students in the academic year 2019-2020; 50 students in the academic year 2020-202; 17 students in the academic year 2021 - 2022); (*Standard V.2, Criteria 5*)



Recommendations

1. Although UT does not have an integrated internal information management system, this institution is working to improve the program that manages information for students (e_student) and for the staff. The institution should ensure that the information management program for students and for academic and administrative staff to be active starting from the next academic year;
2. Being aware of a decrease in the general trend on the demand for programs such as "Economics", the Department of Economics as the Basic Unit responsible for the study program must find some other efficient ways that will help attract students in numbers and in quality;



Shkalla e përbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përbushen	Përbushen pjesërisht	Përbushen kryesisht	Përbushen plotësisht
I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT				X
II. STRUKTURA DHE PËRMBAJTJA E PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT				X
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT/EVE				X
VLERËSIMI TËRËSOR				X

